



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2416, datë 04.02. 2014

Për

“Miratimin të Dokumentit: “Analizë e tregut me shumice te aksesit broadband internet: Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perفشire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) – Dokumenti Përfundimtar””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 04.02.2014 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit: Analizë e tregut me shumice te aksesit broadband internet: Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perفشire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Përfundimtar”

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës, të përbërë nga:

i. Relacioni shpjegues;

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drini, K. IX, Tiranë

Tel : ++ 355 4 2259 571
Fax : ++ 355 4 2259 106

www.akep.al
info@akep.al

ii. Dokumenti “*Analizë e tregut me shumice te aksesit broadband internet: Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Perfundimtar*”

iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, ndryshuar me vendimin nr. 2342, date 31.07.2013, te Keshillit Drejtues te AKEP (**Rregullorja**).
5. Vendim Nr. 2341 date 31.07.2013, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: “Analizë e tregut me shumice te aksesit broadband internet: Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) – Keshillim Publik”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-Vendimi për “*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut me shumice te aksesit broadband internet: Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Perfundimtar*”

2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*),
3. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin “*Analizë e tregut me shumice të aksesit broadband internet: Tregu me shumice të aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice të aksesit broadband (bitstream) – Këshillim Publik*” në ANEKS 2:

Albtelecom sh.a me shkresën Nr. 1673 Prot., datë 07.10.2013; Vodafone Albania sh.a. nëpërmjet shkresës Nr. 1710 Prot., datë 14.10.2013 ;Albanian Mobile Communications sh.a. me shkresën Nr. 1649 Prot., datë 02.10.2013; Plus Communication Sh.a nepermjet shkrese Nr. 1634 date 30.09.2013;

4. Dokumenti i përgatitur nga Grupi i Punës “Analizë e tregut me shumice të aksesit broadband internet: Tregu me shumice të aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice të aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Perfundimtar”, i cili përmban si Aneks 2: Komentet në Këshillim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V E R E N:

1. Këshilli Drejtus i AKEP me vendimin Nr. 2340 date 31.07.2013, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: “Analizë e tregut me shumice të aksesit broadband internet: Tregu me shumice të aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice të aksesit broadband (bitstream) – Këshillim Publik”
2. Këshillimi publik u krye më datë 01.08.2013-29.09.2013, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente operatorët Albtelecom, Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Plus Communication sh.a.
3. Dokumenti “Analizë e tregut me shumice të aksesit broadband internet: Tregu me shumice të aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice të aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Perfundimtar”.

- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 01.08.2013-29.09.2013, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
- b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
- c. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
- d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikën më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
- e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.
- f. Bazuar në dinamikën e shërbimeve dhe teknologjive si dhe ndryshimet e propozuara nga KE për rishikimin e listës së tregjeve përkatëse të Rekomandimit të vitit 2007, sidomos për shërbimet e aksesit fizik dhe virtual (LLU dhe bitream), AKEP gjykon që përfundimet e këtij dokumenti dhe masave rregulluese për FNT do të duhet të jenë objekt rishikimi sipas ndryshimeve të rekomanduara nga KE për tregjet përkatës.

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të aksesit broadband internet: Tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumicë i aksesit broadband (bitstream) - Dokumenti Përfundimtar”, sipas përmbajtjes në Aneks 1.

2. Dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.
3. Kundra ketij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE

E

TREGUT

ME SHUMICE TE AKSESIT BROADBAND NE INTERNET:

- 1) Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse;
- 2) Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream);

PERFUNDIMTARE

Shkurt 2014

(MIRATUAR ME VKD NR.2416 DATE 04.02.2014)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE
E
TREGUT
ME SHUMICE TE AKSESIT BROADBAND NE INTERNET:

- 1) Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse;
- 2) Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream);

PERFUNDIMTARE

SHKURT 2014

(MIRATUAR ME VKD NR.2416 DATE 04.02.2014)

INDEKSI I PERMBAJTJES

| | |
|--|-----------|
| I. PERMBLEDHJE | 4 |
| II. HYRJE | 9 |
| II.1. PANORAME E PERGJITHSHME E ZHVILLIMIT TE AKSESIT BROADBAND NE SHQIPERI | 9 |
| II.2 PERCAKTIMI I SIPERMARRESVE ME FUQI TE NDJESHME NE TREG | 12 |
| <i>I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator</i> | <i>12</i> |
| <i>II. Procesi i Konsultimit</i> | <i>13</i> |
| <i>III. Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës</i> | <i>13</i> |
| <i>IV. Struktura e Dokumentit</i> | <i>14</i> |
| <i>V. Perkufizimi i tregut perkates</i> | <i>14</i> |
| <i>VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese</i> | <i>16</i> |
| III. TREGU I PAKICES TE AKSESIT BROADBAND | 20 |
| III.1 PERSHKRIMI I TREGUT TE PAKICES NE AKSESIN BROADBAND | 21 |
| III.2 ANALIZE E KONKURRENCES NE TREGUN E PAKICES | 25 |
| IV. ANALIZE E TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND | 33 |
| IV.1 PERKUFIZIMI I TREGUT | 35 |
| IV.2 ANALIZA PER FUQI TE NDJESHME NE TREGUN ME SHUMICE TE BROADBAND | 41 |
| <i>I. Pjeset e tregut</i> | <i>42</i> |
| <i>II. Vleresimi per barrierat ne hyrje ne tregun me shumice te aksesit ne broadband</i> | <i>42</i> |
| <i>III. Fuqia kunderverpruese e bleresve</i> | <i>43</i> |
| <i>IV. Analize e tarifimit per aksesin broadband ne tregun e shumices</i> | <i>44</i> |
| <i>V. Krahasimi me rajonin</i> | <i>44</i> |
| <i>VI. Pritshmerite per tregun e shumices te aksesit ne broadband</i> | <i>45</i> |
| <i>VII. Konkluzion ne analizen e tregut te shumices te aksesit ne broadband</i> | <i>45</i> |
| V. TREGU I AKSESIT FIZIK NE INFRASTRUKTUREN E RRJETEVE NGA NJE VENDODHJE FIKSE (PERFSHIRE AKSESIN E NDARE DHE TE PLOTE) | 46 |
| V.1 PERKUFIZIMI I TREGUT DHE DIMENSIONI I PRODUKTEVE DHE SHERBIMEVE | 47 |
| V.2 ANALIZA PER FNT: TREGU ME SHUMICE NE AKSESIN FIZIK LLU | 48 |
| <i>I. Pjeset e tregut</i> | <i>48</i> |
| <i>II. Faktoret ekonomike dhe fuqia kunderverpruese</i> | <i>49</i> |
| <i>III. Tarifimi per LLU</i> | <i>49</i> |
| <i>IV. Krahasimi me rajonin dhe BE</i> | <i>49</i> |
| <i>V. Pritshmerite per tregun e LLU-se ne te ardhmen</i> | <i>50</i> |
| <i>VI. Konkluzion perfundimtar per LLU</i> | <i>51</i> |
| VI. MASAT RREGULLATORE PER TREGJET E ANALIZUARA | 52 |
| VI.1 MASAT RREGULLATORE PER LLU | 56 |
| VI.2 MASAT RREGULLATORE PER BITSTREAM AKSES | 58 |
| ANEKS 1. KOMENTET NE KESHILLIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP | 61 |

INDEKSI I FIGURAVE DHE TABELAVE

| | |
|--|----|
| FIGURA II.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË INTERNETIT 2011-2013/1 | 9 |
| FIGURE II .2. KRAHASIMI I TARIFAVE TE AKSESIT BROADBAND 2 DERI 4 MBPS: SHQIPERI V RAJON 2012 | 10 |
| FIGURE II .3. KRAHASIMI I SHQIPERI-BE: TELEFONI FIKSE, CELULARE DHE AKSES BROADBAND | 10 |
| FIGURA II.4 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE 2000-2013/1 | 11 |
| FIGURA III.1 PJESET E TREGUT PER AKSES BROADBAND 2011 -2012 (NUMRIT TE PAJTIMTAREVE)..... | 26 |
| FIGURA III.2. KRAHASIMI I NORMAVE TE PENETRIMIT: SHQIPERI VS MESATARE E BE27 | 27 |
| FIGURA III.3. PJESET E TREGUT PER AKSES BROADBAND (2013/1) | 27 |
| TABELA III.1 PJESET E TREGUT NE % SIPAS TE ARDHURAVE NE RETAIL 2011 DHE 2012..... | 27 |
| FIGURA III.5. KRAHASIMI I TARIFIMIT NDERMJET INCUMBENT DHE OA SIPAS CI | 28 |
| FIGURA III.6 . ECURIA E PAKETAVE BUNDLES NE RRJETET FIKSE 2011-2013/1 | 29 |
| FIGURA III.7 ECURIA E AKSESIT NE BROADBAND 3G PER 2011-2013/1 | 30 |
| FIGURA III.8 ECURIA E AKSESIT NE BROADBAND (FIKS+ 3G) PER 2011-2013/1 | 30 |
| SKEMA IV.1: HIREARKIA E AKSESIT NE RRJET PER BITSTREAM | 37 |
| SKEMA IV.2: ARKITEKTURA DHE ELEMENTET E RRJETIT NGA..... | 38 |

I. PERMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar) ketu e me pas Ligji 9918 (i ndryshuar), ne nenin 1 te tij, percakton se:

Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument permban analizen e tregjeve me shumice te aksesit ne broadband si dhe te aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjeteve te hapura, dhe konkretisht:

- 1) Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perفشire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.
- 2) Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream).

Ne baze te percaktimeve te Ligjit 9918, i ndryshuar si dhe praktikës se AKEP me analizat e tregjeve, periudha e konsultimit publik u mbajt prej 60 ditësh nga data 01.08.2013 deri me 29.09.2013, dhe procesi i konsultimit u krye per statusin e FNT dhe per detyrimet e propozuara per FNT.

Ne perfundim te periudhes se konsultimit nga palet e interesuara kane derguar komente ne lidhje me kete dokument operatorët Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Albtelecom Sh.a, Plus Communication.

Komentet mbi dokumentin si dhe qendrimet e mbajtura rreth ketyre komenteve nga AKEP jane te reflektuara ne dokumentin e analizes ne seksionin e fundit, "ANEKS 2".

Ne baze te parashikimeve ligjore dhe te Rregullores, analiza e nxjerre per konsultim publik permban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese si dhe pershkrimin e produkteve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates;
- analize e konkurrencës ne tregjet qe plotesojne kriteret per t'u analizuar per FNT si vleresimin perkates nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg, duke perdorur kriteret e percaktuara ne nenin 33 te Ligjit 9918 (i ndryshuar) si dhe udhezimin e KE;

Ky dokument analize per tregjet e shumices, te aksesit fizik ne rrjetin lokal LLU si dhe tregut te shumices te aksesit broadband zhvillohet per here te dyte ne Shqiperi, pasi per here te pare keto tregje jane analizuar ne 2011.

Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet, bazuar ne vleresimet e te dhenave te tregut, ka tregues te qarte te rritjes te konkurrencës (sidomos ne dy vitet e fundit), gje per te cilen mund te thuhet se tregu i pakices te broadband internet, ndodhet ne kushte e nje konkurrence gjithnje e ne rritje si ne rrjetet fikse (si ofruet kryesore) te aksesit ne broadband internet ne tregun e pakices, por edhe ne rrjetet mobile bazuar ne teknologjine 3G.

Si rezultat i konkurrencës ne rritje nder te tjera vihet re dhe rritja e ofertes ne treg, llojshmeria e ofertes e cila evidentohet ne nje larmi paketash te ofruara ne treg nga ofruerit e internetit pavaresisht rrjetit mbi te cilin ofrohet akses ne broadband internet (fiks apo mobile 3G), gje

cila ka bere te mundur renie te cmimeve si dhe rritje te games se sherbimeve te konsumuara per te njejtin cmim per perdoruesin, gje qe do te konkludohet ne menyre te permbledhur se:

- Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet ka ritme te mira zhvillimi te konkurrences, eshte dinamik dhe ka premisa te forta per nje konkurrence gjithnje e ne rritje. Megjithate niveli i penetrimit te aksesit broadband nga vendodhje fikse ne Shqiperi eshte ne nivele te uleta krahasuar me BE-ne dhe Rajonin. Kjo ben te nevojshme analizimin e tregjeve me shumice te aksesit broadband per nderhyrje te mundshme rregullatore per te stimuluar me tej rritjen e penetrimit te aksesit broadband.

Nga analiza e tregut me shumice te aksesit ne broadband internet, rezulton:

Pas perkufizimit te ketij tregu, ne termat e percaktimit te produkteve dhe sherbimeve te tij, si dhe ne aspektin e shtrirjes gjeografike te ketyre produkteve dhe sherbimeve qe gjenden ne kete treg, AKEP ka zhvilluar me tej analizen per FNT, konkurrencen e mundshme ne kete treg si dhe ecuria e zhvillimit te tij se bashku me prespektiven e mundshme te zhvillimit te ketij tregu ne nje periudhe afatmesme, duke identifikuar ne se ka apo jo operator dominues ne kete treg qe mund te demtojne zhvillimin e konkurrences efektive.

Per identifikimin e fazes se zhvillimit te konkurrences, AKEP mori ne konsiderate nje grup faktoresh, ku nder me kryesoret te vleresuara si: madhesia e tregut (pjeset e tregut sipas te ardhurave ne wholesale), pengesat e mundshme per te hyre ne kete treg dhe analize e barrierave te natyres strukturore, fuqine kundervepruese te bleresve, analize e tarifimit si dhe krahasimi me rajonin dhe BE-ne;

Por pavaresisht faktoreve te cituar me siper, nje rendesi te vecante kishte aspekti tek zhvillime te reja te ndodhura ne kete treg, ku nder me kryesoret jane:

- investimet ne rritje ne infrastrukturat individuale te rrjeteve te operatoreve alternative;
- rritja e mundesive per akses ne broadband nepermjet teknologjive te tjera (perفشire edhe 3G);

Referuar analizes se bere per faktoret e marre ne konsiderate ne lidhje me fuqine e ndjeshme ne treg, rezulton se:

- Albtelecom vazhdon te zoteroje pjese tregu ne nivele mbi 50% te aksesit ne broadband ne nivel shumice;
- Zhvillime te rendesishme te ndodhura ne rrjetin e Albtelecom (kalim ne NGN) duhet konsideruar si nje avantazh dominues ndaj rrjeteve te operatoreve alternative;
- Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), pavaresisht zbehjes se disa prej faktoreve avantazhues qe lidhen me ekonomine (ekonomike te lidhura me ekonomine e shkalles, te densitetit, apo te qenurit lojtar i pare ne treg), edhe pse flitet qarte per renie te dominaces ne kete treg, por duke gjykuar ne prespektiven e zhvillimit te metejsheem te tregjeve te aksesit ne broadband internet, lejon te gjykohet per nje peshe te vecante te Albtelecom ne raport me OA.
- Pavaresisht te trajtimit te tregut te shumices per aksesin broadband internet, faktoret e konsideruar ne menyre te kombinuar me faktoret e madhesise se tregut, ne

prespektiven e zhvillimit te tregjeve broadband ne Shqiperi jane kryesisht per sherbimin bitstream akses, kjo edhe ne fazen ne te cilen aktualisht ndohet zhvillimi i rrjetit te Albtelecom, krahasuar me OA.

Per rrjedhoje AKEP konsideron se:

Albtelecom permbush kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregun perkates me shumice te aksesit ne broadband duke e propozuar sipas kesaj analize si OFNT.

Nga analiza e tregut me shumice te aksesit ne infrastrukture fikse nga vendodndohje fikse (LLU), rezulton:

Per aksesin ne infrastrukturen fizike (LLU) si sherbime me shumice, nje vend te rendesishem ze arsyetimi ne lidhje me produktet e mundshme zevendesuese, te identifikuara si:

- Ndertimi i rrjetit te aksesit nga operatori ne vend te blerjes se LLU;
- Blerja e aksesit LLU ne rrjetin e nje operatori tjeter (eshte aksesit LLU i operatoreve te ndryshem ne te njejtin treg);
- Blerja e aksesit broadband me shumice (bitstream);
- Vetefurnizimi;

Ne lidhje me perkufizimin e tregut dhe dimensionin e produkteve dhe sherbimeve, u konkludua qe:

- Te gjitha sherbimet te cilat mundesohen nga aksesit (shared + full akses), produkte dhe sherbime te cilat mbeshteten ne teknologjite qe mundeson rrjeti mbi baker, fiber etj;
- Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar;

Per analizen e tregut me shumice ne aksesin fizik LLU, mbeshtetur edhe ne analizen pararendese referuar statistikave te depozituara ne AKEP, pavaresisht percaktimit te Albtelecom si operator me FNT si dhe vendosjes se masave rregullatore perkatese, te cilat me kryesoret jane percaktimi i cmimeve per te dy tipet aksesit si dhe miratimi i RUO-s, vihet re se nuk ka ndonje zhvillim te ri ne kete treg, pasi nuk rezulton te kete ndonje kerkese te paraqitur prane operatorit Albtelecom, keshtu qe per faktoret e trajtuar ne analize si: madhesia e tregut (pjeset e tregut), fazen ne te cilen ndodhet zhvillimi i ketij tregu ne Shqiperi, pengesat e mundshme per te hyre ne kete treg si dhe analize e barrierave te natyres strukture, fuqine kundervepruese te blesesve, analize e tarifimit si dhe krahasimi me rajonin dhe BE-ne;

arrihet ne konkluzionin se **Albtelecom permbush kriteret per FNT tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin e hapur lokal (LLU).**

Masat rregullatore per LLU

AKEP gjykon te arsyeshme vazhdimin e detyrimeve rregullatore te vendosura ne analize 2011 per Albtelecom ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike te Albtelecom perfshire facilitetet e tjera ndihmese, etj;

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
- Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Ne amendimin e Ligjit 9918, detyrimi për Akses¹ dhe detyrimeve të vendosura në dokumentin e RUO të miratuar nga AKEP me 31.05.2012, përfshin edhe dhenien e aksesit në elemente jo-aktive të rrjetit për të mundësuar lidhjen e operatorit me MSAN në rrjetin Albtelecom për LLU.

Në lidhje me tarifat, Albtelecom duhet të vazhdojë të aplikojë tarifat e miratuara me VKD nr.1365, datë 13.04.2011 si më poshtë, duke saktësuar që për linjat e aksesuara në MSAN për LLU, Albtelecom të aplikojë tarifat përkatëse të aksesit (të plote dhe të përbashkët) në nën-rrjetin lokal.

Njëkohësisht Albtelecom duhet të vazhdojë aplikimin e tarifave të tjera për LLU të përcaktuara në dokumentin RUO të miratuar nga AKEP me VKD nr.1975, datë 31.05.2012.

Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 42 dhe 45) nga Albtelecom, do të kryhet në bazë të përcaktimeve të Rregullores “*Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri*”, miratuar me Vendim të KD të AKEP Nr. 2406, datë 26.12.2013.

Masat rregullatore për Bitstream Akses

AKEP bazuar në perfundimet e analizës për FNT gjykon të arsyeshme vazhdimin e detyrimeve rregullatore të vendosura në analizë 2011 ndaj Albtelecom në lidhje me tregun e shumicës të aksesit në broadband internet (bitstream akses nga vendodhje fikse) dhe konkretisht:

- Detyrimi për Aksesin (sipas *nenit 39* të ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi për mos-diskriminim (sipas *nenit 40* të ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi për transparencë (sipas *nenit 42* të ligjit 9918 i ndryshuar);

Nderkohe për këto detyrime AKEP gjykon të imponojë disa ndryshime si më poshtë:

- Albtelecom duhet të përditësojë ofertën referencë të aksesit bitstream të publikuar në 2013, duke mos përfshirë kufizime në numër portash për ofrimin e shërbimit. Albtelecom mund të ofrojë skonto (zbritje) për blerje në sasi të mëdha, duke dhënë rregullat e aplikimit të tyre në oferte.

Albtelecom ka detyrimin të japë akses me shumicë broadband (bitstream):

Ne nivel Ethernet;
Ne nivel IP

¹ Neni 42, pika 2/a: t'u ofrojnë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal.

AKEP gjykon te arsyeshme lenien e detyrimit per akses ne layer 2 (Ethernet)² dhe ne layer 3 IP, dhe heqjen e detyrimit per akses bitstream ne nivel DSLAM, pasi ky akses eshte shume i perafert me aksesin per LLU. Gjithashtu aksesin ne nivel IP eshte shume afer rishitjes, ndersa rishitja vete nuk ka nevojte per shrbime aksesin pasi te gjitha ofrohen nga operatori inkumbent.

Detyrimi per kontroll tarife

Pervec detyrimeve te mesiperme AKEP gjykon te arsyeshme te vendose detyrimin per kontroll te tarifave te sherbimeve te akses bitstream, sipas metodes “retail minus”, si me poshte:

| Niveli i aksesit | Cmimi Maksimal |
|-------------------------|-----------------------|
| Ne nivel Ethernet; | Retail – 50% |
| Ne nivel IP | Retail -30% |

Shenim: Tarifa retail me pakice pa TVSH

Tarifa retail do te jete ne varesi te shpejtesise se aksesit broadband, duke iu referuar paketave tarifore te aksesit broadband per pajtimtaret e Albtelecom. Me hedhjen ne treg te paketave te reja tarifore broadband Albtelecom do te duhet te ofroje dhe sherbimin e aksesit bitstream duke ofruar dhe cmimin perkates ne varesi te nivelit te aksesit dhe tarifes perkatese me pakice.

- Zbritjet ne tarifa ne varesi te sasise

AKEP gjykon qe nje zbritje prej 10 pike perqindjeje te aplikohet per 100 linjat e para te blera te cdo operatori. Pra kur nje operator arrin kuoten 100 linja ne nje pike aksesin (niveli Ethernet apo IP) te kete nje reduktim me 10 pike perqindjeje per tarifen mujore qe do te paguaje Albtelecom.

- Cmim dysheme (minimal)

Cmimi per akses bitstream nuk mund te jete me i lire se cmimi per akses ne LLU. Ne vijim te argumentit ne pjesen e analizes per LLU, cmimi (tarifa mujore) per akses bitstream nuk mund te jete me i ulet se tarifa mujore e qarkut/nenqarkut local per akses te perbashket.

Sic eshte evidentuar edhe ne analizen e linjave me qira, nje numer i konsiderueshem operatoresh kane investuar ne rrjete backbone me fiber optike ne zona urbane dhe midis qyteteve kryesore, pefshire edhe ne rrjete aksesin. Investimet ne rrjetet e aksesit kane cuar dhe cojne ne nje kerkese me te ulet per LLU dhe akses bitstream. Megjithate AKP gjykon qe mundesite qe ofron rrjeti NGN/NGA jane te medha dhe detyrimet e perfshira ne kete dokumnet dhe ne analizen e linjave me qira, krijojne mundesi per operatoret e ndryshem ne treg qe nepermjet kombinimit te infrastruktures se tyre dhe perdorimit te sherbimeve me shumice te aksesit ne infrastrukture fizike dhe jo-fizike te Albtelecom, te ofrojne produkte te ndryshme perdoruesve fundore dhe me shume inovacion dhe konkurrence ne tregjet me pakice te aksesit broadband.

² Ne NGN ATM zevendesohet teresisht nga Ethernet.

II. HYRJE

II.1. Panorame e përgjithshme e zhvillimit të aksesit broadband në Shqipëri

Numri pajtimtareve me akses broadband fikse dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të 6 muajit të I-re të vitit 2013, është mbi 204 mijë, kundrejt rreth 215 mijë që ishte në fund të vitit 2012, gjë e cila përben një rritje prej rreth 5% .

Numri i pajtimtareve me akses broadband me rrjete fikse është pothuajse në të njëjtat parametra të vlerësuar në fund të vitit 2012. Vihet re një rritje e operatorit alternativ Abcom prej rreth 17% dhe në rritje e vogël nga Albtelecom në vlerë me pak se 2%.

Në operatorët alternativë fikse ABCOM vazhdon të jetë operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 42 mijë në fund të 6 muajit të I-re 2013, me një rritje prej rreth 17 % krahasuar me fund vitin 2012.

Një rritje në nivelin 7%, ka pasur edhe Abisnet, por në totalin e tyre operatorët alternativë rezultojnë të kenë një rritje prej rreth 22 %, krahasuar me të dhënat e fund vitit 2012.

Numri i pajtimtareve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem për përdorim me kompjuter) në fund të 6 muajit të I-re 2013 është rreth 42 mijë, kundrejt 55 mijë në fund të 2012, që përben një rritje me 31%. Rritje të theksuar në këtë grup ka operatori Vodafone me një vlerë rreth 44%.


FIGURA II.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË INTERNETIT 2011-2013/1

| | Albtelecom | Abcom | Abisnet | ASC | OA të tjere | Total Fiks | AMC | Vodafone | EM | Total Fiks +3G |
|------------------------|------------|--------|---------|--------|-------------|------------|--------|----------|-------|----------------|
| 2011 | 60,055 | 29,321 | 15,321 | 10,129 | 24,871 | 139,697 | 9,000 | 25,493 | | 174,190 |
| 2012 | 66,757 | 35,870 | 17,719 | 11,777 | 27,965 | 160,088 | 17,833 | 37,572 | | 215,493 |
| 2013/1 | 67,855 | 41,980 | 18,982 | 10,309 | 23,642 | 162,768 | 17,971 | 21,049 | 2,882 | 204,670 |
| Ndryshimi 2013(1)/2012 | 2% | 17% | 7% | - 14% | - 22% | 2 % | | - 44% | | -5% |

Nga tabela e mësipërme vihet re për disa ndryshime në krahasimin ndërmjet të dhënave të 6 muajit të I-re 2013 dhe të dhënave të fund vitit 2012.

Vihet re që aksesin në broadband fikse për 2013/1 të ketë një rritje modeste prej rreth 2 %, krahasuar me fund vitin 2012, ndërsa në aksesin në broadband internet në Fiks + Celular 3G (karta modem), rezultojnë të ketë një rritje prej rreth 5%. Kjo rritje vjen kryesisht nga rritja e reflektuar tek Vodafone Albania.

FIGURE II .2. KRAHASIMI I TARIFAVE TE AKSESIT BROADBAND 2 DERI 4 MBPS: SHQIPERI V RAJON 2012



Burimi: AKEP dhe Cullen International


Nje krahasim i tille ka ne konsiderate tarifimin standart, pasi ne treg për aksesin broadband me kapacitete 1 Mbps – 2 Mbps, ka oferta te cilat jane me te uleta te cilat variojne nga 1500 lek/muaj (pakete e cila perdoret nga nje numer i konsiderueshem abonentesh te Albtelcom) dhe 1300 lek/muaj (me TVSH) për operatorë alternative. Ne tarifate e cituara ne te gjitha ofertat e ofruara nga rrjete fikse (paketa bundles), jane te perfshira edhe pajtimi mujor i telefonise + sherbime te tjera pervec sherbimit te aksesit ne internet broadband me kapacitetin e kontraktuar.

Operatoret alternative kane qene gjithashtu aktive ne reduktimin e tarifave te aksesit ne Internet dhe tarifate e tyre jane te krahasueshme me ato te Albtelcom, dhe sic eshte theksuar me sipër, operatoret kryesore alternative ofrojne edhe paketa te kombinuara telefoni, Internet dhe television ne disa raste.

Ecuria e zhvillimit te telefonise fikse, celulare dhe aksesit broadband ne Internet rezulton se Shqipëria per secilen nga segmentet kryesore te tregut te komunikimeve elektronike (telefonine fikse, telefoni celulare dhe broadband internet) vijon te jete ne rritje te vazhdueshme per telefonine celulare dhe aksesin ne broadband internet, dhe ne ritme te uleta zhvillimi per telefonine fikse.

Ne nje krahasim me vendet e BE dhe te rajonit vihet re sipas figures se meposhtme.

FIGURE II .3. KRAHASIMI I SHQIPERI-BE: TELEFONI FIKSE, CELULARE DHE AKSES BROADBAND




Akresi në Internet me brez të gjerë (broadband) sot konsiderohet si një ndër faktorët e rëndësishëm për zhvillimin konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale të një vendi. Ndarja e informacionit me shpejtësi të madhe, rrit prodhimin, ndihmon tregun duke sjellur risi në zhvillimin ekonomiko-shoqëror. Për të pasur të gjitha avantazhet e Internetit, konsumatorët duhet të jenë në gjendje të dërgojnë dhe të pranojnë të dhëna me shpejtësi të madhe. Kjo është ajo çfarë ofron aksesin me brez të gjerë.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të 6 muajit të vitit 2013, arriti në rreth 280 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012.

Kjo përbën një rënie me rreth 10 %. Kryesisht kjo rënie ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 11 mijë krahasuar me të dhënat e fundit të vitit 2012 si dhe ndryshimit të madh të sjelljeve në të dhënat e operatorit alternativ Abcom, pasi referon të dhëna me një rënie rreth 20 mijë pajtimtare (sipas përcaktimit të bërë vetëm si pajtimtare aktive). Duke vlerësuar të dhënat e derguara nga operatorët e telefonisë fikse, pavarësisht tendencës në ulje të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse që duket se po ndjek atë të vendeve të BE, në Shqipëri rezultojnë që norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri është rreth 10 %, kundrejt penetrimit prej 11% që ishte në fund të vitit 2012 dhe në një nivel që është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej 40%) dhe vendet e rajonit.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Albtelecom dhe operatorëve alternative.

FIGURA II.4 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE 2000-2013/1



Vihet re që në të dhënat e raportuara në fund të 6 muajit të I-re të vitit 2013, numri total i pajtimtarëve të operatorëve alternativë ka pësuar ndryshime të ndjeshme krahasuar me të dhënat e fundit të vitit 2012. Sqaruar me siper se ndryshimi kryesor ka ardhur si pasojë e raportimeve të bërë nga Abcom, i cili në matjet e bërë në rrjetin e tij ka konsideruar vetëm pajtimtarët (përdorues pagues) dhe jo numrin e plotë të pajtimtarëve të lidhur në rrjetin e tij, për të cilin deklaroi se është i njëjti me të dhënat e fundit të vitit 2012.

II.2 Percaktimi i sipermarresve me fuqi te Ndjeshme ne Treg

I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 (i ndryshuar) "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918), ne nenin 1 te tij, percakton se:

Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat Rregullatore shprehen qartesisht ne Nenin 7 i Ligjit 9918 (i ndryshuar), ku nder te tjera percaktohet se:

AKEP-i nxit konkurrencën efçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

a) për t'u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.

b) për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve;

c) për të mbrojtur interesat e sigurisë publike;

ç) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;

d) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;

dh) për të nxitur investimet efçente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;

e) për të nxitur përdorimin e frytshëm të frekuencave dhe serive numerike si burime të fundme;

ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e anlizes se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Rekomandimet dhe udhezimet e KE-se te marra si më poshtë:

o Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhëzimi i KE)

o Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003 , për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në

një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)

- o Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)

II. Procesi i Konsultimit

Ligji Nr.9918 dt. 19.05.2008 (i ndryshuar) “Per komunikimet elektronike ne RSH”, parashikon ne Nenin 35 te tij, proceduren e keshillimit me palet e interesit per analizen e tregut duke vendosur si afat, periudhen kohore prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon, mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara.

Ne baze te percaktimeve te Ligjit 9918, i ndryshuar si dhe praktikës se AKEP me analizat e tregjeve, periudha e konsultimit publik u mbajt prej 60 ditesh nga data 01.08.2013 deri me 29.09.2013, dhe procesi i konsultimit u krye per statusin e FNT dhe per detyrimet e propozuara per FNT.

Ne perfundim te periudhes se konsultimit nga palet e interesuara kane derguar komente ne lidhje me kete dokument operatorët Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Albtelecom Sh.a, Plus Communication.

Komentet mbi dokumentin si dhe qendrimet e mbajtura rreth ketyre komenteve nga AKEP jane te reflektuara ne dokumentin e analizes ne seksionin e fundit, “ANEKS 2”.

.

III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918 dt. 19.05.2008 (i ndryshuar) “Per komunikimet elektronike ne RSH”, AKEP-i bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës, duke respektuar edhe Memorandumin e Mirëkuptimit (Nr. Prot. 1566/1, datë 29.08.2007) ndermjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe në veçanti “Neni 6”, ku flitet per përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.

Autoriteti i Konkurences eshte perfshire vazhdimisht me komentet e tij ne analiza tregjesh te konsultuara si per telefonine fikse dhe celulare, duke dhene sugjerime dhe rekomandime perkatese ne keto procese, duke gjetur tek AKEP predispozicion e bashkerendimit te veprimeve qe favorizojne konkurencen nepermjet nderhyrjeve ex-ante ne tregjet e konstatuara si te nevojshme per nderhyrje te tilla.

AKEP i ka kerkuar AK te shprehe opinionin e vet ne lidhje me dokumentin “Analizë e tregut me shumice te aksesit broadband internet: Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) - Konsultim Publik”

dhe komentet e AK do të merren në konsideratë dhe reflektohen në dokumentin final të Analizës së tregut.

IV. Struktura e Dokumentit

Ky dokument përmban analizën e tregjeve me pakice dhe me shumice të linjave me qira, dhe konkretisht:

- 1) Tregu me shumice i aksesit në infrastrukturen e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plote dhe të përbashkët-LLU) nga vendodhje fikse;
- 2) Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream);

Në bazë të parashikimeve të Rregullores, analiza përmban:

- përkufizimin e tregjeve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates për të analizuar konkurrencën në këto tregje dhe nëse ka operatore me fuqi të ndjeshme në treg, duke përdorur kriteret e përcaktuara në nenin 33 të Ligjit si dhe udhëzimin e KE
- analizimin e problemeve në tregjet në të cilat nuk ka konkurrencë efektive apo ku ka operatore me fuqi të ndjeshme në treg
- detyrimet për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg

V. Përkufizimi i tregut perkates

Në kuader të analizave të kryera nga një rregullator për qëllime të analizës së konkurrencës efektive dhe përcaktimit të sipërmarrjes/sipërmarrësve me FNT, analiza e një tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe shërbimeve që konsiderohen të jenë pjesë e të njëjtit treg.

Si referencë për përkufizimin e tregut perkates është përdorur përkufizimi i marrë nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës:

***Treg perkates**- janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kerkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.*

Ky përkufizim është i ngjashëm me përkufizimin e dhënë në Udhëzimin e KE, pika 44³. Për këtë arsye si dhe duke qenë se udhëzimi i KE, është pjesë e dokumentave të KE të referuara në Rregulloren, AKEP në këtë Analizë do të përdoret të njëjten metodologji për përcaktimin e produkteve/shërbimeve që janë pjesë e të njëjtit treg perkates, sic është shtjelluar dhe në paragrafet në vijim.

³ According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

Perkufizimi i tregut per nje sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

Parimi i monopolistit hipotetik

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprurese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprurese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses- konsumatorët do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjetër, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

Zevendesimi ne anen e kerkeses

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorët te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorët mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

Zevendesimi ne anen e ofertes

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatoret, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese egzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne

tarifimin e shërbimeve të ndryshme: s'ka mundësi të rrisë çmimin e një shërbimi pa reduktuar çmimin e një shërbimi tjetër, i cili në vetevetë nuk është zëvendësues për shërbimin tjetër.

VI. Fuqia e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese

Pekufizimi i FNT është dhënë në nenin 33 të ligjit:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Ky perkufizim është pothuajse i njëjti me perkufizimin e Direktives Kuader të KE 2002, neni 14⁴ (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit përcakton gjithashtu kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrës me FNT, që do të thotë dominancë individuale, dhe për rastet kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrës me FNT apo dominancë e bashkuar. Perkufizimi i dominancës së bashkuar i dhënë në nenin 33 është si vijon:

Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, vepronë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cila të çon në një sjellje të bashkënduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.

Për përcaktimin e FNT, dominancë individuale apo e bashkuar, siç theksohet dhe në pikat 79 dhe 98 të Udhezimit të KE, kriteret e përdorur duhen marrë të gjithë në konsideratë dhe në kombinim me njëri tjetrin dhe jo në mënyrë të veçantë për secilin kriter me vetë, pasi evidenca e kriterëve të veçantë mund të mos jete përcaktuese e FNT.

Analiza për FNT është një analizë e cila merr në konsideratë zhvillimet e kaluara dhe njëkohësisht tendencën për të ardhmen (forward looking), pasi mungesa e konkurrencës në të kaluarën nuk do të thotë që një treg nuk ka tendencë për të qenë në konkurrencë në të ardhmen. Në këtë mënyrë Analiza krahas shqyrtimit të kriterëve për vlerësimin e konkurrencës efektive në treg në të kaluarën, bën vlerësimin se si pritet të evoluojë tregu në të ardhmen. Analiza kryhet për të shqyrtuar nëse një treg përket vlerësohet të jete në konkurrencë efektive në një periudhë të pakten 2 vjeçare, dhe mungesa e konkurrencës efektive është barazvlefshme me egzistencën e fuqisë së ndjeshme në treg, prej një ose më shumë sipërmarrësish.

Egzistenca e FNT do të thotë që në treg ka probleme të cilat identifikohen dhe në bazë të problemeve të evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrime për tu zbatuar nga sipërmarrësi/sipërmarrësit me FNT. AKEP në bazë të nenit 34, ka detyrimin që në rast të gjetjes së FNT në një treg përket të vendose një disa apo të gjitha detyrimet e cilesuara në nent 39 - 45 dhe neni 56 të Ligjit 9918 (i ndryshuar). Vendosja e detyrimeve/masave rregulluese për FNT duhet të marrë në konsideratë objektivat rregullatore të përcaktuara në Ligj.

⁴ 'an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers''

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrence efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarresve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre.

II.3 Perfundimet kryesore te analizes 2011 per LLU dhe WBA

Perfundimet kryesore te analizes 2011 per tregun LLU

Analiza per tregun me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem dhe te plote) nga vendodhje fikse, u mbajt per here te pare ne vitin 2011, dhe dy sherbimet kryesore te trajtuara ne kete analize ishin:

- Akses i plote (full LLU)
- Akses i ndare apo i perbashket (shared LLU)

Specifikat perkatese per secilin nga dy llojet e aksesit te trajtuara jane dhene me dataje ne dokumentin analize 2011, duke ilustruar edhe me skema perkatese.

Ne dokumentin analize 2011, vend te posacem kishte pershkrimi i produkteve dhe sherbimeve te LLU, si produkte te identifikuar ne tregun shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit incumbent, si: “shared akses” dhe “full akses”, te konsideruara si te rendesishme per rritjen e mundesive per akses ne broadband.

Aksesi ne infrastrukture fizike (LLU) si sherbime me shumice ka keto produkte te mundshme zevendesuese:

- Ndertimi i rrjetit te aksesit nga operatori ne vend te blerjes se LLU;
- Blerja e aksesit LLU ne rrjetin e nje operatori tjetere;
- Blerja e aksesit broadband me shumice (bitstream);
- Vetefurnizimi;

AKEP arriti ne konkluzionin se Albtelecom ishte operator me Fuqi te Ndjeshme ne Tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit te tij nga nje vendodhje fikse perfshire aksesin e plote dhe te ndare.

Detyrimet e vendosura per LLU

Sipermarresi ALBTELECOM sh.a. i percaktuar sipermarres me FNT ne tregun me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike per aksesin e ndare te pjesshem ose te plote (LLU) nga vendodhje fikse, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet si më poshtë, por pa u kufizuar:

- Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 te ligjit nr. 9918.
- Detyrimin e transparences, sipas nenit 40 te ligjit nr. 9918.
- Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41 te ligjit nr. 9918.

- Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918.

- Detyrimin për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9918.

Detyrimet rregullatore u detajuan si më poshtë:

Ne përputhje me nenin 57, pika 1/a dhe neni 59 pika 2, niveli maksimal i tarifave të aksesit në rrjetin lokal të Albtelecom për LLU u vendos të jetë sipas vlerave të modelit BULRAIC të zhvilluar në 2010.

Implementimi i masave rregullatore sipas analize 2011 për LLU

Albtelecom si operator me FNT në tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën fizike në të dy llojet e aksesit (shared dhe full), nën monitorimin e AKEP, ka implementuar detyrimet rregullatore të cituara më sipër, ku ndër me kryesoret është miratimi i ofertes referencë për LLU (pjesë përberëse të të cilës janë edhe tarifatat për shërbimet përkatëse, sipas produkteve të identifikuara).

Perfundimet kryesore të analizës 2011 për tregun WBA

Perfundimet kryesore të arritura në analizë 2011, në lidhje me:

Aksesi i realizuar mbi të gjitha platformat që shfrytëzojnë teknologjitë XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj), teknologjinë kablore, FWA apo teknologji të tjera që mundësojnë aksesin në broadband bëjnë pjesë të të njëjtin treg të shumicës, duke përcaktuar si dimension të mundshëm të ofrimit të këtij shërbimi, dimensionin kombëtar, pra territorin e RSH.

Ndërsa pas zhvillimit të analizës për FNT në këtë treg si dhe marrjes në konsideratë të faktoreve kryesore në analizën për FNT, si pjesët e tregut, faktorët e fuqisë kundërpruese të blerësve, faktorët e tjere avantazhuese që kanë lidhje me ekonominë e sipërmarrjesit Albtelecom si, ekonomia e shkallës apo densitetit, peshën e faktorit të konsideruar si integrim vertikal në ofrimin e shërbimit “bitstream akses” si dhe duke mos i konsideruar faktorët në mënyrë kumulative, konstatimi sipas analizës 2011 në lidhje me shërbimin e sipërcituar dhe analizën për FNT në këtë treg, ishte:

- Albtelecom përmbushte kriteret për fuqi të ndjeshme në tregun përkatës me shumicë të aksesit në broadband

Detyrimet e vendosura për Albtelecom i identifikuara sipas analizës 2011 me FNT në tregun me shumicë të aksesit broadband (bitstream) si:

- Detyrimin e mosdiskriminimit;
- Detyrimin e transparencës;
- Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit;

Detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e aksesit me shumicë broadband (bitstream) në rrjetin Albtelecom, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të ALBTELECOM, si edhe me tarifa të cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

Albtelecom ka detyrimin te jape akses me shumice broadband (bitstream):

- Ne nivel DSLAM;
- Ne nivel ATM/Ethernet;
- Ne nivel IP;
- Rishitje;

- Albtelecom ka detyrimin te jape akses me shumice broadband (bitstream) ne rrjetin Albtelecom, ne terma komerciale, perfshire tarifat e ketyre sherbimeve, si dhe u percaktua se ne rast mosmarveshje midis paleve do te zbatohen parashikimet e ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator perkates.

- Albtelecom ne rast te dhenies akses nje operatori per sherbimin me shumice broadband (bitstream) te perditesoje Ofertën Referencë të aksesit te hapur (RUO) per sherbimin e ofruar duke e bere te disponueshme edhe per operatore te tjere ne terma jo-diskriminues dhe transparent.

Analiza 2011 e mbajtur nga AKEP ne lidhje me tregun me shumice te aksesit broadband (bitstream akses), ka konsideruar ne zanafille te tyre tregun e pakices ne broadband, aspektin e kerkesave te mundshme te gjeneruara ne nivelin e pakices, duke gjykuar ne konkurrencen ne nivelin e pakices pa diferencuar teknologjite e mundshme.

III. TREGU I PAKICES TE AKSESIT BROADBAND

AKEP, gjykon te domosdoshme nje analize te detajuar per tregun e pakices te aksesit ne broadband, nje veshtrim te hollesishem te ndryshimeve te ndodhura pas analize 2011 ne kete treg, zhvillimin e kerkeses konsumatore si dhe shkallen e elasticitetit te kerkeses dhe ofertave, analize te faktorit te zevendesueshmerise se kerkeses apo zevendesueshmerise se ofertes ne kete treg.

Indikatorët kryesorë të tregut që kanë të bëjnë me teknologjinë (teknologjite mbi të cilat ofrohet aksesit në broadband (Albtelecom + Operatorët Alternative), si: X DSL & Fiber, Kabllorë, 3G, shkallën e penetrimit për aksesin broadband (popullsia dhe familje), përbejnë edhe faktorët influencues në zhvillimin e konkurrencës në këtë treg, trendi i mundshëm në aspektin e rritjes së konkurrencës pas analize 2011, të cilat të konsideruara së bashku, përcaktojnë nëse është e nevojshme për nderhyrje ex-ante në tregjet e nivelit të shumicës (tregjet e shumicës të aksesit broadband).

AKEP ka mbajtur në vëmendje dhe në fokus zhvillimin e tregut të aksesit broadband në të dy nivelet e tij, pasi kjo është përcaktuar edhe nga strategjia kombëtare për zhvillimin e broadband në Shqipëri, si dhe nevojat gjithnjë e në rritje për kryerjen e shërbimeve bazike të konsumatorëve të mbështetura nga shërbimet që mundeson aksesit në broadband.

AKEP në mënyrë periodike ka publikuar raporte statistikore, kryesisht në dy vitet e fundit konstatohet:

- Rritje e kerkeses per akses ne broadband, per rrjedhoje ka rritje te penetrimit te aksesit ne broadband;
- Krahas rritjes se kerkeses per akses ne broadband, konstatohet pozicionimi i kerkeses konsumatore per akses ne broadband me shpejtesi te larte, duke rezultuar ne kete menyre pothuajse ne eliminimin e aksesit ne brez te ngushte, pasi kjo vjen si pasoje e pozicionimit te kerkeses konsumatore per aplikacione qe kerkojne shpejtesi te larte dhe kapacitet me te madh, (per download), per aplikacione te ndryshme, per filma, muzike, lojra te ndryshme, sherbime te ndryshme te kushtezuara per kapacitet te larte;
- Zhvillimi sasior por edhe cilesor i kerkeses konsumatore per akses ne broadband, ka ndikuar edhe ne zhvillimin e ofertes ne te gjitha karakteristikat e saj, por edhe orientimin drejt teknologjise qe ploteson sa me mire kerkesen konsumatore, pasi rritja dhe zhvillimi ne paralel e kerkeses dhe ofertes, ben te detyrueshme edhe per ofertuesin hedhjen e veshtrimit drejt teknologjise qe maksimizon plotesimin karakteristikave te kerkeses si dhe optimizimin e elementeve te ofertes, gjykuar ne koston e ofrimit te shërbimit te aksesit ne broadband;
- Konstatohet nje rritje e shtrirjes gjeografike te shërbimit te aksesit broadband;
- Konstatohen zhvillime pozitive te games se teknogjise nepermjet se ciles mundesohet aksesit ne broadband, por edhe zhvillime te rendesishme te nje grupi ofruesish (operatorët alternative), te cilet kane nje rritje te ndjeshme ne penetrimin me shërbimin e aksesit ne broadband;
- Konstatohet nje zhvillim gjithnje e ne rritje nga shërbimet broadband celulare mbi 3G;
- Zhvillime te rendesishme te paketave “bundle”, ofertave qe plotesojne kerkesen konsumatore per telefoni dhe internet kryesisht, por edhe pakete tre-play, ku pershihet edhe paketa TV;

AKEP gjykon se faktoret e mesiperm perbejne faktoret baze mbi te cilet mbeshtetet zhvillimi tregut te aksesit broadband ne nivelin e pakices, dhe bazuar edhe ne objektivin shteteror dhe strategjine e zhvillimit te broadband, mund te parashikohet se ne vitet e ardhshme do te kete rritje te ndjeshme te penetrimit te aksesit ne broadband, kjo vleresuar edhe si penetrimit ne aksesin e linjave, gje e cila do te percaktoje ne menyre te natyrshme rritje te penetrimit te perdoruesve te sherbimeve qe mundeson aksesin ne broadband.

Trendi i rritjes se investimeve ne zhvillimin e infrastruktures mbi te cilen mundesohet aksesin ne broadband, perben edhe premisen kryesore mbi te cilen mbeshteten e ardhmja e zhvillimit te tregjeve broadband. Kjo vihet re si ne investimet e bera ne NGN (apo kryesisht NGA), investime te cilat bazojne rrjetet e tyre kryesisht ne (IP), te cilat ne fund te fundit orientojne tregjet edhe ne konvergjence te sherbimeve te cilat mbeshteten ne (IP). Nje zhvillim i tille, terheq kerkesen konsumatore ne akses me kapacitet te larte, por percakton edhe zhvillimin e rendesishem te ofertave ne kete drejtim, pasi vihet re se kemi rritje te ndjeshme te kapacitetit te ofruar (upload dhe download), pothuajse ne te njejtin nivel cmimi. Kjo perben nje zhvillim te rendesishem ne kete drejtim, gje e cila percakton qarte tregues te rritjes se konkurrences ne kete treg.

III.1 PERSHKRIM I TREGUT TE PAKICES NE AKSESIN BROADBAND

Ne konstatimet e trajtuara me siper per tregun e pakices per aksesin broadband, per teknologjite mbi te cilat mbeshtetet aksesin ne broadband, zhvillimin e kerkeses dhe ofertes per aksesin broadband, bejne te mundur qe ne identifikimin e tregut perkates ne pakice, ne menyre te ngjashme ka gjetur trajtim edhe ne praktikate rregullatore te vendeve te tjera, praktika te cilat kane mbeshtetje edhe ne rekomandimet e KE-se, si dhe ne studime te ndryshme te bera dhe te publikuara nga BEREC per zhvillimin e tregjeve broadband dhe prespektiva e zhvillimit te tyre ne vitet e ardhshme, kane si baze rekomandimet e bera ne 2003 dhe 2007, por duke parashikuar mundesite e nderhyrjeve rregullatore sipas rrethanave specifike ne te cilat zhvillohen analizat qe marrin ne konsiderate aksesin broadband.

Edhe ne analize 2011, eshte parashikuar qe ne dy vitet ne vijim do te kete zhvillime te pritshme ne tregun e aksesit broadband. Keshtu qe te gjitha vleresimet jane bere duke marre ne konsiderate zhvillimin e tregjeve broadband te trajtuara ne aspektim e zhvillimit te konkurrences, duke i trajtuar me predispozicion te vecante zevendesueshmerine e kerkeses/ofertes per secilin nga produktet/sherbimet e mundshme ne treg.

Ofertuesit kryesore ne treg, llojet e ofertave

Edhe ne analize 2011 eshte dhene pershkrimi baze per broadband dhe narrowband, ne lidhje me kufirin ndares ndermjet tyre (sipas kapacitetit, teknologjise etj), ku varion kufiri dysHEME nga 128 kbit/s, por ka vende qe perdorin 144 kbit/s ne varesi kapaciteteve te ofruara dhe ne lidhje me kufirin tavan (te pakufizuar, deri me X Mbit/s), duke detajuar teknologjite mbi te cilat mundesohen broadband (per sherbime qe kerkojne kapacitet te larte ne download dhe upload), ofertuesit kryesore ne treg, gamen e ofertave qe mundesohen ne treg se bashku me karakteristikate e ofertave perkatese.

Ne regjistrin zyrtar te AKEP jane nje numer i konsiderueshem subjektesh dhe personash fizike te autorizuar per ofrimin e sherbimit te internetit, ku numri i madh i tyre eshte i

pozicionuar lokalisht (ne zona lokale ne ofrimin e sherbimit te internetit), te cilat rezultojne rreth 53 sipërmarrës aktive (pavaresisht se numri i sipërmarrësve te autorizuar eshte shume me i larte).

Por peshen kryesore ne ofrimin e aksesit ne broadband fikse (nga rrjetet fikse) rreth 80% e zene sipërmarrësit: Albtelecom, Abcom, Abissnet, Primo, ASC, ndersa te gjithë ofruesit e tjere te bazuara ne rrjetet fikse te ofrimin te aksesit ne broadband internet zene rreth 20 %. Ndersa ne se do te behej nje vleresim per ofruesit e aksesit ne broadband internet (fiks + 3G) ku per rrjetet celulare jane llogaritur vetem akses i bazuar ne card modem, rezulton qe pesha e ofruesve alternative ne totalin e tyre eshte shume me e vogel, (rreth 12 %).

Sipërmarrësit kryesore ne treg dhe ofertat e tyre

Para se gjithash vihet re (kryesisht ne dy vitet e fundit), tendenca e te gjithë ofruesve te sherbimit te internetit te bazuara ne rrjetet fikse (por edhe rrjetet e telefonise se levizshme), qe te ofrojne per konsumatorin paketa me game sherbime (bundles), te paketuara dhe te ofertuara ne periudha kohore te shtrira ne periodicitet nje mujor, 3 mujor, 6 mujor, 12 mujor etj.

Ne kete aspekt, me qellim berjen atraktive te ofertave te tyre, nder te tjera ofrohen pervec internetit dhe telefonise edhe sherbime te tjera (aksesore ndihmes) si: instalime, modeme, krijim faqesh, mirembajtje te ndryshme, hostime etj, te cilat ofrohen ose falas, ose kundrejt nje tarife te arsyeshme, por te kushtezuara me kontraktimin e sherbimit me kompanine ofruese . Kjo sjellje e ofruesve eshte pothuajse e njejte, dhe kryesore eshte qe ofertat te tilla kryesisht nga ofertues te ndryshem gjenden ne zona te njejta gjeografike, gje e cila perben edhe nje faktor shume pozitiv per rritjen e treguesve te konkurrencës, jo vetem ne tarifim por edhe ne karakteristikat e tjera te sherbimit.

Per ilustrim, ne vijim do te gjeni nje pershkrim te permbledhur te disa prej ofertave kryesore ne treg, ofertat e tyre kryesore si dhe permbajtja (ne menyre te permbledhur e elementeve perberes te ketyre ofertave.

Per perdoruesin fundor ofertuesit kane te publikuar nje game ofertash me karakteristika dhe mundesi pagese te ndryshme per perdoruesin (me aftesi te ndryshme pagese).

Oferta te ngjashme gjenden tek ofruesit kryesore ne treg, si Albtelecom, Abcom, Abissnet, Primo, ASC te cilet ofrojne nje kombinim te elementeve te ofertes me elemente thirrje telefonike me tiplogji te ndryshme si dhe internet. Por ASC dhe Abcom si ofrues te sherbimit ne tre-play, ofrojne si element te ofertave te tyre edhe paketa TV.

Klasifikimi i llojeve te ofertave, sipas kategorise se perdoruesit

a) Oferta broadband per kategorine pajtimtare familjare:

- Karakteristikat kryesore qe kane lidhje me kapacitetin;
- Kufizueshmeria e ofertave (te limituara, ose te palimituara);
- Afati i kontraktimit te ofertes;
- Elementet e ofertes (telefoni, internet, TV);

b) Oferta broadband per kategorine pajmtare biznes:

- Karakteristikat kryesore qe kane lidhje me kapacitetin;
- Kufizueshmeria e ofertave (te limituara, ose te palimituara);
- Afati i kontraktimit te ofertes;
- Elementet e ofertes (telefoni, internet, TV);

Elementet kryesore te ofertave te permbledhura permbajne:

Instalim të telefonisë fikse, FALAS (ose ne ndonje vlere simbolike);

Instalim të internetit, FALAS (ne shumicen e ofertave);

Bllloqe thirrjesh telefonike me tipologji te ndryshme te perfshira si element te paketes;

Kapacitet ne internet broadband (te limituar apo pa limit);

Modem wireless (ose ADSL), FALAS (pasi kryesisht permbajne kushtezime ne afatin e kontraktimit te sherbimit);

Kohëzgjatja e kontratës: kryesisht 12 muaj, por ka edhe alternative ne afat kohor me te shkurter, apo edhe me te gjate se 12 muaj;

Ne shumicen e ofertave (paketa bundles, pajtimi mujor i telefonit fiks dhe TVSH janë të përfshira në çmim.

Perfundim kryesor per ofertat:

- Ka nje numer te madh te ofertave (plane tarifore te ndryshme);
- Ne aspektin e perzgjedhjes, ofrojne mundesi aletrnative per pajtimtarin qe eshte e lidhur kryesisht me afatin e kontraktimit, tarifen per paketen e ofertuar sipas elementeve te ofertes. Ne kendveshtrimin e konsumatorit mund te gjykohet se ka hapësira perzgjedhjeje.

Ne lidhje me tregun e pakices te aksesit broadband internet, pershkrimin e produkteve dhe sherbimeve pjese perbere te ketij tregu, konstatohet edhe ne analize 2013 se:

- aksesin ne broadband dhe narrowband ne tregun e pakices, nuk eshte pjese e te njejtit treg;
- aksesin ne broadband ne tregun e pakices, pavaresisht kategorise se perdoruesit (familjare dhe biznes), eshte pjese perberese e te njejtit treg;

Ndersa ne lidhje me klasifikimin e aksesit ne broadband ne tregun e pakices, bazuar ne teknologjite mbi te cilat mundesohet ky akses, AKEP gjykon se teknologjite qe mundesojne akses ne broadband jane te ndryshme, por pavaresisht teknologjive te perdorura eshte e nevojshme te arsyetohet ne lidhje me nje grup karakteristikash funksionale qe te permbledhura do te bazoheshin mbi:

- ❖ Karakteristikat funksionale te lidhjes:
 - Download
 - Upload

- ❖ Tarifa Mujore
- ❖ Tarifa e Instalimit

Akesi sipas teknologjive kryesore, te cilat zene peshen kryesore te tregut te pakices te aksesit ne broadband, jane si me poshte:

- Aksesit ne broadband bazuar ne teknologjine x DSL;
- Aksesit ne broadband bazuar ne rrjete kabllore dhe lidhje te dedikuara;
- Aksesit ne broadband bazuar ne Fibren Optike;
- Aksesit ne broadband bazuar ne rrjetin GSM dhe UMTS (3G);
- Aksesit ne broadband bazuar ne Fixed Wireless Access;
- Aksesit publik nepermjet sherbimeve HotSpot ;

Edhe pas periudhes 2 vjecare ne aspektin e zevendesueshmerise per lloje te ndryshme te aksesit broadband ne nivel pakice, AKEP i qendron te njejtut konkluzion qe eshte arritur edhe ne analizen pararendese dhe konkretisht:

Konkluzioni kryesor mbi aksesin broadband ne nivel me pakice eshte:

- a. Aksesit i realizuar mbi te gjitha platformat qe shfrytezojne teknologjite XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj.), teknologjine kabllore, FWA apo teknologji te tjera qe mundesojne aksesin ne broadband nga vendodhje fikse, jane pjese te te njejtut treg.
- b. Aksesit i realizuar per te dy kategorite (familjar + biznes), ne tregun e pakices, eshte pjese e te njejtut treg.
- c. Aksesit broadband dhe narrowband nuk jane pjese e te njejtut treg perkates;
- d. Aksesit broadband me linja me qera (lidhje te dedikuuar) nuk eshte ne te njejtut treg perkates me aksesin broadband te ofruar me format e tjera;
- e. Aksesit broadband celular nuk eshte ne te njejtut treg perkates me aksesin broadband nga vendndodhje fikse (por ketu mund te konsiderohen si pjese te te njejtut treg aksesit ne broadband 3G nepermjet card modem USB dhe aksesit ne broadband internet nga vendndodhje fikse).

III.2 ANALIZE E KONKURRENCES NE TREGUN E PAKICES

Pas percaktimit te tregut te pakices per aksesin ne broadband , pershkrimet te produkteve dhe sherbimeve te ofruara ne kete treg, percaktimit te dimensionit gjeografik te tregut te pakices per aksesin ne broadband, AKEP gjykon te nevojshme te beje nje analize te ketij tregu per te identifikuar zhvillimin e konkurrences ne kete treg, fazen ne te cilen ndodhet ky treg ne Shqiperi dhe krahasimet e mundshme me tregjet rajonale dhe BE-27.

Faktoret themelor te konsideruar

Per te analizuar tregun e pakices te aksesit ne broadband , pervec kriterëve te percaktuara ne nenin 33 te ligjit 9918 (i ndryshuar), konsiderojme si faktore themelore per te vleresuar shkallen e konkurrences ne tregun e pakices te aksesit ne broadband, faktoret e meposhtem si:

- madhesine (ndarja) e tregut ne %;
- shpejtesia;
- cmimi;
- paketat bundle;

Dimensionet e tregut te pakices per aksesin ne broadband

Tregu i pakices te aksesit ne broadband ne Shqiperi ka ndjekur nje trend ne rritje kryesisht 2-3 vitet e fundit. Treguesit qe bejne te mundur vleresimin e aksesit ne tregun e pakices (numri i pajtimtareve), te orienton ne kete perfundim.

AKEP bazuar ne te dhenat e evidentuara ne menyre periodike, konstaton qe:

Ne fund te vitit 2012, penetrimi i linjave te aksesit ne broadband ne tregun e pakices eshte 7.6%. Ndersa penetrimi i aksesit ne broadband per familje eshte afërsisht 27% e familjeve.

Ne se do te vleresonim aksesin ne broadband ne tregun e pakices bazuar ne rrjete fikse, apo te njohur ndryshe si fiks broadband, rezulton qe per dy vitet e fundit, 2011 dhe 2012 te kete rritje dhe respektivisht numri i pajtimtareve me akses ne broadband (total fiks), afërsisht 140 mije per vitin 2011 dhe rreth 160 mije per vitin 2012.

Te njejtin trend rrites ka ndjekur edhe aksesi ne broadband ne rrjete celulare (duke konsideruar vetem akses ne broadband nepermjet card modem, qe ploteson kriteret e zevendesueshmerise nga ana e kerkeses me aksesin ne broadband nga rrjete fikse), numri i pajtimtareve me akses broadband mobile per vitin 2012 arriti rreth 55 mije nga 34 mije ne fund te 2011.

Gjithesesi te konsideruar se bashku Fiks + Mobile, rezulton qe numri i pajtimtareve me akses broadband ne tregun e pakices per vitin 2012 arriti ne rreth 215 mije, kundrejt 174 mije qe ishin ne fund te vitit 2011, ose e thene ndryshe qe perben nje rritje me rreth 24% ne krahasim me vitin 2011.

Pjeset e tregut te pakices per aksesin ne BB (tregu pakices)

Pjeset e tregut te pakices per aksesin ne broadband internet, jane te shprehura ne sipas numrit te pajtimtareve per aksesin ne broadband internet, te cilat ne vijim do te gjenden te ilustruara grafikisht, si dhe ne tabelen nr III.1, jane te shprehura pjeset e tregut te pakices te matura sipas te ardhurave ne kete treg, ndermjet Albtelecom dhe OA per dy vitet 2011 dhe 2012.

Pjeset e tregut ne vitin 2012, nuk kane ndryshime te ndjeshme me ato te vitit 2011. Albtelecom ka humbur pjese tregu ne aksesin broadband fiks nga 43% ne 2011 (58% ne 2010) ne 42% ne 2012. Operoretet e tjere kane shtime te vogla ne pjeset e tregut ne krahasim me shtimin ne 2011.

FIGURA III.1 PJESET E TREGUT PER AKSES BROADBAND 2011 -2012 (NUMRIT TE PAJTIMTAREVE)




FIGURA III.2. KRAHASIMI I NORMAVE TE PENETRIMIT: SHQIPERI VS MESATARE E BE27





FIGURA III.3. PJESET E TREGUT PER AKSES BROADBAND (2013/1)



Por ne se aspektin e madhësisë së tregut të pakicës, duke iu referuar ndarjes së tregut sipas të ardhurave (si një ndër parametrat kryesore që duhet konsideruar në ndarjen e tregut), rezultojnë që:

- Të ardhurat në tregun e pakicës nga shërbimi i internetit (aksesi në broadband internet) për Albtelcom dhe OA për dy vitet 2011 dhe 2012 tregojnë për rritje të të ardhurave (pjesë tregu) për Albtelcom dhe rritje të OA respektivisht, Albtelcom ka pjesë tregu në të ardhura në tregun e pakicës rreth 45% dhe OA rreth 55% në vitin 2012, kundërshtuar 47% për Albtelcom dhe 53% për OA që ishin në vitin 2011:

TABELA III.1 PJESET E TREGUT NE % SIPAS TE ARDHURAVE NE RETAIL 2011 DHE 2012

| Vitet | Te ardhurat ne tregun e pakices (vleresuar ne %) | |
|-------|---|----|
| | Albtelcom | OA |
| 2012 | 45 | 55 |
| 2011 | 47 | 43 |


Ne pjesen e tregut sipas te ardhurave ne tregun e pakices per OA (operatoret alternative), ne totalin e te ardhurave nga OA rreth 85 % te tyre e zene vetem 4 operatoret kryesore ne kete treg, Abcom, ASC, Abissnet, Primo. Ndersa 15 % te te ardhurave ne total ne tregun e pakice te OA e zene te gjithë operatorët e tjere alternative.

Krahasimi i Shqiperise me Rajonin (Cullen international)


Tarifimi per Broadband access (tarifimi mujor)

Krahasimi sipas figurave me poshte ndermjet operatorit incumbent dhe operatorëve alternative (per akses ne broadband internet pa limit).

FIGURA III.5. KRAHASIMI I TARIFIMIT NDERMJET INCUMBENT DHE OA SIPAS CI



Burimi: Cullen International (Enlargement countries monitoring report 3 - Annex – April 2013)



Burimi: Cullen International (Enlargement countries monitoring report 3 - Annex – April 2013)

Ne tregun e pakices gjenden nje numer i konsiderueshem ofertash te cila kane me shume se nje sherbim, ku perfshihen telefoni+ internet, por edhe telefoni + internet + TV; elemente te

cilet ofrohen ne treg ne opsione te ndryshme si nga koha e kontraktimit te ketyre paketava, nga menytrat e ndryshme te pageses dhe mundesohen edhe nga rrjete te ndryshme (fikse + celulare).


Nje gje e tille, ka bere te mundur rritjen e fleksibilitetit te ofertes, duke qene se per paketa te tilla gjenden ofertues te ndryshem, nje tregues i qarte qe ne tregun e pakices mund te flitet per elasticitet te dukshem ne te dy anet e kerkeses dhe ofertes.

Referuar te dhenave rezulton qe:

Numri i pajtimtareve te Albtelecom dhe OA (bazuar ne rrjetet e tyre) qe perdorin dy sherbimet baze te ofruara si pakete (telefoni + internet) eshte mbi 117 mijë, ose e thene ndryshe zene rreth 74 % te totalit te pajtimtareve me akses ne broadband internet qe ofrohet ne rrjetet fikse.

Ndersa rreth 7% eshte numri i pajtimtareve qe mbeshitetur ne rrjetet fikse perdorin tri-play (Internet+Telefoni + TV). Ne tregun e pakices ka pajtimtare qe perdorin dy sherbimet (Telefoni + TV) rreth 6.5%, ndersa (internet + tv) rreth 8% te pajtimtareve qe kane akses ne broadband internet.


FIGURA III.6 . ECURIA E PAKETAVE BUNDLES NE RRJETET FIKSE 2011-2013/1



Me siper eshte dhene nje vleresim mbi aspektin e zevendesueshmerise se kerkeses/ofertes per aksesin ne broadband te bazuar ne UMTS (3G) me aksesin ne broadband te bazuar ne rrjetet fikse, dhe eshte vleresuar qe do te merret ne konsiderate vetem aksesin ne broadband nga UMTS (3G) nepermjet card modem, pasi ka perputhshmeri ne aspektin e karakteristikave funksionale, por diferencohen ndermjet tyre ne tarifim. Nje gje e tille ka orientuar ne perfundimin se aspekti i zevendesueshmerise ne tregun e broadband ne Shqiperi duhet konsideruar pothuajse i plote, duke e konsideruar kryesisht ne anen e kerkeses.


Duke bere vleresimin ne total per dy grupet e pajtimtareve qe kane akses ne broadband internet (nga rrjete fikse dhe nga UMTS (3G)), rezulton qe:

FIGURA III.7 ECURIA E AKSESIT NE BROADBAND 3G PER 2011-2013/1



Ndersa duke vleresuar ecurine ne aksesin ne broadband internet ne tregun e pakices per dy vitet 2011 dhe 2012, ne total duke perfshire rrjetet fikse dhe UMTS (3G), rezulton grafikisht si me poshte:

FIGURA III.8 ECURIA E AKSESIT NE BROADBAND (FIKS+ 3G) PER 2011-2013/1



Duke vleresuar shifrat e mesiperme rezulton qe ne tregun e pakices tregu te aksesit ne internet broadband ka njohur ritme te mira te zhvillimit te konkurrences efektive, ne te gjithë elementet e mundshem qe shprehin tregues ne rritje te konkurrences. Perfundimi i mesiperme ne lidhje me tregun e pakices per aksesin ne broadband internet, ka ne mbeshtetje te tij nje grup faktoresh te cilet ne menyre te permbledhur mund te grupohen si:

- rritja e numrit te pajtimtareve;
- rritja e numrit te ofertave si dhe llojshmerise se tyre;
- rritja e kapacitetit te internetit te aksesuar ne broadband;
- renie te cmimit per produktet e ofruara (ose rritja e sasise se produkteve te perfituara, per te njejtin cmim);
- Rritja e mbulimit te sherbimit ne broadband internet (rrjetet fikse dhe celulare 3G);

Ne vleresimin e konkurrences ne tregun e pakices te aksesit ne broadband internet, AKEP konsideron edhe kriteret tjera te cilet jane te lidhur dhe kane impakt ne zhvillimin e konkurrences ne tregun e pakices, si:

- ekonomia e shkalles dhe densitetit;
- zhvillimi i infrastruktures egzistuese apo ndertimi paralel i infrastruktures;
- integrimi vertikal dhe horizontal;
- fuqia kundervepruese e bleresve;
- barrierat e mundshme per pajtimtaret per ndryshim rrjeti;

Faktoret e fuqise ekonomike dhe pengesave strukturore;

Pesha e faktoreve themelore, si:

- Pengesat Strukturore;

- Avantazhet ekonomike te lidhura me ekonomine e shkalles, te densitetit, apo te qenurit lojtar i pare ne treg, ne kushte e avancimit te teknologjive si dhe te rritjes se mundesive per ofrues te rinj, rezultojne me nje zbehje te dukshme per operatorin Albtelecom, i konsideruar ne analizen pararendese si perfitues i ketyre avantazheve, te cilat ndikojne ndjeshem ne aftesine ndikuese te Albtelecom ndaj ofruesve te tjere, pasi ne tregjet me pakice pervec Albtelecom dhe nje numer i konsiderueshem OA, jane aktualisht edhe rrjetet 3G, te cilet konsiderohen si ofrues potencial te aksesit te internetit broadband ne tregun e pakices, duke perdorur edhe avantazhin e mbulimit gjeografik, nje avantazh i rendesishem krahasuar me rrjetet fikse.

Rrjedhimisht faktoret e ekonomise se shkalles dhe ekonomise se densitetit duhen konsideruar si faktore me peshe gjithnje e ne rnie, gje e cila perforcon konkluzionin e arritur per tregues konkurrence ne rritje te vazhdueshme ne tregun e pakices te aksesit broadband internet.

Konkluzioni eshte se:

Pavaresisht historikut te Albtelecom, si dhe konsiderimit te avantazheve ekonomike te lidhura me ekonomine e shkalles, te densitetit, apo te qenurit lojtar i pare ne treg, ne tregun e pakices te aksesit te broadband internet, faktoret e mesiperme jane ne favor te konkurrences efektive dhe zhvillimit te metejshme te saj.

Fuqia kundervepruese e bleresve dhe barrierat e mundshme per ndryshim rrjeti

Faktori Fuqi Kundervepruese per blerjen ne tregun me pakice te aksesit broadband, eshte nje faktor qe ka peshen e vete specifike, pasi prezenca e shume ofruesve te rinj si dhe mundesia e perdorimit te teknologjise 3G dhe ofrimit nepermjet saj (petencialisht rrit mundesine e ofrimit ne zona gjeografike ku mungon prezenca e rrjeteve fikse), perben nje shtyese te konsiderueshme nga pala blerese per te rritur presionin ne negociatat e mundshme.

Ne mbeshtetje te ketij perfundimi mund te vlejje edhe fakti qe tregu mundeson nje game ofertash (gje e cila rrit shkallen e presionit pozitiv ne favor te bleresit, ne negocim me palet).

Ne kete menyre, potencialisht ne shumicen e zonave te mbulimit me broadband internet, ka me shume se nje ofrues dhe nisur nga fakti qe kjo shoqerohet edhe me nje game ofertash (kryesisht fleksibel), per rrjedhoje, egzistojne mundesite e ndryshimit te rrjetit, ne rast te mungeses se elasticitetit te ofertes.

AKEP veren se, ne periudhen 2011-2012, per secilin nga faktoret e mesiperme ka ndryshime pozitive ne favor te rritjes se konkurrences ne tregun e pakices per aksesin ne broadband internet.

Pritshmerite per tregun e pakices ne te ardhmen

Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet aktualisht ndodhet ne kushte e nje konkurrence gjithnje e ne rritje, por duke marre ne konsiderate nje grup faktoresh si:

- Objektivi Shteteror, per te konsideruar zhvillimin e rrjeteve broadband si nje nder elementet themelor qe do te paraprije zhvillimin ekonomik dhe social;
- Rritja e investimit kryesisht ne rrjetet dhe infrastrukture broadband qe kane per baze IP, per te furnizuar me internet me shpejtesi te larte;
- Liberalizimit te plote te tregut te aksesit ne broadband;
- Efektet e nderhyrjeve rregullatore ne zhvillimin e konkurrences efektive dhe reduktimin e cmimeve;
- Rritja e penetrimit te internetit broadband;
- Rritja e kerkeses per sherbime publike te bazuara ne broadband internet;
- Rritja e cilesise se sherbimeve si dhe llojshmerise se ofertes (ne kapacitet si dhe elementeve perberes te saj);

Keshtu qe duke vleresuar fazen aktuale ne te cilen ndodhet zhvillimi i tregut broadband si dhe referuar faktoreve te mesiperme, parashikimet per rritjen e kerkeses konsumatore per sherbime qe bazohen ne internet broadband, AKEP ka pritshmeri pozitive per zhvillimin e tregut te pakices te aksesit ne broadband internet ne nje periudhe afatmesme, duke arritur tregues cilesore ne kete aspekt.

Konkluzioni ne tregun me pakice te aksesit ne broadband

Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet, bazuar ne vleresimet e te dhenave te tregut te prezantuar sa siper, ka tregues te qarte te rritjes te konkurrences (sidomos ne dy vitet e fundit), gje per te cilen mund te arrihet ne perfundimin tregu i pakices te broadband internet, ndodhet ne kushte e nje konkurrence gjithnje e ne rritje si ne rrjetet fikse (si ofruet kryesore) te aksesit ne broadband internet ne tregun e pakices, por edhe ne rrjetet mobile bazuar ne teknologjine 3G.

Si rezultat i konkurrences ne rritje nder te tjera vihet re dhe rritja e ofertes ne treg, llojshmeria e ofertes e cila evidentohet ne nje larmi paketash te ofruara ne treg nga ofruet e internetit pavaresisht rrjetit mbi te cilin ofrohet akses ne broadband internet (fiks apo mobile 3G), gje cila ka bere te mundur rene te cmimeve si dhe rritje te games se sherbimeve te konsumuara per te njejtin cmim per perdoruesin.

Duke vleresuar sa siper per tregun e pakices te aksesit ne broadband, konkludojme se:

Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet ka ritme te mira zhvillimi te konkurrences, eshte dinamik dhe ka premisa te forta per nje konkurrence gjithnje e ne rritje. Megjithate niveli i penetrimit te aksesit broadband nga vendodhje fikse ne Shqiperi eshte ne nivele te uleta krahasuar me BE-ne dhe Rajonin. Kjo ben te nevojshme analizimin e tregjeve me shumice te aksesit broadband per nderhyrje te mundshme rregullatore per te stimuluar me tej rritjen e penetrimit te aksesit broadband.

IV. ANALIZE E TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE BROADBAND

Ne seksionin II.3.2, eshte referuar nje permbledhje mbi perfundimet kryesore te analize 2011 per tregun me shumice te aksesit ne broadband.

Ne vijim te kesaj permbledhje AKEP beri nje pershkrim te detajuar te produkteve dhe sherbimeve te aksesit ne broadband ne tregun e pakices, duke identifikuar ofertuesit kryesore ne kete treg, llojet e ofertave si dhe duke bere nje analize te konkurrences se mundshme ne tregun e pakices te aksesit ne broadband internet.

Perfundimet kryesore te arritura ne analizen e tregut te pakices te aksesit ne broadband per fazen ne te cilen ndodhet konkurrenca ne kete treg, gjenden te detajuara ne seksionin perkates te cituar me siper.

Ne lidhje me tregun me shumice te aksesit ne broadband internet, strukturimi ne kete seksion eshte si ne vijim:

- Ne pjesen e pare te tij, do te paraqitet perkufizimi i ketij tregu, ne termat e percaktimit te produkteve dhe sherbimeve te tij, si dhe ne aspektin e shtrirjes gjeografike te ketyre produkteve dhe sherbimeve qe gjenden ne kete treg.
- Ne pjesen e dyte te ketij seksioni, do te trajtohet analiza per FNT, konkurrenca e mundshme ne kete treg dhe ecuria e zhvillimit te tij se bashku me prespektiven e mundshme te zhvillimit te ketij tregu ne nje periudhe afatmesme, duke identifikuar ne se ka apo jo operator dominues ne kete treg qe mund te demtojne zhvillimin e konkurrences efektive.

ose ne nje menyre te permbledhur do te gjeni:

- Perkufizimin mbi tregun e shumices te aksesit ne broadband;
- Dimensionin e produkteve dhe/ose sherbimeve ne kete treg;
- Kerkese/oferta ne kete treg dhe aspekti i zevendesuesmerise;
- Bitstream akses nga vendodhje fikse dhe produktet e mundshme ne varesi te nivelit te aksesit per kete sherbim;

NDRYSHIMET NE RRJETIN E ALBTELECOM

Bazuar ne ndryshimet e ndodhura ne treg si ndryshimet ne rrjetin Albtelecom per migrimin nga rrjeti tradicional fiks ne rrjet NGN, duke qene se ka zhvillime te ndjeshme ne infrastrukturen e tij ne krahasim me infrastrukturen tradicionale, duke bere shndërrimin e tij nga teknologjia TDM me sisteme dhe pajisje të reja të teknologjisë IP.

Investime te tilla kane bere te mundur ndërtimin e një rrjeti të ri, të quajtur NGN (Rrjeti i Gjeneratës Tjetër). Rrjeti NGN nënkupton një teknologji dhe një strukturë me efikase ne të gjithë elementët e një rrjeti , duke përfshirë edhe atë qendror, të transportit dhe të aksesit , më konkretisht. Kjo ka bere te mundur shtimin e një game të gjerë shërbimesh të reja te cilat aktualisht jane te aksesueshme per perdoruesin fundor.

Ndryshimet kryesore konsistojne ne a) Rrjetin e Transportit dhe b) Rrjetin e aksesit;

Rrjeti i Transportit

Ndërtimi i rrjetit të ri IP/MPLS (IP Multiprotocol Label Switching) është bërë i mundur duke instaluar dhe vendosur në shfrytëzim nyja të reja, bazuar në teknologjinë IP/MPLS në të gjitha qendrat e vendit tonë. Kjo do të thotë se për shkëmbimin e informacionit midis qendrave jo vetëm ofrohet shpejtësi më e madhe, por edhe siguri më e lartë. Përdorimi i teknologjisë së re DWDM (Dense Multiprotocol Label Switching) ofron kapacitete të mëdha për linjat e transmetimit, sidomos midis qendrave brenda vendit dhe me vendet e tjera.

Në të gjithë pikat kryesore të rrjetit, përdorimi i sistemeve të reja DWDM mbi rrjetin me fibër optike siguron shpejtësi transmetimi të niveleve të ndryshme si psh. : STM16, 10 Gbit/s, ose 40 Mbit/s. Rrjeti aktual është projektuar të sigurojë një kapacitet transmetimi deri 40 λ (lampdas)/ 10G.

Rrjeti i transportit bazohet në një rrjet fibrash optike të shtrira në të gjitha qendrat e Shqipërisë, me një gjatësi totale prej rreth 2400 km. Gjithashtu, ky rrjet siguron shkëmbimin e informacioneve në drejtime të ndryshme për efekt sigurie dhe mbrojtjeje, duke përdorur unazat mbrojtëse të krijuara nga rrjeti me fibër optike.

Implementimi për herë të parë i sistemeve mikrovalore bazuar në teknologjinë IP përbën një arritje të madhe për këtë sektor. Rrjeti Albtelecom ka në përdorim sisteme mikrovalore me kapacitete që arrijnë deri në 1.6 Gb/s. Një teknologji e tillë vazhdon të zhvillohet dhe synimi është implementimi në të gjitha drejtimet ku trafiku e kërkon një gjë të tillë dhe aty ku shtrirja e fibrës optike nuk është e mundur.

Rrjeti i Aksesit

Investimet e kryera në rrjetin e aksesit, që nenkupton akses të abonentit me rrjetin e Albtelecom, ka bërë të zgjerimin e gamës së shërbimeve që ofrohen për përdoruesin si dhe në të njëjtën kohë ka rritur shpërndarjen dhe mbulimin më të mirë të zonave. Duke instaluar dhe vendosur në shfrytëzim me qindra nyja aksesit si: Nyja Aksesit Shumë-Shërbimesh MSAN (Multi Service Access Node), bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve si: PSTN, ADSL, ADSL 2+, VDSL, ISDN, SHDSL etj.


Në të tjera investimet në NGN, mundesojnë përdorimin e shërbimeve me brez të gjerë. Në aspektin e kapacitetit, investimi i kryer ka bërë të mundur që rrjeti i aksesit nga një kapacitet prej rreth 400,000 linjash, tashmë ka arritur shifrat e 650,000 linjash, çka do të thotë se rrjeti është i gatshëm të suportojë menjëherë një shifër të tillë përdoruesish.

Disa nga aspektet kryesore të rrjetit NGN:

- Transferimi bazuar në paketa;
- Ndarja e funksioneve të kontrollit midis aftësive bartese, thirrje/sesion dhe aplikacion/shërbim;
- Ndarja e ofrimit të shërbimit nga transporti dhe ofrimi i nderfaqeve të hapura;
- Mundësimi i një game të gjere shërbimesh, aplikacionesh dhe mekanizmash bazuar në blloqet perberes te shërbimeve (përfshirë shërbime në kohë reale/streaming/në kohë jo-relae dhe multi-media);
- Nderfunksionimi i rrjeteve tradicionale nepermjet nderfaqeve e hapura;

- Pavaresia e funksioneve te lidhura me sherbimin nga teknologjia e transportit te tij;
- Mundesine e perdorimit te teknologjive te shumta ne segmentin fundor (last mile);

KONVENCIONE NDERMJET RRJETEVE TRADICIONALE DHE NGN



IV.I PERKUFIZIMI I TREGUT

Ne kete dokument analize, tregu me shumice per aksesin ne broadband internet eshte percaktuar si nje treg i mundshem per t'u analizuar dhe eshte pjese e listes se tregjeve edhe ne Rekomandimin 2007 te KE-se.

Keshtu qe, ne lidhje me perkufizimin e ketij tregu, AKEP konstaton se ky treg eshte njeri prej tregjeve qe ndodhet ne Rekomandimet e KE si dhe ne listen e tregjeve te percaktuara nga AKEP, treg i cili eshte i percaktuar si tregu me shumice te aksesit ne broadband.

Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregut me shumice te aksesit ne broadband

AKEP, ne lidhje me aksesin ne tregun me shumice te aksesit ne broadband, te cilat ishin te specifikuar si lloje te ndryshme aksesit ne varesi te teknologjise se perdorur eshte ne te njejten linje arsyetimi dhe trajtimi te bere ne analize pararendese.

Pershkrimi i produkteve dhe sherbimeve bazohet ne trajtimin dhe analizen e kerkeses te fokusuar ne aspektin e zevendesueshmerise se saj, ndermjet produkteve dhe sherbimeve qe mund te jene potencialisht pjese perberese te tregut qe analizohet, duke konsideruar zhvillimet e mundshme si dhe prespektiven e tyre afatmesme.

Trajtimi i aspektit te zevendesueshmerise se kerkeses, ka zanafillen e saj ne tregun e pakices dhe ne kete aspekt nuk mund te lihen jashte trajtimin teknologjite e ndryshme te cilat mundesojne aksesin, prej te cilave lejohet te arsyetohet ne se mund te jene te zevendesueshme apo jo ndermjet tyre ne anen e kerkeses, per te zgjeruar me pas ne menyre analoge se sa egzistojne mundesite e zevendesueshmerise ne anen e ofertes.

Duke gjykuar se nje nga llojet kryesore te aksesit ne broadband internet ne tregun e pakices eshte aksesin i bazuar ne teknologjine X DSL (mbi rrjet fikse), dhe duke e trajtuar kete teknologji ne nje zevendesim te vazhdueshem edhe me teknologji te tjera si fiber dhe

frekuenca valore, atehere mund te konstatohet qe aspekti i zevendesueshmerise te kerkeses ne tregun e pakices eshte i mundshem nga ofertues te ndryshem ne kete treg.

Pyetja e shtruar eshte ne se, mund te konsiderohet qe aksesit ne broadband ne tregun e shumices mbi teknologjite e cituara me siper, eshte pjese e te njejtin treg ne nivelin e shumices, pra;

- Aksesit i realizuar mbi te gjitha platformat qe shfrytezojne teknologjite XDSL (ADSL, ADSL 2+, etj.), teknologjine kabllore, FWA apo teknologji te tjera qe mundesojne aksesin ne broadband bejne pjese te te njejtin treg te shumices.

Zevendesimi ne anen e kerkeses – ne tregun e shumices te aksesit ne broadband

Aspekti i zevendesueshmerise persa i perket anes se kerkeses ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, duhet te mundesojte zevendesimin e sherbimit te bazuar ne X teknologji me te njejtin sherbim te bazuar ne teknologjine Y, si nje sherbim te vlefshem ne tregun e shumices te aksesit ne broadband per perdoruesit e ketij sherbimi te cilet duhet te marrin ne konsiderate:

- cmimin te ketij sherbimi per te patur akses ne infrastrukturen sipas teknologjise zevendesuese, duke perdorur sherbimin e aksesit ekuivalent ne kete treg;
- funksionalitetin duke analizuar karakteristikat teknike perkatese;
- pikat e mundshme te interkonektimit (aksesit te mundshem) si dhe mbulimin gjeografik me produkte dhe/ose sherbime;

Ne se zevendesueshmeria arrihet ne nivelin e shumices te aksesit ne broadband, atehere nje zevendesueshmeri e tille transferohet edhe ne tregun e pakices nepermjet dy menyrave:

- a) Te vetefurnizimit;
- b) Te dhenies se aksesit per te tretet ne infrastrukturen egzistuese;

Edhe ne analize pararendese eshte trajtuar fakti ne se eshte e domosdoshmerisht e nevojshme qe per te mundesuar akses per perdoruesin fundor ne tregun e pakices, nje ofrues duhet patjeter te kete rrjet te vetin te ndertuar, apo ka menyre te tjera qe te mundesojne ofrimin e aksesit per perdoruesin fundor.

Ne se nje operator deshiron te furnizojte me akses ne broadband perdoruesin fundor ne nivelin e pakices, jo domosdoshmerisht duhet te kete infrastrukture ne pronesi, pasi mund te perdore sherbimin e aksesit ne nivelin e shumices.

Keshtu qe ne te njejtin linje arsyetimi te perdorur edhe ne analize 2011, kjo edhe ne dakortesi me Rekomandimin e Komisionit European ne tregjet e mundshme per rregullime ex-ante, per te mundesuar sherbimin e aksesit per perdoruesin fundor (tregu i pakices), eshte trajtuar sherbimi "bitstream akses" nga nje vendodhje fikse, i trajtuar si nje nga sherbimet e tregut te shumices te aksesit ne broadband.

Sherbimi i Bitstream akses, NGA dhe NGN


Pershkrimin e detajuar te produktit bitstream akses dhe pikat e mundshme te aksesit sipas nivelit hirearkik te rrjetit eshte dhene ne analize 2011 (nje pjese te te cilit per lehtesi arsyetimi per lexuesin mund te referohet ne analizen 2011 fq. 63-69), pasi AKEP gjykon te arsyeshme

qe per trajtimin e sherbimit bitstream akses nga nje vendodhje fikse, te mos perserise te njejtin arsyetim dhe pershkrim te perdorur edhe ne analize pararendese.

Duke gjykuar ndryshimet e ndodhura ne rrjetin e operatorit Albtelecom, i percaktuar si operator me FNT per kete sherbim ne analize 2011, nder te tjera mund te themi qe:

Per te shfrytëzuar sherbimin bitstream akses, operatorët alternative (apo te njohur ndryshe si perfitues te sherbimit bitstream akses), do te jene perballe mundesise per te perzgjedhur aksesin ne rrjetin e Albtelecom sipas kater pikave te percaktuara ne nivelin hirearkik te rrjetit dhe me pas do te jete e mundur qe te ofrohet per perdoruesin fundor (ne tregun e pakices), paketa e sherbimit te internetit te cilen operatori alternative ka per synim te ofroje.

SKEMA IV.1: HIREARKIA E AKSESIT NE RRJET PER BITSTREAM




Burimi: ERG Common Position on wholesale bitstream access

Duke qene se tregu ndodhet ne kushte te tilla ku kryesisht ne dy vitet e fundit ka investime te medha ne rrjete (kryesisht Albtelecom ne NGN), por edhe nje grup operatorësh alternative kane rritur investimin ne rrjetet e tyre te bazuar kryesisht ne nivel IP, kjo ben te mundur qe ne varesi te koston (pjeses se rrjetit te shfryezuar), te percaktohet edhe kerkesa per sherbimin bitstream akses.


Investimet ne NGA (Next Generation Access), ne vitet e fundit konsiderohen si investime serioze ne rrjete, te cilat mundesojne akses ne broadband me kapacitete dhe shpejtesi shume te larte. Nje gje e tille mundesohet ne se rrjetet zevendesohen potencialisht si rrjete NGA, qe ne kuptimin e pergjithshem nenkupton zevendesimin e rrjeteve te bazuara ne tela bakri (rrjete tradicionale dhe historike) ne rrjete qe kane per baze teknologjine e fibres, sipas hirearkise ne shtrirjen e saj, FTTH (Fibre-To-The-Home), FTTN (Fibre-To-The-Node), FTTC (Fibre-To-The-Cabinet).

SKEMA IV.2: ARKITEKTURA DHE ELEMENTET E RRJETIT NGA



Burimi: BEREC

SKEMA IV.3 : RRJETI NGA – OPSIONE TE AKSESIT TE HAPUR



Burimi: BEREC

Infrastruktura te reja paralele per aksesin broadband internet

Ne kushtet e rritjes se investimeve te operatoreve te ndryshem brenda te njejtës zone gjeografike, atehere kjo perben edhe nje mundësi reale per zbehjen e kerkesave te mundshme per sherbimin e bitstream akses dhe ky arsytim ilustruhet edhe duke marre ne konsiderate faktin qe Altelecom eshte operator me FNT dhe ndaj te cilit jane vendosur detyrime rregulatore per ofrimin e sherbimit bitstream akses.

Nga informacionet e derguara ne AKEP, rezulton qe nuk ka kerkesa te refuzuara nga Altelecom per kete sherbim gjate kesaj periudhe kohore qe nga analiza pararendese.

Por gjithësesi, pavaresisht faktit ne se ne treg ka kerkesa per sherbimin bitstream akses apo jo deri ne momentin e kryerjes se kesaj analize, duke gjykuar nga objektivi themelor per rritjen e mundësive te aksesit ne broadband internet si dhe faktin qe faktoret per ndertimin e infrastrukturave te reja paralele si:

- Koha e gjate per ndertimin e infrastruktures, e cila mund te jete zevendesuese e infrastruktures se operatorit incumbent;
- Kostot e ndertimit;
- Densiteti i perdoruesve te mundshem qe do te aksesoheshin ne kete infrastrukture (qe do te thote nje parashikim i mundshem per kerkesat qe do te jene ne zonen perkatese te ndertimit te infrastruktures);

AKEP gjykon te arsyeshme se ky grup faktoresh te konsideruar te nevojshem do te percaktonin edhe strukturen e cmimit te ofrimit te ketij sherbimi dhe per rrjedhoje edhe nevojten per t'u konsideruar ne se duhet te kete apo jo vemendje rregullatore ne percaktimin e sherbimit te bitstream akses si nje sherbim i nevojshem per nderhyrje ex-ante, me objektivin themelor per te sherbyer si nje shtyese ne rritjen e aksesit ne broadband internet, pasi cdo element barriere te mundshme (cilado qofte natyra e saj, strukture, ligjore, rregullatore etj), ne ndertimin e infrastrukturave paralele (zevendesuese te operatorit incumbent), do te sherbenin si pengese per mundesine e sherbimit zevendesues per sherbimin e bitstream akses.

Vetefurnizimi ne sherbimin e aksesit ne broadband

Vetefurnizimi, eshte konsideruar si nje faktor i rendesishem dhe me peshe te vecante ne zhvillimin e konkurrences, pasi ajo varet kryesisht nga shtrirja gjeografike e rrjetit dhe sherbimit qe vetefurnizohet dhe per rrjedhoje kjo percakton edhe hirearkine e tregjeve (vertikale).

Ne arsyetimin e trajtimit te lidhjes vertikale te tregjeve, arsyetimet e perdorura ne menyre hipotetike se rritja e cmimit ne ofrimin e sherbimit X qe ofrohet ne nivel shumice per operatorin qe aksesohet ne nivel shumice, do te transferonte ne menyre llogjike rritje te cmimeve ne tregun e pakices per perdoruesit fundor. Ne kete rast perdoruesi fundor duke u perballur me rritje te cmimit per aksesin e kontraktuar te bazuar ne sherbimin bitstream akses te ofruar nga operatori ofertues qe ka akses ne nivel shumice ne rrjetin e operatorit incumbent, perdoruesi fundor do te orientohet drejt sherbimeve qe ofron operatori incumbent si nje mundesi per te perfituar cmim me te mire.

Keshtu qe operatori i aksesuar ne infrastrukturen e operatorit incumbent per sherbimin e bitstream akses, ne rast te nje rritje te mundshme te cmimit ne kete nivel, ne mungese te alternativave te tjera per te ofruar akses ne tregun e pakices, do te percaktonte ne te vertete peshen e faktorit te "vetefurnizimit" per nje sherbim te caktuar, pasi nje gje e tille do te shfaqte nje tendence per te mbajtur perdoruesin fundor duke mos i ndryshuar cmimin e sherbimit te aksesit te ofruar.

Per kete arsye "vetefurnizimi" eshte konsideruar ne analizat e tregjeve por edhe nga qendrimet te perbashketa ERG (BEREC), si nje mundesi qe perdoruesi fundor mund te jete pre e presionit te operatorit incumbent (apo operatorit vetefurnizues).

Nder te tjera, pavaresisht faktit ne se ka apo jo kerkesa per sherbimin bitstream akses, ne zona gjeografike ku operatoret ofrojne sherbimin e aksesit ne broadband per qellime vetefurnizimi, presioni konkurrues ne nivel pakice eshte i rendesishem, dhe per rrjedhoje ne mungese te detyrimeve qe mund te ishin ndaj operatorit incumbent, per t'u mos lejuar te ofronte keto sherbime poshte nje niveli te caktuar cmimi, por gjithesesi kjo nuk do te perberte zgjidhje te situates.

Ndaj arsyetimi i mesiperme është edhe në mbështetje të faktit që vendndja rregullatore në kushtet aktuale të zhvillimit të kësaj analize, të jetë jo kaq shumë e mbështetur në numrin e kërkesave për këtë shërbim, por kryesisht duke e trajtuar me rëndësi pragmatiste si një shërbim konkurrues dhe presion ndaj shërbimit të vetefurnizimit për efekte të metejshme pozitive në zhvillimin e konkurrencës gjithnjë e më shumë në tregun e pakicës.

Zevendesimi në anën e ofertes

Në trajtimin e bërë në analizë pararendëse, është konsideruar se zëvendësueshmëria në anën e ofertes për shërbimin e aksesit në broadband, akses i cili bazohet në bitstream akses për tregun e shumicës do të ishte potencialisht i mundur nëse kjo realizohej pa kosto të rëndësishme shtese.

Sa është e mundur një zëvendësueshmëri e tillë, duke marrë në konsideratë një rrjet me baze pajtimtarësh të cilët në nivelin e pakicës mund të kërkonin shërbimin e aksesit në internet nga ndonjë operator tjetër (për arsye të ndryshme të pajtimtarit), në kushtet kur kjo ofertë të bëhej atraktive për pajtimtarin do të ishte pothuajse e pamundur që të ishte e tillë nëse operatori alternativ zgjidhjen e vetme do të kishte aksesin në nivelin e shumicës tek operatori ofrues (operatori incumbent, zotëues i rrjetit).

Në aspektin e zëvendësueshmërisë në anën e ofertes, AKEP arsyeton se:

Shërbimet alternative të bitstream akses duhen konsideruar me zëvendësueshmëri të plotë në zonat gjeografike në të cilat kemi dublime infrastrukture për ofrimin e shërbimit të aksesit broadband internet, dhe nëse nëqelë për të konsideruar shërbimin “bitstream akses”, të nevojshëm për nderhyrje ex-ante në zonat gjeografike në të cilat nuk mundësohet dublimi i infrastruktures që mundëson akses në broadband internet.

Konkluzion mbi tipet e aksesit të bitstream sipas niveleve

Shërbimi “Bitstream akses”, u konsiderua si një produkt i shitjes me shumicë që nëpërmjet linjave të aksesit të operatorit ofrues të këtij shërbimi, të mundësohet dhënia e kapacitetit të transmetimit me qëllim shitjen e shërbimit të Internetit si dhe shërbime të tjera (kryesisht shërbime me vlerë të shtuar).

Referuar përcaktimeve dhe ilustrimeve të mesiperme, në lidhje me shërbimin bitstream akses, shërbim i cili përfshin pikat që lejojnë kalimin e trafikut midis operatorit furnizues me shërbime dhe operatorit që përdor këto shërbime, pavarësisht teknologjisë mbi të cilën mundësohet aksesin duke konsideruar si pikë aksesit pikat e mëposhtme, në tregun e shumicës të aksesit në broadband, sipas përshkrimeve të bëra më sipër mund të konkludohet se, produktet bitstream në varësi të nivelit të aksesit në hierarkinë e rrjetit grupohen si më poshtë:

- Bitstream në nivel DSLAM;
- Bitstream në nivel Ethernet;
- Bitstream në nivel IP;
- Rishitje (shërbimet e ofruara nga vetefurnizimi, pavarësisht teknologjisë së përdorur);

Dimensioni gjeografik i tregut të shumicës për aksesin në broadband

Aspekti i dimensionit të produkteve dhe/ose shërbimeve të ofruara, si dhe shtrirja e mundshme gjeografike nuk ka asnjë ndryshim nga përcaktimet e bëra në analizë 2011, për rrjedhojë në përputhje edhe me përcaktimet e Udhezimit të KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 citojnë midis të tjerave se dimensionin gjeografik të tregut përkates përfaqëson zonën gjeografike në të cilën operojnë sipërmarrësit ofrues dhe kërkues të shërbimeve, zona e cila ka kushte të ngjashme të konkurrencës, si dhe praktiken tradicionale të përcaktimit të tregjeve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në bazë të zonave të mbuluara nga rrjeti.

Pra:

- *Dimensioni gjeografik i shërbimit të aksesit në broadband në tregun e shumicës, është territori i Republikës së Shqipërisë.*

Për sa më me sipër, përcaktimi i tregut me shumicë të aksesit në broadband përfaqëson:

- **Tregu me shumicë aksesit në broadband;**
- **Dimensioni gjeografik i tregut është kombëtar;**

IV.2 Analiza për Fuqi të Ndjeshme në Tregun me shumicë të Broadband

Në analizën që kryhet për FNT, ka të përcaktuara një sërë kriteresh me referencë ligjin 9918 (i ndryshuar), direktiva dhe rekomandime të BE-së, si dhe qëndrime të përbashkëta nga BEREC, kryesisht për tregjet broadband dhe domosdoshmerinë e zhvillimit të tyre.

AKEP para se gjithash i kushtoi një rëndësi të vecantë analizës së tregut të aksesit broadband në nivelin e pakicës dhe në përfundim arriti në konkluzionin se:

Tregu i pakicës të aksesit në broadband internet ka ritme të mira zhvillimi të konkurrencës, është dinamik dhe ka premisa të forta për një konkurrencë gjithnjë e më të rritur. Megjithatë niveli i penetrimit të aksesit broadband nga vendodhjet fikse në Shqipëri është në nivele të ulëta krahasuar me BE-në dhe Rajonin. Kjo bën të nevojshme analizimin e tregjeve me shumicë të aksesit broadband për nderhyrje të mundshme rregullatore për të stimuluar më tej rritjen e penetrimit të aksesit broadband.

Pesha kryesore në qëndrimin apo vëmendjen rregullatore në tregjet e nivelit të shumicës, duhet të ketë si zanafillë fazën në të cilën ndodhet zhvillimi i konkurrencës në tregjet e shtrira vertikalisht, pra tregjet në nivelin e pakicës ose e the në ndryshe në tregjet në të cilët mundësohet aksesit për përdoruesin fundor.

Për të arritur në konkluzionin se cila është faza e zhvillimit të konkurrencës, duhen analizuar një grup faktorësh, ku ndër më kryesoret vlerësohen:

- madhësia e tregut, pjesët e tregut;
- fazën në të cilën ndodhet zhvillimi i këtij tregu në Shqipëri;

- pengesat e mundshme per te hyre ne kete treg dhe analize e barrierave te natyres strukturore;
- fuqine kundervepruese te bleresve;
- analize e tarifimit si dhe krahasimi me rajonin dhe BE-ne;
- etj (arsyetime dhe faktore te tjere ndihmes);

Ne aspektin e percaktimit ligjor ne lidhje me kriteret qe do te perdoren per analize 2013 edhe ligji 9918 (i ndryshuar) nuk sjell ndonje specifike te re te ndryshme nga ato qe jane perdorur ne analize 2011, por pesha kryesore e arsytimit per kete analize do te fokusohet tek zhvillime te reja te ndodhura ne kete treg, ku nder me kryesoret duhen konsideruar:

- investimet ne rritje ne infrastrukturat individuale te rrjeteve te operatoreve alternative;
- rritja e mundesive per akses ne broadband nepermjet teknologjive te tjera (perfshire edhe 3G);

I. Pjeset e tregut

Per sa i perket madhesis se tregut te shumices per aksesin ne broadband internet, duke iu referuar ndarjes se tregut sipas te ardhurave (si nje nder parametrat kryesore qe duhet konsideruar ne ndarjen e tregut), rezulton qe:

Te ardhurat ne tregun e shumices nga sherbimi i internetit (aksesi ne broadband internet) per Albtelecom dhe OA per dy vitet 2011 dhe 2012 tregojne per renie te te ardhurave (pjeset tregu) per Albtelecom dhe rritje te OA respektivisht, Aktualisht per Albtelecom rezulton qe ka pjeset tregu ne te ardhura ne tregun e shumices rreth 87 % dhe OA rreth 13 % ne vitin 2012, kundrejt 93 % per Albtelecom dhe 7 % per OA qe ishin ne vitin 2011:

TABELA IV.2: PJESET E TREGUT NE % SIPAS TE ARDHURAVE NE WHOLESALE 2011 DHE 2012

| Vitet | Te ardhurat ne tregun e shumices ((vleresuar ne %) | |
|-------|---|----|
| | Albtelecom | OA |
| 2012 | 87 | 13 |
| 2011 | 93 | 7 |

Ne vijim do te trajtohen faktoret e tjere, pasi vetem faktori “pjeset tregu”, nuk eshte i mjaftueshem per te konkluduar ne se ka apo jo FNT, ne j sipermarres.

II.Vleresimi per barrierat ne hyrje ne tregun me shumice te aksesit ne broadband

Ne aspektin ligjor dhe rregullator aktualisht nuk ka barriera te larta dhe te pakalueshme per hyrjen ne tregun e shumices te aksesit ne braodaband internet, per rrjedhoje edhe ne ndertimin e infrastrukturës backbone, apo mundesine per akses ne nivel shumice.

Duke vleresuar si pengesa te mundshme te klasifikuara ne pengesa strukturore (perfshire ato ekonomike), si pengesa te kushtezuara nga teknologjia dhe parimi asnjanesise teknologjike.

Ne mbeshtetje te ketij arsytimi vlen te kujtohet fakti qe aktualisht ne Shqiperi gjenden me shume se nje operator qe ka rrjet backbone kombetar, apo rrjet “core” te zhvilluar ne dimensione te krahasueshme me Albtelecom, duke rritur mundesine per akses ne nivel shumice per akses ne braodaband internet.

Faktoret themelor te konsideruar per hyrjen ne kete treg

Pesha e faktoreve themelore te perdorur ne analizen pararendese, si:

- Pengesat Strukturore;
- Avantazhet ekonomike te lidhura me ekonomine e shkalles, te densitetit, apo te qenurit lojtar i pare ne treg, ne kushte e avancimit te teknologjive si dhe te rritjes se mundesive per ofrues te rinj, rezultojne me nje zbehje te dukshme per operatorin Albtelcom, i konsideruar ne analizen pararendese si perfitues i ketyre avantazheve.

Ndaj ne aspektin konkurrues, per hyrjet e mundshme ne kete treg, rritjes se mundesive konkurruese te operatoreve alternative egzitues, apo edhe hyrjeve te reja te mundshme, duhen konsideruar si faktore te qenesishem dhe qe kane rezultuar ne nje mase te konsiderueshme ne zvoglimin e dominances se Albtelcom, per te gjithë faktoret e cituar me siper, apo ne analogji edhe me konkluzione te arritura nga vende te tjera qe kane marre ne konsiderate avancimet e teknologjise (kryesisht 3G), si percaktuese edhe ne kete treg.

III. Fuqia kundervepruese e bleresve

Faktori Fuqi Kundervepruese per blerjen ne tregun me shumice te aksesit ne broadband internet, eshte nje faktor qe duhet marre ne konsiderate, pasi prezenca e ofruesve te rinj si dhe mundesia e perdorimit te teknologjise 3G dhe ofrimit nepermjet saj, perben nje shtyese te konsiderueshme nga pala blerese per te rritur presionin ne negociatat e mundshme me Albtelcom.

Keshtu qe do duhet te konsiderohet fakti qe pozita e nje operatori, qe eshte dominant ne ofrimin e nje sherbimi, mund te jete me e dobet nese ekzistojne bleres te sherbimit, te cilet zoterojne fuqi te larte negociuese. Fuqia e larte negociuese eshte rezultat, kryesisht, i sasise se madhe te sherbimit te kerkuar nga pala blerese, dhe interesit te shitesit per te mos humbur kete klient, pasi mundesia per te gjetur zgjidhje tek ofrues te tjere, ekziston.

Konkluzioni paraprak ne lidhje me grupin e faktoreve si:

- Vleresimi i barrierave te natyres strukturore;
- Vleresimi i fuqise kundervepruese te bleresve;
- Vleresimi i natyres se integritit vertikal dhe horizontal;
- Vleresimi i faktoreve avantazhues te ekonomise (te shkalles dhe densitetit);

eshte si ne vijim:

Pavaresisht historikut te Albtelcom, si dhe konsiderimit te avantazheve ekonomike te lidhura me ekonomine e shkalles, te densitetit, apo te qenurit lojtar i pare ne treg, por edhe faktit te mungeses se prezences se plote te Albtelcom ne tere territorin e vendit, lejon hapesirat e duhura edhe per ofrues te tjere, konstatimi i pare eshte se jemi ne kushtet kur identifikohet nje renie te dominances se Albtelcom. Por duke gjykuar ne prespektiven e zhvillimit te metejshem te tregjeve te aksesit ne broadband internet, ky grup faktoresh te trajtuara edhe ne analizen e tregut te pakices per aksesin ne broadband internet, pavaresisht zbehjes se ketyre faktoreve te konsideruar te rendesishem ne vleresimin e dominances se Albtelcom, per te gjykuar mbi nje peshe te vecante te Albtelcom ne raport me OA, te kombinuar me faktoret e madhesise se tregut (pjeses se tregut per sherbimin bitstream akses).

perseri jane faktore qe duhen konsideruar dhe vleresuar ne prespektiven e zhvillimit te tregjeve broadband ne Shqiperi.

IV. Analize e tarifimit per aksesin broadband ne tregun e shumices

Tarifimi i nje sherbimi perben nje nder elementet e rendesishem ne aspektin e nderhyrjes rregullatore, ne kushte e identifikimit te operatoreve me FNT ne tregun e analizuar, ose e thene ndryshe ne kushtet e identifikimit te dominances ne tregun e analizuar.

Por para se gjithash duhen konsideruar edhe disa faktore te tjere qe kane te bejne me:

- Fazen e zhvillimit te tregjeve broadband dhe pjekurine e tyre;
- Rriskun e investimit ne rrjetet broadband;
- Pasojat e rregullimit te çmimeve broadband gjatë periudhave të tranzicionit teknologjik;

Faktoret e cituar me siper, do te trajtohen ne menyre te vecante ne seksionin e vleresimit te masave rregullatore, nevojen ose jo per nderhyrje rregullatore ex-ante, ne percaktimin e masave rregullatore per tregjet e aksesit ne broadband internet ne nivelin e shumices.

V. Krahasimi me rajonin

Nga monitorimi i vendeve te rajonit sipas Cullen International report 3 - Annex – April 2013, ne lidhje me aksesin ne broadband ne nivelin e shumices (bitstream akses) per:

- Hirearkine e dhenies se aksesit per bitstream (ATM/Ethernet handover, IP handover, end-to-end resale, Naked DSL, Multicast);
- Rregullimin e cmimit (te zgjedhura nga rregullatoret);
- Implemenmtimin ne praktike dhe vlefshmerine e produkteve bitstream akses;

rezulton qe:

Ka vendimarrje rregullatore dhe detyrime perkatese per rregullimin e bitstream akses ne secilin nga vendet e rajonit duke filluar nga 2009 dhe ne vazhdim, ne lidhje me opsionet e aksesit dhe metodat e rregullimit te cmimit.

Krocia, Islanda Maqedonia, Serbia dhe Turqia, rezultojne te kene efektive sherbimin bitstream akses per shumicen e opsioneve te aksesit (ne nivele te ndryshme), dhe rezultojne me nje numer marreveshjesh te limituara ne nivelin e shumices, por me nje numer te konsiderueshem linjash broadband (si rishitje). Metodat e rregullimit te cmimeve jane dy kryesore:

- orientim ne kosto;
- retail minus (metoda me e perdorur);

Ndersa ne lidhje me bitstream akses ne Shqiperi, percaktuar ne 2011 sipas detyrimeve rregullatore perkatese, mbi baza komerciale, rezulton qe numri i marreveshjeve per kete sherbim eshte zero.

Disa nga arsyet kryesore per kete jane renditur ne trajtimin e bere me siper per bitstream akses, mbi mundesite e zevendesueshmerise se bitstream akses dhe nder me kryesoret eshte

ndertimi i infrastrukturave paralele ne vendet e mbulimit me sherbimin e aksesit broadband internet.

VI. Pritshmerite per tregun e shumices te aksesit ne broadband

Ne analizen e tregut te pakices te aksesit ne broadband internet, nder te tjera u evidentuan edhe pritshmerite e AKEP ne nje periudhe afatmesme per zhvillimin e konkurrences ne kete treg, duke patur ne konsiderate nje grup faktoresh.

Por pritshmerite per zhvillimin e konkurrences ne tregun e pakices nuk do te egzitonin, ne se nuk do te ishte ne konsiderate zhvillimi pozitiv ne tregun e shumices te aksesit ne broadband.

Kur vleresohet nje gje e tille, jane konsideruar secili nga faktoret e cituar ne seksionin e anlizes se tregut te pakices qe do te jene te tille, pikerisht ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, gje qe nenkupton para se gjithash faktorin kyc qe eshte zhvillimi i infsatruktores backbone, si mundesi per akses ne kete infsatrukture.

Por nje gje e tille aktualisht eshte nje realitet i prekshem dhe parashikohet qe ne nje periudhe afatmesme te jete akoma me fleksibel ne zhvillimin e tregut me shumice te aksesit ne broadband.

Ndaj duke konsideruar “zinxhirin e furnizimit” te tregjeve ne broadband si hallka te lidhura, bazuar ne pritshmerite ne rritje te kerkeses konsumatore ne tregjet e pakices, do te sjelle per pasoje edhe rritje te kerkeses nga ana e furnizuesve me akses dhe sherbime pikerisht ne tregun e shumices te aksesit ne broadband, gje e cila nenkupton nje rritje dhe elasticitet edhe per oferten ne kete treg.

VII. Konkluzion ne analizen e tregut te shumices te aksesit ne broadband

Referuar analizes se bere per faktoret e marre ne konsiderate ne lidhje me fuqine e ndjeshme ne treg, rezulton se:

- Albtelecom vazhdon te zoteroje pjese tregu ne nivele mbi 50% te aksesit ne broadband ne nivel shumice.
- Zhvillime te rendesishme te ndodhura ne rrjetin e Albetelecom (kalim ne NGN) duhet konsideruar si nje avantazh dominues ndaj rrjeteve te operatoreve alternative;
- Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), pavaresisht zbehjes se disa prej faktoreve avantazhues qe lidhen me ekonomine (te lidhura me ekonomine e shkalles, te densitetit, apo te qenurit lojtar i pare ne treg), edhe pse flitet qarte per renie te dominaces ne kete treg, por duke gjykuar ne prespektiven e zhvillimit te metejshem te tregjeve te aksesit ne broadband internet, lejon te gjykohet per nje peshe te vecante te Albtelecom ne raport me OA.
- Pavaresisht trajtimit te tregut te shumices per aksesin broadband internet, faktoret e konsideruar ne menyre te kombinuar me faktoret e madhesise se tregut, ne prespektiven e zhvillimit te tregjeve broadband ne Shqiperi jane kryesisht per sherbimin bitstream akses, ne fazen ne te cilen aktualisht ndohet zhvillimi i rrjetit te Albtelecom, krahasuar me OA.

Per rrjedhoje AKEP konsideron se:

Albtelecom permbush kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregun perkates me shumice te aksesit ne broadband duke e propozuar sipas kesaj analize si OFNT.

V. TREGU I AKSESIT FIZIK NE INFRASTRUKTUREN E RRJETEVE NGA NJE VENDODHJE FIKSE (PERFSHIRE AKSESIN E NDARE DHE TE PLOTE)


Tregjet 4 ne listen e tregjeve sipas Rekomandimit te 2007 te KE-se, eshte konsideruar si nje treg i rendesishem dhe si shtyese per zhvillimin e tregjeve te aksesit ne broadband, por para se gjithash ne kete aspekt eshte konsideruar investimi qe kryhet ne infrastrukturen qe eshte e lidhur me tregjet e aksesit ne broadband.

Edhe pse jane tregje te ndara dhe analizohen si te tilla, here pas here ne arsyetimet te ndryshme kane te njejten reference sidomos ne se lidhet me aspektin e nderhyrjeve ex-ante per rregullimin e tyre. Pra e rendesishme para se gjithash eshte promovimi i investimeve eficente.

Aspekt i rendesishem ne kete drejtim eshte vleresimi i “liderit te investimeve” dhe ne analizen e kryer ne keto tregje ne rastin e gjetjes se FNT , te vendoset detyrimi per aksesin me fokus kryesor adresimin ne zhvillimin e konkurrences efektive.

Duke i gjykuar si ngushtesisht te lidhura te dy tregjet e cituara me siper, (tregjet 4 dhe 5), si dhe konsideruar rekomandimet e KE-se per keto tregje dhe kryesisht per rritjen e mundesive dhe stimulimin e tyre ne investimet ne infrastrukturen mbi te cilen mbeshteten keto dy tregje, si mjaft te rendesishme per te shtrire konkurrencen efektive dhe ne tregjet e nivelit te pakices si tregje te lidhura me perdoruesin fundor, atehere skematikisht paraqitet me poshte nje lidhje e ngushte ndermjet produkteve dhe sherbimeve ne nivelin e shumices dhe shtrirja e tyre ne nivelin e pakices si dhe percaktimet e bera ne “European Commission’s Explanatory Note to the NGA Recommendation” , pershkallezimi i tyre sipas nivele dhe konkretisht:

FIGURA V.I. SHAKALLA E INVESTIMEVE (INVESTMENT LADDER)



Burimi: European Commission’s Explanatory Note to the NGA Recommendation

Ne seksionin II.3.1, ne menyre te permbledhur paraqitem perfundimet kryesore te arritura ne analize 2011 per LLU, ne dy versionet e aksesit (shared LLU dhe full LLU)

Ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike (LLU) si sherbime me shumice, nje vend te rendesishem ze arsyetimi ne lidhje me produktet e mundshme zevendesuese, te cilat ne analize 2011, u identifikuan si:

- Ndertimi i rrjetit te aksesit nga operatori ne vend te blerjes se LLU;
- Blerja e aksesit LLU ne rrjetin e nje operatori tjetër (eshte aksesit LLU i operatoreve te ndryshem ne te njejtin treg)
- Blerja e aksesit broadband me shumice (bitstream)
- Vetefurnizimi;

V.1 Perkufizimi i Tregut dhe dimensionit i produkteve dhe sherbimeve

Ne kete dokument analize, analize 2013, ne lidhje me perkufizimin e tregut AKEP konstaton qe nuk ka ndryshime nga perkufizimi i dhene ne analizen pararendese, duke qene perseri nje treg i cili edhe sipas Rekomandimit 2007 eshte pjese e listes se tregjeve te rekomanduara per t'u analizuara.

- Ne lidhje me pershkrimin e produkteve dhe sherbimeve te identifikura ne kete treg, AKEP eshte ne dakortesi te plote me perfundimet e arritura ne analizen pararendese, dhe per rrjedhoje nuk e gjykon te arsyeshme nje perseritje te pershkrimin te ketyre produkteve, duke orientuar lexuesin e ketij dokumenti qe per detaje te referohet ne dokumentin e analize 2011, e cila ndodhet ne faqen zyrtare te AKEP.

- Dimensioni gjeografik i produkteve dhe sherbimeve

Dimensioni gjeografik i sherbimit te aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjetit (LLU) ne tregun e shumices, eshte territori i Republikes se Shqiperise.

- **Tregu me shumice aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjetit (LLU)**
- **Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar**

Konkluzion mbi percaktimin e tregut te aksesit ne infrastruktura fizike (LLU)

Ne lidhje me percaktimin e tregut me shumice te aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjetit (LLU), konstatohet qe perfshin:

- Te gjitha sherbimet te cilat mundesohen nga aksesit (shared + full akses), produkte dhe sherbime te cilat mbeshteten ne teknologjite qe mundeson rrjeti mbi bakër, fiber etj;
- Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar;

V.2 ANALIZA PER FNT: TREGU ME SHUMICE NE AKSESIN FIZIK LLU

Analiza e tregut me shumice ne aksesin fizik LLU, mbështetur edhe ne analizen pararendese referuar statistikave te depozituara ne AKEP, pavaresisht percaktimit te Albtelecom si operator me FNT si dhe vendosjes se masave rregullatore perkatese, te cilat me kryesoret jane percaktimi i cmimeve per te dy tipet aksesit si dhe miratimi i RUO-s, vihet re se nuk ka ndonje zhvillim te ri ne kete treg, pasi nuk rezulton te kete ndonje kerkese te paraqitur prane operatorit Albtelecom.

AKEP ne analizen pararendese te kryer per FNT, ne reference me nenin 33 te ligjit 9918, ka perdorur kriteret e percaktuara ne piken 2 te ketij neni, ku pervec te tjerash nder me kryesoret ishin:

- madhesia e tregut, pjeset e tregut;
- fazen ne te cilen ndodhet zhvillimi i ketij tregu ne Shqiperi;
- pengesat e mundshme per te hyre ne kete treg dhe analize e barrierave te natyres strukturore;
- fuqine kundervepruese te bleresve;
- analize e tarifimit si dhe krahasimi me rajonin dhe BE-ne;
- etj. (arsyetime dhe faktore ndihmes);

Ne aspektin e percaktimit ligjor ne lidhje me kriteret qe do te perdoren per analize 2013 edhe ligji 9918 (i ndryshuar) nuk sjell ndonje specifike te re te ndryshme nga ato qe jane perdorur ne analize 2011, por pesha kryesore e arsytimit per kete analize, kryesisht ka te beje me faktin ne se ne kete treg ka apo jo zhvillime te reja.

Sic edhe konstatoam ne fillim te ketij seksioni, ky treg eshte ne kushte kur nuk egziton asnje kerkese per sherbime LLU (shared apo full), por ndryshime te tjera qe duhen konsideruar jane;

- avancimi i investimit ne infrastrukturat individuale te rrjeteve te operatoreve alternative;
- rritja e mundesive per akses ne broadband nepermjet teknologjive te tjera (perfshire edhe 3G);

I. Pjeset e tregut

Ne analize 2011, ne lidhje me percaktimin e pjeseve te tregut eshte perdorur arsytimi se, edhe ne rast se aksesit LLU qe mund te ofrohet nga secili OA qe ka rrjet aksesit me tela bakri, dhe ky akses do te konsiderohet si i zevendesueshem me aksesin qe mund te ofrohet nga Albtelecom, atehere pjesa e tregut te Albtelecom do te llogaritet mbi bazen e numrit te linjave te aksesit ne nivelin me pakice. Ne totalin e linjave te aksesit qe zoteron Albtelecom (duke

perjashtuar lidhjet e mundsuara me MUX), rezulton ne menyre hipotetike si treg i mundshem per t'u ofruar akses per "te tretet", sipermarres te tjere ne ofrimin e sherbimit te aksesit ne broadband te bazuar ne LLU.

Ndaj referuar te dhenave te 2012, vihet re nje reduktim i numrit te linjave te aksesit te Albtelecom, por gjithesesi perseri ne se do te perdorej nje kriter i tille vleresimi ndermjet Albtelecom dhe OA, perseri pjesa e tregut te Albtelecom per linjat e aksesit te telefonise fikse eshte mbi 70 % nga 80 % qe ishte sipas analize 2011.

Faktoret kryesore te konsideruar dhe te cituar me siper, jane pothuajse te pandryshuar, gje qe do te thote cilado menyre e matjes se pjeseve te tregut per LLU, per Albtelecom rezulton te jete ofruar i vetem i mundshem i aksesit LLU, pra dhe me pjese tregu te barabarte me 100% (nje vleresim hipotetik), sipas arsyetimit te perdorur edhe ne analize 2011 (ne mungese te zhvillimit te kerkesave te mundshme ne kete treg).

Si konkluzion:

Referuar arsytetimeve te perdorura, ne te dy variantet Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele te larta (100% ne vleresimin hipotetik) ose ne vlersimin sipas linjave te aksesit ne nivele mbi 70% te tregut te shumices te aksesit fizik ne rrjetin e hapur lokal (LLU).

II. Faktoret ekonomike dhe fuqia kunderverpruese

- Vleresimi i barrierave te natyres strukture;
- Vleresimi i fuqise kunderverpruese te blesesve;
- Vlersimi i natyres se integrimit vertikal;
- Vleresimi i faktoreve avantazhues te ekonomise (te shkalles dhe densitetit);

Ky grup faktoresh te konsideruar ne analizen pararendese per FNT per Albtelecom, pavaresisht zbehjes se mundshme, perseri ngelen faktore te cilet e identifikojne Albtelecom me peshe te konsiderueshme ne raport me OA, pavaresisht rritjes se ndonjerit nga operatoret alternative, perseri jane faktore qe duhen konsideruar dhe plotesojne kriteret per FNT te Albtelecom.

III. Tarifimi per LLU

AKEP ne analizen pararendese, percaktoi se tarifate per LLU (ne dy versionet e aksesit, shared akses dhe full akses), bazuar ne detyrimin per kontroll te tarifave te vendosur ndaj Albtelecom, duke percaktuar nivelin maksimal te tarifave te aksesit ne rrjetin lokal te Albtelecom per LLU duke percaktuar :

- tarifen mujore per LLU;
- tarifen e instalimit (e cila paguhet vetem njehere);

IV. Krahasimi me rajonin dhe BE



Ne aspektin e krahasimit te tarifimit te LLU, me vendet e rajonit dhe BE-se, behen kryesisht duke perdorur referencen benchmark per percaktimin e tarifave qe duhen ofruar nga operatori incumbent per aksesin ne rrjetin lokal ne dy versionet e tij (full dhe shared).

Nisur nga praktikat ne vende te rajonit dhe raportimet e bera per Cullen International, referuar raportit te Prill 2013, rezulton qe:

Tarifat per LLU (Full and shared akses);

- Tarifa e instalimit;

FIGURA V.2. KRAHASIMI I TARIFIMIT PER LLU (FULL DHE SHARED) SIPAS CI



Burimi: Cullen International, report 3 - Annex – April 2013

Figure O.5 and Figure O.6 krahasojne tarifen e instalimit dhe tarifen mujore te aksesit per full and shared LLU akses, sipas monitorimeve ne vendet e rajonit dhe krahasimi me EU-27, sipas monitorimit te Cullen International.

V. Pritshmerite per tregun e LLU-se ne te ardhmen

Tregu i aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjetit LLU, konsiderohet si nje shtyese ne zhvillimin e tregjeve per akses broadband.

Keshtu qe:

- ne varesi te rrethanave kombetare te zhvillimit te ketij tregu;
- te mundesive per zevendesueshmeri te teknologjive te tjera qe mundesojne akses ne brodaband, duke zbehur nevojën e perdorimit te LLU;
- zhvillimit te infrastrukturave paralele dhe dublimi i tyre per zona gjeografike te njejta;
- prespektives per mbyllje te mundshme te centraleve lokale, duke u orientuar ne rrjete me me pak pika interkonektimi, bazuar kryesisht ne IP;
- etj;

Per arsyet e mesiperme, AKEP ka pritshmeri per renien e interesit te paleve te konsideruara si te interesuara per LLU, pasi zhvillojne kerkesat e tyre per akses ne broadband kryesisht ne rrjetet e tyre, ose mbesheten ne teknologji me kosto me te ulet per ofrimin e sherbimit per pajtimtaret e tyre.

VI. Konkluzion perfundimtar per LLU

Bazuar ne vleresimet dhe arsyetimet e parashtruara ne kete seksion, si dhe duke vleresuar fazen aktuale te zhvillimit te ketij tregu ne Shqiperi, AKEP arrin ne perfundimin se Albtelecom vazhdon te ruaje pozita dominuese ne rrjetin e aksesit per qarkun lokal, per rrjedhoje gjykohet se ploteson kriteret per FNT ne kete treg, keshtu qe:

Albtelecom eshte operator me Fuqi te Ndjeshme ne Tregun e shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit te tij nga nje vendodhje fikse perfshire aksesin e plote dhe te ndare.

VI. MASAT RREGULLATORE PER TREGJET E ANALIZUARA

Per tregjet e nivelit te shumices (tregjet e broadband), ka nje sere studimesh, opinione profesionale dhe qendrimesh te KE-se duke i adresuar tek autoritetet rregullatore me qellim rritjen e kujdesit dhe vemendjes se tyre per nderhyrje te kujdeshme ne keto tregje, me qellim stimulimin e investimeve si dhe krijimin e hapësirave te nevojshme per pjekurine e ketyre tregjeve.

Pesha kryesore ne qendrimin apo vemendjen rregullatore ne tregjet e nivelit te shumices, duhet te kete si zanafille fazen ne te cilen ndodhet zhvillimi i konkurrences ne tregjet e shtrira vertikalisht, pra tregjet ne nivelin e pakices ose e thene ndryshe ne tregjet ne te cilet mundesohet aksesimi per perdoruesin fundor.

Ne kete aspekt jane tregjet 4 dhe 5 te percaktuara ne rekomandimin e 2007, si dhe ne studimet e mevonshme te kryera jane konsideruar si tregje te lidhura ngushtesisht me njeri-tjetrin te cilat kane ne themel te tyre zhvillimin e infrastruktures baze mbi te cilat mbeshteten platformat broadband internet. E perbashketa e te gjitha studimeve dhe qendrimeve ne keto dy tregje ka te beje me faktin qe kerkohet qe autoritetet rregullatore kryesisht ne nderhyrjet ex-ante te jene te perqendruara ne detyrimin rregullator per mos-diskrimin dhe dhenie aksesimi, dhe shume me pak ne aspektin e orientimit te tarifave drejt kostos.

Rekomandimet e KE per Strukturat Rregullatore

KE nepermjet rekomandimit “European Commission (2010) Section 1 of Annex 1 to Commission Recommendation of 20.9.2010 on regulated access to Next Generation Access Networks (NGA)” si dhe dokumentit te punes shoqerues, nder te tjera i ka kushtuar nje rendesi te posacme kerkeses per gjetjen e menyrave per inkurajimin e investimeve eficente, nga strukturat rregullatore kombetare si dhe mbrojtjen e konsumatoreve ne tregjet ku identifikohen operatore dominues ne produktet dhe sherbimet qe ofrojne ne keto tregje. Ne se identifikohen operatore dominues, nje rendesi te vecante duhet kushtuar ne identifikimin e problemeve qe shkaktojne mungesen e konkurrences, apo pozicionojne operatore dominant ne treg. Vendorsja e masave rregullatore duhet te ruaje proporcionalitetin me masen e problemit te identifikuar.

Ne kete aspekt KE, ka konsideruar dy tregje ne nivelin e shumices te lidhura ngushtesisht me njeri-tjetrin dhe qe kane per baze zhvillimin apo investimet ne infrastrukturen e NGA.

Dy tregjet e konsideruara nga KE, jane pikerisht dy tregjet e analizuara ne kete dokument analize dhe konkretisht:

- Akses ne infrastrukturen fizike te rrjeteve ne tregun e shumices;
- Akses ne broadband ne tregun e shumices;

Dy tregjet e mesiperme ne nivelin e shumices, edhe mund te trajtoheshin ne menyre te pandare nga njeri-tjetri, pasi konsiderohen si baza furnizuese me produkte dhe sherbime per tregjet e pakices. Ndaj rritja e kapacitetit te infrastruktures fizike te rrjeteve ku mbeshteten aksesimi ne broadband, sjell ne finale rritje te shpejtesise dhe cilesise se produkteve dhe

sherbimeve , per rrjedhoje sherbejne edhe si shtyese apo nxitje ne zhvillimin e konkurrences ndermjet ofruesve te ndryshme, jo vetem ne gamen e produkteve por edhe ne cilesine e tyre. Ne vijim eshte konsideruar e rendesishme qe te vleresohen me fokus te vecante detyrimi i mos-diskriminimit qe mund te vendoset nga rregullatorët dhe per kete qellim eshte ne fazen finale te përgatitjes rekomandimi per metodologjine e kostove qe kane per reference specifikesisht tregjet e broadband dhe masat rregullatore ne kete drejtim.

KE, mbi rrishtun e investimit ne rrjetet broadband

Rregullatorët duhet te vleresojne rrishtun e investimit, duke marre ne konsiderate faktoret e pasigurise si:

- pasiguri qe lidhet me kerkesat qe vijne ne tregjet e pakices;
- pasiguri qe vijne nga shperndarja e kostove, (pune civile,inxhinjerike dhe menaxheriale);
- pasiguri qe lidhen me progresin e shpejte te teknologjise;
- pasiguri qe lidhen me dinamiken e tregjeve dhe zhvillimin e situates se konkurrences, ne raport me infrastrukturen baze, kabllore etj;
- pasiguri qe lidhen me ndryshimet ne termat makro-ekonomik;

Faktoret e renditur me siper mund te jene relative me kalimin e kohes dhe mund te ndryshojne, pasi gjithcka do te varet kryesisht nga kerkesat e zhvilluar ne dy nivelet e tregjeve, pakice dhe shumice per produkte dhe/ose sherbime ne tregjet broadband.

Masa rregullatore per kontroll tarife per aksesin broadband ne tregun e shumices

Ne se tregu i shumices te broadband, ploteson tre kriteret test dhe gjate zhvillimit te analizes per kete treg identifikohen ofrues me fuqi te ndjeshme ne treg, atehere ne raport me problemin e identifikuar do te percaktohet edhe niveli i nderhyrjes rregullatore me qellim zgjidhjen e problemit te identifikuar si pengese per zhvillimin e konkurrences.

Masat rregullatore te vendosura per kete qellim mund te jene te ndryshme, por patjeter nje nder masat qe ne te gjitha rrethanat do te jete prezente, eshte detyrimi per te dhene akses ne infrastrukturen e rrjetit te tij.

Kur diskutohet per infrastrukturen e nje operatori ne tregun e broadband, duhet te marrim ne konsiderate qe mund te jete e ndare ne dy pjese, infrastrukture aktive dhe pasive. Ne infrastrukturen pasive (si kulla, kanale, antena, “website” te ndryshme, furnizues elektrike, dark fiber etj);

Ndersa me infrastrukture aktive ne teresine e tyre referohen elementet elektronike te infrastruktures (nyje aksesit, swich-e, sisteme menaxhimi, light fiber , aksesit si dhe sherbimet e komutimit te aksesit ne broadband etj.).

Detyrimi qe vihet per operatorin me FNT, ne teresine e tyre perfshijne te dy elementet e infrastruktures (aktive dhe pasive)

Rregullimi i tarifave per elementet e infrastruktures aktive, gjithmone duhet te ruajne parimin e koston ekonomike te ndertimit, duke qene gjithnje me te larta, me qellim qe te shmangim

tarifa nen koston ekonomike per sherbime, gje e cila do te dekurajone investimet si dhe do te ishte ne disfavor edhe te konkurrences efektive.

Ne aspektin e rregullimit te cmimeve, rregullatorët duhen te tregohen te kujdesshme ndermjet percaktimit te cmimeve per dy tipet e infrastruktures (aktive dhe pasive), pasi duhet marre ne konsiderate rrishten e koston (koston e kapitalit te punesuar, madhesia e tregut, lojtaret e tregut, si dhe shkalla e investimit);

Ne percaktimin e kostove baze te cilat do te perdoren per detyrimin e orientimit te tarifave ne kosto, per tregjet broadband duhen konsideruar nga rregullatorët dublikimet e infrastruktures per (akses ne NGA dhe NGN), me qellim primar te fizibilitetit dhe eficenses ekonomike.

Diferenca e arsyeshme per tarifat e tregut te pakices dhe produkteve bitstream ne shumice

Percaktimi i tarifave per aksesin e sherbimeve ne tregun e shumices, marrjen ne konsiderate te faktoreve shtese per ofrimin e ketyre sherbimeve ne tregune pakices, perbejne ne vetevete nje percaktim kompleks, referuar edhe faktoreve te mundshem qe lidhen me faktoret e pasigurise te konsideruar si rrishten per investimin.

Relativiteti i faktoreve qe mundesojne edhe percaktimin e e baze se koston per sherbimet ne tregun e shumices, krijojne edhe hapesirat e mundshme per rrishtjen e produkteve apo sherbimeve ne tregun e pakices.

Ne kete aspekt, rregullatorët duhet te jene te kujdesshem ne perpjekjet e tyre per percaktimin e tarifave per infrastrukturen aktive, duke patur nje vezhgim te hollesishem te sjelljes konsumatore apo te mundesive te zhvillimit te kerkesave ne tregun e pakices. Kjo do varet shume edhe nga:

- zhvillimi i konkurrences dhe faktoret themelor qe e pengojne kete zhvillim;
- problemet kryesore te identifikuar nga analiza dhe proporcionaliteti i masave te propozuara per zgjidhjen e tyre;
- faza e rëndësishme në zinxhirin e furnizimit broadband;
- tregu broadband dhe burimet ose alternativat në dispozicion për rregullatorin;
- alternativë e mundshme per nderhyrje ex-ante, duke aplikuar testin “margin squeeze”, kryesisht per operatorët e integruar vertikalisht;

Pasojat e rregullimit te cmimeve broadband gjatë periudhave të tranzicionit teknologjik

Vitet e fundit (kryesisht) vihet re nje zhvendosje nga narrowband ne broadband, pasi kerkesat per sherbime ne kapacitet dhe shpejtesi te larte kane bere te domosdoshme zhvendosjen e ketyre platformave mbi te cilat mundesohen keto sherbime. Kjo ka bere te domosdoshme edhe per faktin qe si “driver kryesor”, eshte duke u pozicionuar ai i te dhenave, ne ndryshim nga historiku qe kishte si driver kryesor “zerin”. Rregullatorët do të duhet të marrin në konsideratë se si - dhe kur – eshte momenti qe ploteson kushtet e “zvendesuesmerise se plote”, për të njohin zërin mbi broadband si një zëvendësim për shërbimet tradicionale të telefonisë fikse, dhe do të ketë nevojë të rishohë praktikatat tradicionale të rregullimit te cmimeve të shitjes me pakicë të telefonisë.

Konkluzioni kryesor i studimeve te kryera

Studimet e kryer (kryesisht per tregjet e shumices te broadband), theksin kryesor e kane vendosur tek aspekti i tolerances rregullatore, kryesisht ne percaktimin e tarifave ne tregjet broadband, te paktën për aq kohë sa ato tregje të mbetet në një fazë të rritjes.

Por pavaresisht kesaj, mund te lejohen dhe jane te mundshme disa forma të rregullimit të tarifave, kryesisht ne se eshte e nevojshme për të adresuar dështimet specifike të tregut, te cilat identifikohen përmes një procesi të analizës së tregut.

Ndërhyrje te tilla, duhet të jenë kryesisht ne zinxhirin e furnizimit broadband, dhe keshillohet qe keto nderhyrje te kufizohen vetëm ne nivelin me shumicë.

Ndaj, studimet kane lene te hapur dhe pa pergjigje pyetjet e shumta qe vijne nga rregullatorët dhe qe pak a shume jane:

A duhet të rregullohen çmimet apo jo? Dhe nëse po, si?

Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve duhet të bazohen në një shqyrtimi i hollësishëm i rrethanave kombetare të veçanta të tregut përkatës, por pa percaktuar përgjigjet që janë në përgjithësi të zbatueshme.

Megjithatë, për të ndihmuar rregullatorët për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, studimet e kreyra konkludojne ne disa parime baze te konsideruara si te arsyeshme per zhvillimin e tregjeve broadband, por esenciale gjykohen pikerisht parimet e referuara per rregullimin e cmimeve ne tregjet e aksesit ne nivelin e shumices dhe konkretisht duke referuar qe metodologjia e hartuar ne kete drejtim duhet qe:

Metodologjite per percaktimin e çmimeve aksesin ne broadband ne tregun e shumices (perfshire bitstream akses), duhet te marrin ne konsiderate:

- Vështirësitë në vendosjen e kostove të besueshme dhe të dobishme për shërbime të tilla, qoftë nëpërmjet modelimit të kostos ose standartizimit duke përdorur reference benchmark;
- Vështirësitë në vendosjen e tarifave duke aplikuar zbritje apo vlerësime të njohura si praktika (retail minus), te cilat mund te sherbejne si zanafille per percatimin e çmimeve ne nivelin me shumicë;
- Objektivat e politikës, nëse ato ekzistojnë, që mund të favorizojnë zhvillimin e konkurrencës per sherbimet broadband;
- Nëse furnizuesi i aksesit ne broadband ne tregun e shumices është një operator integruar vertikalisht, duke transferuar efektet e nderhyrjes ne nivelin e shumices tek tregu me pakicë.

Nje nga sugjerimet kryesore te studimeve te kryera eshte qe rregullatorët duhet të shmangin termat dhe kushtet ne funksion te rregullimit apo nderhyrjeve ex-ante, duke përfshirë çmimet per aksesin ne broadband me shpejtësi të lartë si dhe të aplikimit të shërbimeve qe bazohen ne broadband. Në qoftë se rregullimi është i nevojshëm, ajo kryesisht duhet te jete per nderhyrje ex-post dhe e orientuar per sjelljet anti-konkurrese te identifikuar ne treg.

VI.1 MASAT RREGULLATORE PER LLU

Konkluzion per percaktimin e masave rregullatore per LLU

Bazuar ne rezultatet e analizes se tregut per LLU, si dhe duke patur ne konsiderate faktin qe ne tregun e aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjeteve, edhe pas percaktimit te masave rregullatore per Albtelcom, rezulton te mos kete asnje kerkese ne kete treg, si dhe nisur nga fakti qe ne kete dokument analize, AKEP ka pritshmeri per renien e interesit te paleve te konsideruara si te interesuara per LLU, pasi zhvillojne kerkesat e tyre per akses ne broadband kryesisht ne rrjetet e tyre, ose mbeshketen ne teknologji me kosto me te ulet per ofrimin e sherbimit per pajtimtaret e tyre,

atehere AKEP vlereson:

Vazhdimin e detyrimeve rregullatore te vendosura ne analize 2011 per Albtelcom ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike te Albtelcom perfshire facilitetet e tjera ndihmese, etj;

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
- Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Ne amendimet e Ligjit 9918, detyrimi per Akses⁵ perfshin edhe dhenien e aksesit ne elemente jo-aktive te rrjetit per te mundesuar lidhjen e operatorit me MSAN ne rrjetin Albtelcom per LLU.

Ky detyrim i eshte vendosur Albtelcom ne dokumentin e RUO te miratuar nga AKEP ne 31.05.2012, si me poshte:

Nese operatori perfitues eshte i intersuar per akses ne kanalet/tubacionet/dark fiber ne menyre qe te arrije pikat e aksesit ne MSAN-et e Albtelcom. Operatori perfitues duhet te beje nje kerkese per produkt te tille. Kerkesa duhet te jete specifike dhe duhet te permbaje informacion per dy pikat e lidhjes: piken ku do lidhet me Albtelcom dhe MSAN/MSAN-et qe kerken te arrije. Me marrjen e kerkeses Albtelcom do te vleresoje mundesite teknike dhe do ti jape pergjigje operatorit perfitues, brenda 30 diteve, ne lidhje me:

- *Mundesine teknike te realizimit, dhe nese eshte mundshme*
- *Pagesat perkatese per ofrimin e sherbimit/produktit dhe afatet e realizimit.*

AKEP gjykon qe edhe ky detyrim te vazhdoje te aplikohet ndaj Albtelcom, pasi kjo eshte akoma me e domosdoshme ne kushtet kur Albtelcom ka perfunduar pothuajse plotesisht migrimin ne rrjetin NGA, dhe eshte nje mase e rekomanduar nga BEREC per LLU ne NGA.

⁵ Neni 42, pika 2/a: t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal

Ne lidhje me tarifat, Albtelecom duhet te vazhdoje te aplikojë tarifat e miratuara me VKD nr.1365, date 13.04.2011 si me poshte:

TABELA VI.1: TARIFAT MAKSIMALE PER LLU

| Shërbimi | Tarifa (Lekë) | Njësia |
|---|--------------------------|-------------------------------|
| Pagesa mujore për LLU | | Paguhet çdo muaj |
| Akses i plote në rrjetin lokal (full unbundled access LLU) | 801 | [per linjë] |
| Akses i perbashket në rrjetin lokal (shared access LLU) | 468 | [per linjë] |
| Akses i plote në nën-rrjetin lokal | 678 | [per linjë] |
| Akses i perbashket në nën rrjetin lokal | 407 | [per linjë] |
| Pagesa instalimi për LLU | | Paguhet vetëm një herë |
| Instalimi I aksesit te plote ne rrjetin lokal | 1 686 | [per linjë] |
| Instalimi I aksesit te perbashket në rrjetin lokal të hapur | 2 452 | [per linjë] |

Tarifat e mësipërme nuk përfshijnë TVSH

Migrimi ne rrjetin NGA, me modelin FTTN, nga Albtelecom mundeson zvogelimin e rrjetit te aksesit dhe qarqeve lokale (local loops), dhe praktikisht ato mund te konsiderohen sub-loops: lidhja MSAN perdorues fundor me linje bakri.

Per kete arsye, per linjat e aksesuara ne MSAN per LLU, Albtelecom duhet te aplikojë tarifat perkatese te aksesit (te plote dhe te perbashket) në nën-rrjetin lokal.

Albtelecom duhet te vazhdoje aplikimin e tarifave te tjera per LLU te percaktuara ne dokumentin RUO te miratuar nga AKEP me VKD nr.1975, date 31.05.2012.

Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 42 dhe 45) nga Albtelecom, do të kryhet në bazë të përcaktimeve të Rregullores “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”, miratuar me Vendim te KD te AKEP Nr. 2406, datë 26.12.2013.

VI.2 MASAT RREGULLATORE PER BITSTREAM AKSES

Konkluzion per percaktimin e masave rregullatore per Bitstream Akses

AKEP bazuar ne perfundimet e analizes per FNT gjykon te arsyeshme **vazhdimin e detyrimeve rregullatore te vendosura ne analize 2011 ndaj Albtelecom ne lidhje me tregun e shumices te aksesit ne broadband internet (bitstream akses nga vendodhje fikse) dhe konkretisht:**

- Detyrimi per Aksesin (sipas *nenit 39 te ligjit 9918 i ndryshuar*);
- Detyrimi per mos-diskriminim (sipas *nenit 40 te ligjit 9918 i ndryshuar*);
- Detyrimi per transparence (sipas *nenit 42 te ligjit 9918 i ndryshuar*);

Ne menyre me te detajuar dhe te perditesuar me ndryshimet e ndodhura keto detyrime do perfshijne sa me poshte vijon.

- **Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**

1. Albtelecom të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij
2. Albtelecom te publikoje oferte reference aksesit per bitstream ne terma jo-diskriminues dhe transparent.

Albtelecom duhet te perditesoje oferten refernce te aksesit bitstream te publikuar ne 2013, duke mos perfshire kufizime ne numer portash per ofrimin e sherbimit. Albtelecom mund te ofroje skonto (zbritje) per blereje ne sasi te medha, duke dhene rregullat e aplikimit te tyre ne oferte.

- **Detyrimi i transparencës (Neni 40)**

Oferta Reference e aksesit te hapur ne qarkun lokal (RUO) e perditesuar sipas pikes 6.1/2 me siper duhet te pershije informacionin e meposhtem te nevojshme per ofrimin e sherbimit:

- specifikimet teknike;
- karakteristikat e rrjetit;
- termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

Albtelecom mund te ofroje skonto (zbritje) per blereje ne sasi te medha, duke dhene rregullat e aplikimit te tyre ne oferte, por te mos kufizojte blerjen e sherbimit me numer te caktuar minimal portash.

- **Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)**

Detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e aksesit me shumicë broadband (bitstream) në rrjetin Albtelecom, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të Albtelecom, si dhe me tarifa të cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

Albtelecom ka detyrimin të japë akses me shumicë broadband (bitstream):

Ne nivel Ethernet;

Ne nivel IP

AKEP gjykon të arsyeshme lenien e detyrimit për akses në layer 2 (Ethernet)⁶ dhe në layer 3 IP, dhe heqjen e detyrimit për akses bitstream në nivel DSLAM, pasi ky akses është shumë i përafërt me aksesin për LLU. Gjithashtu aksesin në nivel IP është shumë afër rishitjes, ndërsa rishitja vetë nuk ka nevojë për shërbime aksesin pasi të gjitha ofrohen nga operatori inkumbent.

Detyrimi për kontroll tarife

Përveç detyrimeve të mësipërme AKEP gjykon të arsyeshme të vendosë detyrimin për kontroll të tarifave të shërbimeve të aksesit bitstream, sipas metodës “retail minus”. Kjo metodë rekomandohet si metoda më mirë për rregullimin e tarifave të aksesit bitstream me shumicë, për shkak të veshirësive se përcaktimit të kostove të këtij shërbimi si dhe një metode më mirë për të shmangur price-squeeze.

‘Retail minus: Sipas metodës retail minus, Albtelecom do të aplikojë tarife me shumicë për akses bitstream në varesi të tarifës me pakicë të aplikuar për përdorues fundorë. Tarifa me shumicë e aplikuar do të jetë tarifa me pakicë minus një përqindje të caktuar. AKEP gjykon që për dy nivelet e aksesit përqindja e zbritjes të jetë si më poshtë:

TABELA VI.2: TARI FAT MAKSIMALE PËR AKSES BITSTREAM (RETAIL MINUS)

| Niveli i aksesit | Cmimi Maksimal |
|-------------------------|-----------------------|
| Ne nivel Ethernet; | Retail – 50% |
| Ne nivel IP | Retail -30% |

Shënim: Tarifa retail me pakicë pa TVSH

Tarifa me shumicë në nivel IP është më e lartë se tarifa në nivel Ethernet, pasi aksesin në nivel IP përdor me shumë inute të ofruara nga Albtelecom (dhe me pak nga operatori tjetër) në raport me aksesin bitstream në nivel Ethernet. Kjo mund të vihet re nga skema për nivelet e aksesit bitstream. Niveli Ethernet mundëson akses me afër përdoruesit fundor dhe krijon mundësi për fleksibilitet më të madh për operatorin për shërbimin broadband që i ofron me pakicë pajtimtarit. Në shkallën e investimeve operatorët që blejnë këto shërbime janë në nivel më të lartë dhe me afër operatorëve që blejnë akses në infrastrukturë fizike LLU. Niveli IP i aksesit bitstream mundëson akses me larg përdoruesit fundor dhe në shkallën e investimeve

⁶ Në NGN ATM zëvendësohet terësisht nga Ethernet.

operatori qe blen kete sherbim eshte me afer rishitesit (pra me pak investime ne infrastrukture te vet se format e tjera si akses bitstream Ethernet, akses ne infrastrukture fizike LLU).

Tarifa retail do te jete ne varesi te shpejtesise se aksesit broadband, duke iu referuar paketave tarifore te aksesit broadband per pajtimtaret e Albtelecom. Me hedhjen ne treg te paketave te reja tarifore broadband Albtelecom do te duhet te ofroje dhe sherbimin e aksesit bitstream duke ofruar dhe cmimin perkates ne varesi te nivelit te aksesit dhe tarifes perkatese me pakice.

- **Zbritjet ne tarifa ne varesi te sasise**

BEREC rekomandon qe nje menyre per te nxitur penetrimin e aksesit broadband me pakice dhe kerkesat e operatoreve per akses bitstream me shumice eshte aplikimi i zbritjeve ne varesi te numrit te lidhjeve te kerkuara/blera nga operatori. AKEP gjykon qe nje zbritje prej 10 pike perqindjeje te aplikohet per 100 linjat e para te blera te cdo operatori. Pra kur nje operator arrin kuoten 100 linja ne nje pike aksesi (niveli Ethernet apo IP) te kete nje reduktim me 10 pike perqindje per tarifën mujore qe do te paguaje Albtelecom.

- **Cmim dysheme (minimal)**

Bazuar ne shkallen e investimeve, AKEP gjykon qe pervec cmimit maksimal te regulloje edhe cmimin minimal. Cmimi per akses bitstream nuk mund te jete me i lire se cmimi per akses ne LLU. Ne vijim te argumentit ne pjesen e analizes per LLU, cmimi (tarifa mujore) per akses bitstream nuk mund te jete me i ulet se 407 lek/muaj. Ky cmim minimal apo dysheme eshte i nevojshem pasi nga ana ekonomike Albtelecom ofron me shume inpute per akses bitstream se sa per akses ne LLU, ndersa operatori perdor me pak infrastrukture te veten ne akses bitstream se sa per akses ne LLU. Gjithashtu kjo eshte e nevojshme edhe per te krijuar stimujt e duhur per LLU dhe konkurrencen me infrastrukture fizike, pasi konkurrenca bazuar ne infrastrukture duhet stimuluar me shume se ajo ne sherbime.

Sic eshte evidentuar edhe ne analizen e linjave me qira, nje numer i konsiderueshem operatoresh kane investuar ne rrjete backbone me fiber optike ne zona urbane dhe midis qyteteve kryesore, pefshire edhe ne rrjete aksesi. Investimet ne rrjetet e aksesit kane cuar dhe cojne ne nje kerkese me te ulet per LLU dhe akses bitstream. Megjithate AKEP gjykon qe mundesite qe ofron rrjeti NGN/NGA jane te medha dhe detyrimet e perfshira ne kete dokumnet dhe ne analizen e linjave me qira, krijojne mundesi per operatorët e ndryshem ne treg qe nepermjet kombinimit te infrastruktures se tyre dhe perdorimit te sherbimeve me shumice te aksesit ne infrastrukture fizike dhe jo-fizike te Albtelecom, te ofrojne produkte te ndryshme perdoruesve fundore dhe me shume inovacion dhe konkurrence ne tregjet me pakice te aksesit broadband.

ANEKS 1. KOMENTET NE KESHILLIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP

Ne dokumentin per keshillim publik, AKEP kishte hartuar disa pyetje rreth te cilave kerkonte komente nga palet e interesuara, duke mos u kufizuar te drejten per t'u shprehur edhe jashte ketyre pyetjeve.

Ne perfundim te fazes se keshillimit per dokumentin e analizes, ne AKEP jane depozituar komente nga operatoret: Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus Communications, Albtelecom.

AKEP, falenderon operatoret e cituar me siper per perfshirjen me komentet e tyre per dokumentin e keshilluar.

Nga te gjithë operatorët e perfshire me komentet e tyre eshte ruajtur struktura e pergjigjeve sipas renditjes te pyetjeve te bera nga AKEP, duke i reflektuar ne komentet e tyre. Duke qene se komentet jane paraqitur edhe ne formen e nje sintheze te pergjithshme, por ne te njejten kohe e njejta pergjigje gjendet edhe ne version te reduktuar tek lista e pyetjeve te shtruara nga AKEP, pjesen e arsytimit te perseritura nga dokumenti i konsultuar, gjykohet e arsyeshme te reduktohet, por duke ruajtur thelbin e komentit si ne rastin e dakortesise me qendrimet dhe konkluzionet e AKEP edhe ne rastin e kundershimeve apo argumenteve ilustruese qe mbeshtesin kundershimit sipas rastit.

Ndaj per orientim te lexuesit, ne vijim do te gjeni nje renditje te tille:

- pyetjen e hartuar nga AKEP ne keshillim publik;
- komentet/pergjigjet e secilit operator mbi kete pyetje, si dhe
- qendrimin e mbajtur nga AKEP per komentet perkatese

1. A jeni dakort me konkluzioin e AKEP se:

Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet ka ritme te mira zhvillimi te konkurrences, eshte dinamik dhe ka premisa te forta per nje konkurrence gjithnje e ne rritje.

Jepni komentin dhe arsyetimet tuaj per keto perfundime.

Pergjigje e Albtelecom Sh.a:

Albtelecom e gjen të argumentuar analizën e tregut broadband me pakicë. Prezenca në të e operatorëve alternativë, paketat bundle dhe ofertat e ndryshme të ofruara prej tyre, përdorimi gjithnjë e më tepër i teknologjisë 3G si dhe shërbimet e ndryshme që mundësojnë aksesin në internet (Wi-Fi, Hot Spot) kanë bërë që tarifat e pakicës për këtë shërbim të ulen konsiderueshëm dhe numri i përdoruesve të internetit të rritet ndjeshëm. Të gjitha këto oferta dhe shërbime e kanë rritur konkurrencën duke e bërë këtë treg me përfitime të dukshme për përdoruesit fundorë.

Nëse do ti referoheshim pjesëve përkatëse të tregut për të ardhurat të secilit operator që operon në këtë treg sërish evidentohet një rritje e konsiderueshme e OA dhe ulje e ndjeshme e të ardhurave të Albtelecom. Sikurse paraqitet në faqen nr. 43 të dokumentit të analizës, pjesët e tregut për sa i përket të ardhurave (një ndër treguesit baze në përcaktimin e dominancës në treg), të operatorëve alternativë janë rritur ndjeshëm krahasimisht me Albtelecom, te ardhurat e te cilit janë në rënie. Albtelecom shprehet dakord me konkluzionin e AKEP se ky treg është dinamik dhe i orientuar drejt konkurrencës efektive.

Pergjigje e AMC:

Ne dy tri vitet e fundit zhvillimi i broadband ne vendin tone ka pasur nje zhvillim dinamik i karakterizuar nga investime te konsiderueshme te bere nga operatoret e ndryshem ne ndertimin dhe permiresimin e rrjeteve te tyre individuale, si psh: investimet ne rrjetet NGN dhe te bazuar ne fibrat optike, apo investimet ne teknologjine 3G nga operatoret mobile.

Por pavaresisht ketyre zhvillimeve dhe investimeve te bera nga operatoret ne teknologji dhe ne rrjetet e tyre, dhe zbehjes disi te avantazheve te operatorit kryesor me te madhe fiks Albtelekom, perseri ne tregun me pakice te aksesit broadband fiks nuk ka ndryshime sinjifikative ne terma te penetrimit te internetit ne te gjithe territorin e vendit (ne numer pajtimtaresh apo ne terma te te ardhurave).

Po te veshtrohen shifrat e analizes se tregut per 2011 – 2012 Albtelekom ka pasur nje ulje te lehte nga 43% ne 42% ne tregun me pakice ne broadband fiks

Ndersa ne vitin 2010, Albtelecom ka pasur nje kuote tregu prej 63% te numrit te pajtimtareve kundrejt operateve te tjere alternative, si ne figuren me poshte (sipas dokumentin te te dhenave statistikore te vitit 2010 publikuar nga AKEP.

Sic shihet edhe ne tabelat e Analizes ne lidhje me shperndarjen e numrit te pajtimtareve me akses ne broadband per 2010-2012, vihet re se Albtelecom ka nje rënie te numrit te pajtimtareve nga 70,597 abonente ne 2010 ne rreth 67,000 abonente ne 2012.

Pavaresisht se ka pasur nje zbehje te perqindjes ne kuotat e tregut per Albtelecom dhe te rritur per operateve te tjere alternative per numrin e pajtimtareve me akses, perseri situata e konkurrences ndermjet Albtelecom dhe operateve te tjere mbetet ende larg asaj efektive, duke qene se operateve alternative nuk e mbulojne te gjithe territorin e vendit me rrjetin e tyre duke lene pa akses shume zona gjeografike, ndersa Albtelecom ka nje shtrirje gjeografike me te madhe te rrjetit, gje qe tregon nje avantazh tjeter evident te Albtelekom ndaj operateve te tjere.

Tregu i pakices te aksesit ne broadband ne Shqiperi ka ndjekur nje trend ne rritje kryesisht 2-3 vitet e fundit. Treguesit qe bejne te mundur vleresimin e aksesit ne tregun e pakices (numri i pajtimtareve), orienton ne kete perfundim.

Penetrimi i linjave te aksesit ne broadband fiks ne tregun e pakices mbetet ende i ulet (7.6% ne vitin 2012, dhe penetrimi i aksesit ne broadband per familje eshte 27%), duke evidentuar qarte se presioni konkurrues eshte akoma i pamjaftueshem per te stimuluar rritjen e tij ne territor per konsumatorete.

Perfundimet e arritura nga AKEP ne lidhje me tendencen gjithnje e ne rritje te konkurrences efektive ne tregun me pakice te broadband fiks nuk eshte krejtesisht i sakte, pasi ne shifrat e publikuara ne kete analize nga AKEP, jane perfshire ne aksesin ne broadband fiks edhe shifrat per aksesin nga 3G broadband me ane te kartave modem USB si pjese e te njejtit treg.

AMC shpreh objeksionin e saj me arsyetimin e dhene nga AKEP se aksesin me ane te kartave modem neprmjete USB ne rrjetet 3G eshte pjese e aksesit ne broadband fiks per shkak te karakteristikave funksionale te njejta.

Ne shume vende te BE-se (Austri, Finlande, Portugali, etj) keto dy sherbime nuk jane konsideruar si pjese e te njejtit treg ("*BoR (10) 28 report on market definitions, par.3.1 NRAs' experience: fixed/mobile broadband*") per shkak se:

1. Keto dy sherbime ne disa nga keto vende konsiderohen me shume si komplementare sesa zevendesuese nga ana e kerkeses;
2. Kane karakteristika funksionale te ndryshme (upload, donwnload, traffic data rate, mobiliteti per broadband mobile, etj);
3. Cmimet e ofruara per keto sherbime kane ndryshime te ndjeshme midis tyre;

Ndaj dhe ne shifrat per tregun me pakice te aksesit ne broadband fiks nuk duhet te perfishihen shifrat per aksesin me ane te teknologjise 3G per te shqyrtuar situaten e konkurrences ne kete treg. Duke pasur kete arsyetim si pikenisje, rezultatet mbi situaten kompetitive ne treg ndryshojne ne menyre te ndjeshme, pasi psh; Albtelecom nga 31% ne broadband fiks+mobile ka nje kuote prej rreth 41% vetem ne broadband fiks.

Gjithashtu ne lidhje me mbulimin territorial duhen konsideruar vetem rrjetet e operatoreve fiks, dhe ne tregun me pakice te aksesit ne broadband fiks (duke mos konsideruar rrjetet 3G), Albtelekom ka mbulim territorial ne pjesen me te madhe te vendit, ndersa operatoret e tjere alternative kane mbulim kyresisht ne nivel lokal.

Pra, pavaresisht rritjes se numrit te operatoreve ne treg, investimeve ne rrjetet e tyre (kalimi nga PSTN ne NGN), uljes se ndjeshme te cmimeve ne paketat qe operatoret ofrojne, perseri situata e konkurrences mbetet ende larg asaj efektive, per shkak te avantazheve qe ende Albtelekom gezon dhe per rrjedhoje, te pozites dominante qe ka (nivel me i madh i shtrirjes se rrjetit, kuote me e madhe e kontrollit ne treg ne nivel pajtimtaresh me akses ne rrjet, te ardhura financiare me te medha se operatoret e tjere, etj).

Si perfundim, niveli i konkurrences ne tregun me pakice te aksesit ne broadband fiks ka pasur zhvillime sinjifikative ne terma te progresit teknologjik, uljes se cmimeve, rritjes se konkurrenteve, investimeve ne treg, etj, por duhet ende kohe qe kjo konkurrenca te jete efektive midis operatoreve. Ndaj eshte e nevojshme qe AKEP te krijojte mundesi per stimuj dhe incentiva te metejshem drejt promovimit te investimeve ne teknologji dhe rrjet nga operatoret.

Pergjigje e Plus:

Jemi dakord me konkluzionin e AKEP qe tregu i pakices te aksesit ne broadband internet ka ritme te mira zhvillimi te konkuresces, eshte dinamik dhe ka premisa te forta per nje konkurrenca ne rritje. Eshte e vertete qe Albtelecom eshte dominues ne kete treg, por eshte vene re qe konkurrenca ka ardhur ne rritje me ofertat agresive te disa operatoreve te tjere fiks por dhe atyre mobile. Operatorët mobile me hyrjen e teknologjise 3G keto 2 vitet e fundit e kane rritur ndjeshem konkurrenccen ne kete lloj tregu.

Megjithate ne mendojme se dhenia e licenses se fundit 3G per operatorin PLUS do te bente qe kjo konkurrenca te jete me e ndershme dhe akoma ne rritje.

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania shprehet e mendimit se rendesia e aksesit ne broadband eshte e pacmuar ne kushtet e zhvillimit te sotem. Jo pa qellim, pavaresisht nga ideologjite politike, cdo kahje e drejtimit te vendit ka ne fokus aksesin e popullates se gjere ne sherbimet e internetit, duke filluar nga arsimi, mjekesia, transparenca dhe shlyerja e detyrimeve fiskale dhe doganore, aksesin ne informacionin e pergjithshem kulturor-edukativ, pagesat bankare dhe ndaj te treteve, e keshtu me rradhe.

Fatkeqesisht sipas te dhenave qe ne disponojme edhe atyre te publikuara nga AKEP rezulton se aksesin ne broadband ne internet eshte ne ritme tejet te ulta dhe shume larg mesatares se vendeve te BE (pa u krahasuar aspak me vendet lider ne kete aspekt). Konkretisht, shifrat e meposhtme jane dekurajuese sidomos persa i takon aksesin ne broadband nepermjet rrjetit fiks:

Te dhenat jane marre nga Raporti i Cullen International per vendet ne zgjerim, Prill 2013

Ne keto rrethana, konkurrenca ne perspektive e brendshme ne nje treg te pazhvilluar ploteson vetem gjysmen e rebusit dhe nevojtes se tregut per zhvillim te metejsheem ne arritjen e objektivave primare te qeverise dhe interesit publik qe permendem me lart. E njejta gje mund te thuhet per ritmet e ngadalta te zhvillimit qe nuk jane aspak ne linje me planin agresiv te prezantuar nga Qeveria, ku sipas tabelës se meposhtme vihet re rritja e moderuar por sidoqofte shume poshte mesatares se BE dhe e fundit ne rajon.

Te dhenat jane marre nga Raporti i Cullen International per vendet ne zgjerim, Prill 2013

Ndonese sipas AKEP ne treg jane shume sipermarres qe kane njoftuar AKEP per ofrimin e sherbimit te aksesit ne Internet nepermjet rrjetit fiks, midis te cileve 53 prej tyre rezultojne aktive, inkumbenti mbetet i vetmi operator qe ka shtrirje me rrjetin e tij ne te gjithe territorin e vendit dhe pjese tregu ende ne nivele siperore dhe te pacenueshme nga konkurrentet e aferm, ndersa operatorët e tjere, ashtu sic theksohet ne analizen e tregut nuk kane mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem me operatorin inkumbent. Pozita e avantazhuar e operatori inkumbent eshte edhe me tej e perforcuar tanime qe ai operon ne teknologjine e re NGN, ku perfshihen elementet e rrjetit qendror, transportit dhe aksesit.

Nuk mund te thuhet e njejta gje per sipermarresit celulare, te cilet po lene gjurme ne kete drejtim duke mbajtur peshen kryesore dhe reflektuar indikatorë pozitive dhe te qendrueshem drejt penetrimit dhe aksesit ne broadband, si me poshte paraqitur:

| | Viti | AMC | VODAFONE | TOTAL |
|---|-------------|---------|----------|---------|
| Numri i pajisjeve celulare me akses ne broadband UMTS total | 2011 | 55,000 | 228,249 | 283,249 |
| | 2012 | 240,715 | 408,998 | 649,713 |
| | Diferenca % | 338% | 79% | 129% |
| Nepermjet telefonave celulare | 2011 | 46,000 | 202,756 | 248,756 |
| | 2012 | 222,882 | 371,426 | 594,308 |
| | Diferenca % | 385% | 83% | 139% |
| Nepermjet cards/modem/keys (non-mobile handsets) | 2011 | 9,000 | 25,493 | 34,493 |
| | 2012 | 17,833 | 37,572 | 55,405 |
| | Diferenca % | 98% | 47% | 61% |

Si perfundim, mund te themi qe tregu i internetit ne Shqiperi aktualisht nuk eshte ende plotesisht konkurrues ne ofrimin e sherbimit per perdoruesit fundor, por paraqet mundesi te larta zhvillimi dhe rritjeje per shkak te nivelit aktual te ulet te penetrimit. Per rrjedhoje, Qeveria dhe AKEP duhet te luajne rolin e tyre ne percaktimin e rregullave te qarta te lojes per zhvillimin e shpejte te tregut te internetit ne Shqiperi dhe te mbeshtetin operatoret alternative dhe ata celulare me nje kuader ligjor dhe rregullator ne favor te zgjerimit te rrjeteve me kosto te uleta dhe procedurave lehtesuese.

Nga ana tjeter Vodafone i kerkon AKEP te monitoroje me kujdes tregun ne vazhdimesi, pasi pjeset e tregut te operatorit inkumbent, qofte ne nivelin e pakices por sidomos ne nivelin e shumices, infrastruktura e tij e zhvilluar dhe e padubleshme, shtrirja e gjere e rrjetit fiber me permasa kombetare dhe integrimi vertikal i garantojne ketij lojtari nje avantazh te dukshem i cili ben diferencen ne momentin e vertikalizimit te fuqise ne tregjet e pakices.

Qendrimi i AKEP:

AKEP vlereson komentet e operatorëve, duke e konsideruar te drejte dhe te argumentuar mjaftueshem konkluzionin e AKEP se:

Tregu i pakices te aksesit ne broadband internet, është dinamik dhe i orientuar drejt konkurrencës efektive, konkluzion i cili eshte ilustruar edhe me treguesit e referuar ne dokumentin e analizes per shkallen e penetrimit te linjave te aksesit ne broadband si dhe nevojat gjithnje e ne rritje per kete sherbim, duke treguar qe ne fazen aktuale te zhvillimit te ketij tregu, vihen re shenjat e dinamizmit dhe te tendences drejt konkurrences efektive, dhe nje konkluzion i tille ka ardhur si rezultat i analizes se te gjithe faktoreve te konsideruar.

Duke nenvizuar faktin qe tregu i pakices ka tendence te qarte drejt konkurrences efektive, kjo ne asnje rast nuk nenkupton se eshte arritur “stacioni i fundit”i konkurrences efektive. Te gjitha komentet e sjella nga AMC dhe VF, edhe pse ne kendveshtrime te ndryshme ne pikepamjen e interesit, ne thelb reflekton rendesine e zhvillimit akoma me tej te tregut te aksesit ne broadband internet, me qellim rritjen e nivelit te penetrimit ne kete sherbim. Por duke e analizuar ne kendveshtrimin e kerkese/ofertes, konkluzioni i AKEP mbi fazen aktuale te zhvillimit te ketij tregu eshte i drejte dhe i arsyeshem.

2. A jeni dakort me konkluzionet paraprahe te arritura per perkufizimin, pershkrimin e produkteve si dimensionin gjeografik per tregun e shumices te aksesit ne broadband (bitstream akses) ne kete dokument?

Jepni komentin dhe arsyetimet tuaj per keto perfundime.

Pergjigje e Altelecom Sh.a:

Altelecom shprehet dakord me perkufizimin dhe dimensionin gjeografik te ketij tregu. Ndërsa në lidhje me përfundimet për statusin FNT në këtë treg dhe lënien në fuqi të detyrimeve rregullatore në vijim argumentohet pse Altelecom nuk i përmbush kriteret për FNT. Altelecom i ka paraqitur kundërshtimet e veta për këtë status edhe në analizën e bërë në 2011 dhe u qëndron sërish atyre argumentave.

AKEP është bazuar në faktorët standardë për të argumentuar nëse Altelecom është me FNT, si barrierat ligjore/rregullatore dhe strukturore, forcën kundërvepruese të blerësve, integrimin vertikal dhe horizontal. Gjithashtu, prishmëria e ketij tregu duket se është e orientuar drejt konkurrencës, për të cilën AKEP shprehet se: *“...prishmëritë për zhvillimin e konkurrencës në tregun e pakicës nuk do të ekzitonin, në se nuk do të ishte në konsideratë zhvillimi pozitiv në tregun e shumicës të aksesit në broadband”* (fq.62).

Teorikisht gjithnjë është pranuar një lidhje e drejtpërdrejtë mes rregullimit të tregjeve në nivel shumice dhe konkurrencës së tregjeve përkatëse në nivel pakice. Por në kushtet aktuale në të cilat paraqitet tregu i pakicës, ku konkurrenca rezulton të jetë në rritje për shkak të ofrimit të shërbimeve nga operatorët alternativë dhe në kushtet kur Altelecom-it nuk i është paraqitur asnjë kërkesë për të lidhur marrëveshje për aksesin bitstream, lehtësisht mund të argumentohet se lidhja *“shkak-pasojë”* mes këtyre dy tregjeve është thjesht teorike dhe tregu në nivel pakice është zhvilluar jashtë ndikimit rregullator të imponuar ndaj Altelecom. E thënë ndryshe, nuk kanë qënë këto masa të imponuara që kanë drejtuar tregun ndaj konkurrencës por faktorë të tjerë të tregut.

Së pari, nëse i referohemi të dyja kaheve të zëvendësueshmërisë së shërbimit është AKEP që argumenton se ekziston mundësia e zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës pasi ky shërbim është i mundshëm për t’u ofruar, pavarësisht teknologjisë, edhe nga operatorë të tjerë që janë aktivë në treg dhe kanë ndërtuar rrjetet e tyre.

Se dyti, ky treg paraqitet si një treg në zhvillim dhe akoma i pamaturuar dhe imponimi i masave rregullatore në këtë stad vetëm do të rëndonte pozicionin e Altelecom në raport me operatorët e tjerë.

Së treti, si edhe sanksionohet dhe në nenin 1 të Ligjit 9918, i ndryshuar, i cili thekson parimin e asnjëanësisë teknologjike për promovimin e konkurrencës dhe infrastrukturës efëcente për ofrimin e shërbimeve, Altelecom nuk është i vetmi operator që mund të ofrojë aksesin bitstream, as nga pikëpamja e teknologjisë por as e infrastrukturës, përderisa ka një numër të konsiderueshëm operatorësh alternative dhe dy operatorë 3G që operojnë në territore të caktuara në RSH dhe që disponojnë mundësitë për t’u rritur në këtë treg.

Teknologjitë e avancuara, fuqia kundërvepruese e blerësve që tashmë gëzojnë lirinë e zgjedhjes për të lidhur marrëveshje me operatorë të tjerë përveç Albtelecom, infrastrukturat paralele në zona gjeografike të njëjta, krijojnë të gjitha premisat për të patur një konkurrencë efçente në tregun me shumicë të aksesit bitstream. Liria e hyrjes në këtë treg, që kushtëzohet vetëm nga vullneti i operatorit, dëshmon për mungesën e barrierave rregullatore, ekonomike, teknologjike apo strukturore dhe të gjitha këto janë tregues të një tregu të orientuar drejt konkurrencës efektive.

Albtelecom nuk e gjen të arsyetuar statusin me FNT, madje gjykon se masat e propozuara nga AKEP nuk janë në linjë me objektivat rregullatorë të zhvillimit të tregut. Vendosja e detyrimeve, ndër të tjera, duhet të sigurojë mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (neni 7/të i Ligjit). Albtelecom gjykon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me operatorët e tjerë e, për më tepër, ndihet i diskriminuar duke e rënduar me detyrime të pajustificuara.

Për sa më lart, Albtelecom gjykon se ky treg nuk duhet të vazhdojë të jetë nën rregullim, për të gjitha arsytet e argumentuara, parë kjo edhe në linjë me përfundimet e analizave të institucioneve ndërkombëtare që nënvizojnë prirjen e derregullimit të tregjeve, përsa kohë zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut vendosin një balancë konkurruese.

Pergjigje e AMC:

Tregu i shumices për aksesin në broadband bën pjesë në listen e tregjeve nën rregullim sipas EC Recommendation 2007, dhe se fundi dhe në Rregulloren e re të miratuar nga AKEP me anë të *Vendimit nr.2342, date 31.07.2013 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.9, date 17.07.2009 "Për analizën e tregut" "*

AMC shpreh objeksionin e saj përse i perket përfshirjes në të njëjtin treg të aksesit në broadband, atë nga vendndodhje fikse dhe aksesin nëperjet kartave/modem me anë të rrjeteve mobile 3G, i arsyetuar nga AKEP si dy produkte që karakterizohen nga të njëjtat karakteristika funksionale pavarësisht se kanë diferencë në tarifimet perkatese.

Duke qenë se perkufizimi i tregut me shumicë broadband access rrjedh nga perkufizimi i tregut perkates me pakice të aksesit në broadband internet për perdoruesit fundore, përfshirja e dy produkteve (akses me anë të kartave modem USB nga rrjetet mobile 3G dhe akses nga vendndodhje fikse) është e gabuar pasi këto dy shërbime aksesit nuk janë plotësisht të zëvendësueshem me njëri-tjetrin.

Se pari, AKEP nuk ka dhënë evidenca përse i perket numrit të perdoruesve që kanë lënë shërbimin e aksesit në broadband nga vendndodhje fikse për të kaluar në aksesin broadband mobile me kart modem USB me anë të teknologjisë 3G.

Se dyti, sic dhe evidentohet nga dokumenti i BEREC "*BoR (10) 28 report on market definitions, par.3.1 NRAs' experience: fixed/mobile broadband*" në disa vende të BE-se (Austria, Finlanda, Irlanda, Portugalia, etj) aksesit me pakice në broadband fikse dhe në atë mobile nuk janë pjesë e të njëjtit treg. Në këto vende zëvendësueshmëria midis këtyre shërbimeve shihet me teper si komplementar nga ana e kërkesës, ndërsa nga ana e ofertës këto shërbime shfaqin ndryshime në aspektin funksional dhe në cmimet perkatese me të cilat ofrohen në treg.

Duke qenë se tregjet me shumicë dhe pakice të aksesit në broadband janë tregje të lidhur vertikalisht, teknologjia e aksesit në tregjet me shumicë është e njëjta e perdorur dhe në

tregjet retail, ndaj dhe i njeiti arsyetim qe eshte perdorur ne tregjet me pakice trasferohet ne ato me shumice.

Ne baze te arsytimit te shprehur mesiper, AMC nuk eshte dakort me perfshirjen ne te njejtin treg per sherbimet e aksesit ne broadband nga vendndodhje fikse dhe te aksesit me karta modem USB me ane te rrjeteve mobile 3G.

Ndersa, per sa i perket dimensionit gjeografik te ketyre tregjeve, AMC eshte dakort me konkluzionin e AKEP qe territori kombetar eshte dimensionin gjeografik per tregun me shumice te aksesit ne broadband internet.

Pergjigje e Plus:

Jemi dakord me konkluzionin e AKEP per perkufizimin, pershkrimin e produkteve si dimensionin gjeografik per tregun e shumices te aksesit broadband (bistream akses).

Qendrimi i AKEP:

Pershkrimi i bere nga AKEP per produktet dhe sherbimet pjese perberese te tregut te analizuar, gjejne dakortesi nga operatoret te cilet kane sjelle komentet per kete pyetje. Ne lidhje me arsytimin e perseritur edhe ne pyetjen e pare te AMC per mos-perfshirjen ne te njejtin treg per sherbimet e aksesit ne broadband nga vendndodhje fikse dhe te aksesit me karta modem USB me ane te rrjeteve mobile 3G, AKEP e ka trajtuar edhe si akses ne broadband fiks, por edhe si akses ne broadband fiks + 3G. Por trajtimi i bere per USB karta modem nepermjet 3G te cilat perdoren per akses ne PC, lap top, krijojne ngjashmeri te plote ne anen funksionale por edhe te karakteristikave te tjera qe nga pikepamja e zevendesueshmerise midis ketyre sherbimeve tentojne drejt nje zevendesueshmerie pothuajse te plote ne te dy anet (kerkese/ofertes).

3. A jeni dakort me perfundimet e arritura ne tregun me shumice te aksesit fizik ne infrastrukturen fizike te rrjetit lokal (LLU)?

Jepni komentin dhe arsytimet tuaj per keto perfundime.

Pergjigje e Albtelecom Sh.a:

Albtelecom shprehet dakord lidhur me percaktimin e tregut dhe dimensionin gjeografik te tij dhe gjykon se jane pjesë përbërëse e këtij tregu të gjitha shërbimet që mundësohen nga të dyja tipet e aksesit (full-shared access). Gjithashtu shprehet dakort lidhur me të gjitha produktet dhe shërbimet të konsideruara në këtë analizë si zëvendësuese, pavarësisht teknologjisë së përdorur për të mundësuar këto lloje të aksesit (bakër, fibër etj). Ndërsa për sa lidhet me vlerësimin e faktorëve si fuqia kundërvepruese e blerësve, natyrës së integritimit vertikal dhe horizontal dhe i faktorëve avantazhues të ekonomisë (të shkallës dhe densitetit) të analizuar në këtë seksion të analizës, Albtelecom shprehet në kundërshtim të konkluzionit të AKEP, madje thekson faktin se të gjithë këta faktorë tregojnë dukshëm se kriteret për FNT nuk përmbushen.

Pergjigje e AMC:

AMC është dakort me konkluzionet e AKEP në lidhje me përcaktimin e tregut të shumicës së aksesit në infrastrukturën fizike të rrjeteve LLU, për shërbimet që përfshijn ky treg dhe dimensionin gjeografik të tij.

Përgjigje e Plus:

Jemi dakord me përfundimet e arritura në tregun me shumicë të aksesit fizik në infrastrukturën fizike të rrjetit lokal (LLU). Megjithatë pjesa më e madhe e paleve të interesuara për LLU kanë filluar të zhvillojnë kërkesat e tyre për akses në broadband kryesisht në rrjetet e tyre, ose mbështeten në teknologji me kosto më të ulët për ofrimin e shërbimit për pajtimtarët e tyre. Kjo mund të ndikojë në rënie të interesit për LLU të paleve të interesuara në një të ardhme të afërt.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP në lidhje me pyetjen e shtruar për të cilin kërkon në se produktet dhe shërbimet e përfshira në tregun e analizuar kanë përshkrimin e duhur, nuk ve re ndonjë kundërshtim apo argument të ndryshëm nga ato që janë dhënë në dokumentin e analizës. Falënderon operatorët për komentet e tyre.

Pjesa tjetër e komenteve të Albtelecom, do të gjejë qëndrimin e AKEP në vijimesi të pyetjeve që përcaktojnë statusin dhe masat rregullatore përkatëse.

4. A jeni dakort me përfundimin e mesipër për përcaktimin e tregut të shumicës së aksesit në infrastrukturën fizike të rrjeteve (LLU)? Jepni komentet tuaja.

Përgjigje e Albtelecom Sh.a:

Për shkak të lidhjes që ekziston mes këtyre dy tregjeve, e shprehur kjo dhe në dokumentin e analizës, mund të analizohen dhe të pandarë pasi konsiderohen si baza furnizuese me produkte dhe shërbime për tregjet e pakicës, ç'ka do të thotë që de-rregullimi i njërit treg mund të pretendohet edhe për tregun tjetër.

Siç edhe nënvizohet në analizën e AKEP vendosja e masave rregullatore bëhet me qëllim të stimulojë konkurrencën në tregjet e pakicës. Edhe Rekomandimi i KE 2007 në parag. 2 të tij sanksionon se ...“objektivi për ndërhyrjen ex-ante bëhet vetëm për t'u siguruar benefite përdoruesve fundorë duke i bërë tregjet me pakicë konkurruese”. Sikurse u argumentua më lart teorikisht ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë e efekteve të rregullimit të tregjeve të shumicës me tregjet përkatëse të pakicës. Por në kushtet kur Albtelecom nuk ka asnjë kërkesë për të lidhur marrëveshje për LLU/Bitstream dhe kur tregu i pakicës rezulton të jetë kompetitiv, atëherë në referencë edhe të Rekomandimit të KE, imponimi i masave rregullatore në nivel shumicë nuk e justifikon qëllimin për të cilin vendosen.

Gjatë analizës së këtij tregu AKEP e ka vënë theksin te investimet e bëra për ndërtimin e rrjeteve vetjake nga operatorët alternativë dhe të llojeve të ndryshme të aksesit sipas teknologjive më të avancuara (3G) të cilat ulin ndjeshëm kërkesën për përdorimin e

infrastrukturës së Albtelecom. Edhe në konkluzionet e AKEP citohen një sërë faktorësh, si: kushtet kombëtare të këtij tregu, zëvendësueshmëria e LLU nga zhvillimet teknologjike, dublimi i infrastrukturës për të njëjtat zona gjeografike nga OA, mbyllja e centraleve lokale dhe kalimi i rrjeteve në nivele IP, faktorë këta që ndikojnë në zbehjen e fuqisë dominante të Albtelecom.

Albtelecom vlerëson analizimin e faktorëve nga AKEP, por nga ana tjetër shprehet se nuk ekziston një lidhje koherente mes argumentave të sjellë dhe përfundimit të nxjerrë në bazë të tyre. Edhe po të analizohet testi i tre kriterëve që përcakton tregjet për ndërhyrje ex-ante do të konkludohet se ato nuk përmbushen, sepse:

- i. **Nuk ekzistojnë barriera të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes:** operatorë të tjerë kanë ndërtuar rrjetet e veta dhe operojnë lirisht në këtë treg. Barriera të natyrës ligjore/rregullore, ekonomike dhe teknologjike apo stukturore duket qartë që nuk ekzistojnë. Kjo evidentohet edhe nga fakti që pranë Albtelecom nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga OA për të lidhur marrëveshje për këtë lloj aksesi, informacion që referohet edhe në analizën e AKEP.
- ii. **Struktura e tregut ka prirjen për t’u orientuar në drejtim të konkurrencës efektive brenda afatit kohor përkatës:** tashmë tregu i pakicës është konkurrues për arsyet që kemi përmendur më lart dhe kjo konkurrencë nuk është rezultat i imponimit të masave rregullore në nivel shumice, për më tepër kur nuk ka asnjë kërkesë për LLU, por i hapjes së tregut që reflektohet nga numri i konsiderueshëm i operatorëve dhe shumëllojshmëria e ofertave/paketave dhe teknologjive që mundësojnë aksesin në internet.
- iii. Nuk mund gjykohet as për plotësimin e kriterit të tretë, **“Pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim:** prezenca në treg e operatorëve që ofrojnë gjithnjë e më tepër oferta konkurruese nuk dëshmon për mungesë të konkurrencës të tregjet relevante.

Për sa më lart, gjykojmë se Albtelecom nuk i përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës

Pergjigje e AMC:

Konkluzionet e AKEP në lidhje me tregun me shumicë të aksesit fizik në infrastrukturen fizike të rrjetit lokal LLU janë të sakta, sipas të cilave Albtelecom është operator me FNT në këtë treg (full and shared access).

Albtelecom si operatori inkumbent në këtë treg vazhdon të mbaje nivele të larta përqendrimi të shprehur në numër linjash aksesi fizik, duke pasur një pozite dominante, për shkak të shtrirjes gjeografike dhe mbulimit territorial me anë të rrjetit të saj. Nga një pozite e tillë, ky operator gëzon avantazhe të konsiderueshme ndaj operatorëve të tjerë në tregun me shumicë të aksesit fizik në infrastrukturen e rrjetit lokal LLU. Treguesit e lartë të shprehur në përqindje në terma të numrit të linjave (mbi 70%), pavarësisht zhvillimit të teknologjive të tjera konkurruese, e përforcojnë në mënyrë tepër poziten e tij dominante, gjë e cila bën e nevojshme një monitorim të vazhdueshëm të këtij tregu sic parashikon kuadri rregullator.

Pergjigje e Plus:

Jemi dakord me perfundimet e arritura ne tregun me shumice te aksesit fizik ne infrastrukturen fizike te rrjetit lokal (LLU).

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania mbeshtet analizen dhe perfundimin e AKEP se operatori inkumbent eshte operator me fuqi te ndjeshme ne tregun me shumice te aksesit fizik ne infrastrukturen fizike te rrjetit lokal (LLU), dhe si tille duhet ti nenshtrohet te gjithe detyrimeve rregullatore qe parashikon Ligji 9918. Ne te njejten kohe Vodafone shprehet se AKEP duhet te perfshije me menyre te qarte dhe specifike ne tregun e rregulluar dhe rrjetin NGA se bashku me te gjithe sherbimet qe ofrohen prej tij, VDSL fillimisht – FTTC, e me rradhe PSTN, ASDL, ASDL 2+, ISDN, SHDL, etj, ku operatori incumbent ka pozite dominuese. AKEP duhet te vendose mbi operatorin inkumbent te te gjithe detyrimet rregullatore per rrjetin NGA ashtu si edhe per rrjetin TDM te meparshem.

Vodafone Albania shprehet se ne percaktimin e tregut nen rregullim AKEP duhet te marre ne konsiderate te gjithe teknologjite e perdorura nga operatori inkumbent per te dhene akses ne nivel shumice per te gjithe sherbimet qe me pas te mund ti ofrohen pajtimtarit fundor. Kjo do te thote qe detyrimi per akses, transparence, mosdiskriminim, dhe kontroll tarifash e ndarje llogarish duhet te perfshije te gjithe elementet e rrjetit/nyjet e sistemit te aksesit dhe transportit (aktive dhe pasive) ku pavaresisht teknologjise se ofruar, operatoret e tjere te kene mundesi te aksesojne rrjetin e operatorit inkumbent sipas kushteve te rregulluara, per te gjithe sherbimet qe ofrohen ne treg dhe ofrohen nga operatori inkumbent dhe jane ne interes te pajtimtarit. Ne menyre te vecante rregullimi i operatorit incumbent duhet te shtrihet specifikisht dhe te perfshije rrjetin NGA dhe te gjithe elementet e tij, per gjithe sherbimet e reja me baze fibren optike qe ai mundeson.

Qendrimi i AKEP:

AKEP ne analizen e keshilluar me palet e interesit, ka theksuar faktin qe ne kete treg nuk ka asnje kerkese te evidentuar , por duke gjykuar se jemi ne te njejtat kushte te trajtuara edhe ne analizen e pararendese, ka vleresuar se Albtelecom gezon statusin me FNT ne kete treg, ne konsistence me argumentet e perdoruara edhe ne analizen pararendese. Ne dokumentin e analizes jane per t'u konsideruar nga operatoret edhe parashikimet e bera nga AKEP mbi pritshmerite per LLU ne te ardhmen. Por duke vlersuar faktorin kohe te implementimit te masave rregullatore ne analizat pararendese (e gjykuar si kohe e shkurter per te vleresuar faktin ne se do te kete apo jo kerkesa te mundshme ne kete treg), atehere vleresohet e arsueshme nje zgajtje e kohes per vijimesine e masave rregullatore te vendosura, pasi ne kete menyre as nuk shtojne apo zvoglojne peshen per operatorin Albtelecom mbi te cilin jane vendosur masat rregullatore perkatese ne tregun e analizuar.

5. A jeni dakort me perfundimin e AKEP ne lidhje me masat rregullatore per Albtelecom per LLU, sipas te cilit kerkohet vazhdimesia e implementimit te masave rregullatore te vendosura ne analizen pararendese per kete treg ?

Jepni komentin dhe arsyetimet tuaj per keto perfundime.

Pergjigje e Altelecom Sh.a:

Në përgjigjen e pikës 4 u argumentua se Altelecom nuk përmbush kriteret për t'u shpallur OFNT në tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën fizike, pasi për shkak të një sërë faktorësh nuk e gëzon këtë status, atëherë dhe masat rregullatore që propozohen të vazhdojnë nuk justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur.

Pergjigje e AMC:

Duke qene se Altelecom ka nje pozite dominante ne tregun e aksesit fizik ne LLU dhe si i tille ka FNT ne kete treg, AMC mbeshtet konkluzionin e AKEP per vazhdimesine e implemenetimit te masave rregullatore te vendosura ne analizen pararendese per kete treg. Vazhdimi i aplikimit te metejshem te masave rregullatore eshte ne perputhje dhe me programin strategjik te Qeverise ne lidhje me aksesin ne internet ne te gjithe territorin e vendit dhe masat rregullatore ne tregun me shumice te aksesit fizik ne infrastrukturen fizike LLU luan nje rol te rëndesishem ne rritjen dhe perphapjen e metejshme te aksesit ne broadband internet dhe ne perdorimin sa me masiv te tij si nga institucionet publike ashtu dhe ato private (biznese, perdorues familjare, etj).

Pergjigje e Plus:

Jemi dakord me perfundimin e AKEP ne lidhje me masat rregullatore per Altelecom per LLU, sipas te cilave kerkohet vazhdimesia e detyrimeve rregullatore te vendosura ne analize 2011 ndaj Altelecom ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike te Altelecom perfshire facilitetet e tjera ndihmese, etj;

- Detyrimi per Aksesin (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi per mos-diskriminim (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi per transparence (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi per ndarjen e llogarive dhe detyrimi per kontroll te tarifave dhe sistemin e mbajtjes se llogarive (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania mbeshtet perfundimin e AKEP se operatori inkumbent eshte operator me fuqi te ndjeshme ne tregun me shumice te aksesit fizik ne infrastrukturen fizike te rrjetit local (LLU), dhe si tille duhet ti nenshtrohet te gjithe detyrimeve rregullatore qe parashikon Ligji 9918. Ne te njejten kohe Vodafone shprehet se AKEP duhet te perfshije me menyre te qarte dhe specifike ne tregun e rregulluar dhe rrjetin NGA se bashku me te gjithe sherbimet qe ofrohen prej tij, VDSL fillimisht – FTTC, e me rradhe PSTN, ASDL, ASDL 2+, ISDN, SHDL, etj, ku operatori incumbent ka pozite dominuese. AKEP duhet te vendose mbi operatorin inkumbent te te gjithe detyrimet rregullatore per rrjetin NGA ashtu si edhe per rrjetin TDM te meparshem.

Duke gjykuar nga pozita ne treg e operatorit inkumbent, me nje market share prej mbi 85 %, Vodafone Albania shprehet se testi i 3 kriterëve duhet kryer nga AKEP per nevojë analize te sakte, gjithëpërshirëse dhe te detajuar, por pavaresisht rezultatit te tij, pjesët e tregut nuk lenë vend per ekuivok apo trajtim alternativ; operatori inkumbent është plotësisht ne kushtet e nje dominancë te theksuar ne kete treg dhe si I tille duhet medoemos te rregullohet nga AKEP dhe te jete subjekt i te gjithë detyrimeve perkates qe percakton rigorozisht Ligji 9918.

Vodafone Albania shprehet plotësisht dakord qe detyrimet rregullatore te mbeten ato qe kane qene ne fuqi edhe pergjate analizes se meparshme ne vitin 2011 per aksesin ne infrastrukturen LLU. Njekohesisht te gjithë detyrimet rregullatore nevojiten te vendosen specifikisht mbi operatorin inkumbent per rrjetin NGA, si nje treg ku operatori incumbent ka padiskutim nje pozite dominuese te padiskutueshme.

Nga ana tjeter, duke veshtruar me shqetesim, pozitën e palekundur dominuese te operatorit inkumbent ne treg, Vodafone i kerkon AKEP qe te vleresoje mundesine e nderhyrjes ne treg qe te marre masa me konkrete dhe efikase per te garantuar konkurrenca te shtuar dhe per te ndihmuar frymemarrjen e operatoreve te tjere dhe ‘cmontimin’ e pozites dominuese ekzistuese qe është ne dem te konsumatorit fundor.

Eshte e papranueshme qe e njejta dinamike e ‘ngrire’ tregu te mbetet e pandryshueshme ne 2 vjet kohe dhe AKEP te mos marre masa emergjente per ti dhene incentive dhe shtyese operatoreve te tjere ne funksion te rritjes se konkurrencës dhe per te aksesuar rrjetin e operatorit inkumbent. Kjo mund te arrihet duke analizuar jo vetem mundesine e uljes se cmimeve ne nivel shumice por edhe rishikimin e kujdesshem te kushteve te aksesit, pengesave potenciale indirekte, tarifave te sherbimeve shoqeruese qe nuk jane nen-rregullim, SLA e ofrimit te sherbimit, etj.

Ne kete kuader, Vodafone i kerkon AKEP qe te rishikojë Oferten Reference te Albtelecom per Aksesin ne rrjetin lokal, per te pare mundesuar ne terma konkrete qofte ne nivel aksesi ne facilitete por edhe tarifa te publikuara, transparence, mosdiskriminim qe sherbimi aksesi LLU dhe ne rrjetin NGA te shnderrohet realisht ne efektiv dhe prej tij te perfitojne sipermarresit dhe perdoruesit fundore. Kjo duhet sidomos te kete ne fokus sherbimet e reja qe perftohen nga aksesi ne NGA te operatori inkumbent, me baze teknologjine e fibres optike e cila është e ardhmja per zhvillimin teknologjik dhe komunikimin e informacionit. Ndaj dhe rishikimi i RUO duhet pikerisht te kete ne fokus aksesin ne rrjetin NGA dhe pershtatjen ndaj zhvillimeve teknologjike qe operatori inkumbent ka pesuar sidomos ne 2 vite e fundit (RUO dhe specifikat e saj jane miratuar dhe lenë ne fuqi kur ende rrjeti NGA i operatorit inkumbent nuk ishte plotësisht i perfunduar dhe i aksesueshem). Ne kete aspekt, Vodafone pret nga AKEP qe ne nje te ardhme te afert, mbas perfundimit te kesaj Analize tregu, te nxjerre per konsultim dokumentin RUO per te pare nevojën per perditesimin e tij sipas zhvillimeve teknologjike dhe nevojave te tregut dhe aksesin ne rrjetin NGA.

Qendrimi i AKEP:

AKEP ne analizen e keshilluar me palet e interesit, ka theksuar faktin qe ne kete treg nuk ka asnje kerkese, por duke gjykuar se jemi ne te njejtat kushte te trajtuara edhe ne analizen e pararendese, si dhe duke konsideruar faktin qe aplikimi i masave rregullatore te vendosura sipas analizes 2011, nuk kane qene efektive menjehere pas vendosjes se tyre, pasi kane kerkuar kohen e nevojshme per hartimin dhe aplikimin e tyre. Me qellim nxitjen dhe stimulimin e nevojshem te kerkesave te mundshme te tregut, si dhe ne kushtet kur ka te njejtat produkte dhe pershkrim te tyre si ne analizen pararendese, dhenia e kohes se nevojshme si dhe stimujve te mundshem per nxitje te kerkesave te tregut, nuk perben ndonje barre per Albtelcom, dhe vazhdimesia e masave rregullatore në nivel shumice per nje periudhe afatmesme deri ne analizen e radhes, justifikon qëllimin për të cilin vendosen per te kuptuar ne se realisht tregu nuk ofron asnje kerkese te mundshme per kete sherbim.

AKEP ka trajtuar ne dokumentin e keshilluar me palet e interesit edhe faktorin e “investimit” ne rrjetin NGA si dhe per kete qellim ka referuar edhe opinione te KE-se, duke vendosur theksin ne nevojen per stimulimin e investimeve te tilla dhe pjekurine e duhur te ketyre investimeve, duke marre ne konsiderate edhe riskun e mundshem te rritjes ose jo te kerkesave ne treg, te cilat do te justifikonin propocionalisht investimet e kryera.

AKEP, ne percaktimin e bere per vazhdimesine e masave rregullatore, nder te tjera do te kerkoje edhe perditesimin (rishikimin) e Ofertave te References perkatese, ne pershtatje me ndryshimet e bere ne rrjetin perkates, duke kerkuar perditesimin sipas zhvillimeve teknologjike dhe nevojave te tregut dhe aksesin ne rrjetin NGA.

6. A jeni dakort me perfundimin e AKEP ne lidhje me masat rregullatore per Albtelcom ne lidhje me sherbimin Bitstream Akses ne nivelin e shumices (sipas nivelit te hirearkise ne rrjetin e tij) per te cilin kerkohet vazhdimesia e implementimit te masave rregullatore te vendosura ne analizen pararendese per kete treg ?

Jepni komentin dhe arsyetimet tuaj per keto perfundime.

Pergjigje e Albtelcom Sh.a:

Qëndrimi i Albtelcom për masat rregullatore në aksesin me shumicë bitstream është i njëjtë me qëndrimin e shprehur për LLU. Sikurse vlerësohet gjatë gjithë analizës zvogëlimi i dominancës së Albtelcom për shkak të ndërtimit të rrjeteve individuale nga OA dhe teknologjitë e reja që mundësojnë aksesin broadband kanë bërë që të mos ketë interes nga palët e tjera për të shfrytëzuar rrjetin e Albtelcom. Për sa analizuam më lart Albtelcom nuk është dakord me masat rregullatore që AKEP propozon të vazhdojnë të imponohen.

Për rrjedhojë të sa më sipër gjykojmë se, sipërmarrësi Albtelcom nuk i përmbush kriteret për FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe aksesit në infrastrukturën fizike të qarkut lokal (LLU) dhe propozojmë të hiqen masat rregullatore të propozuara respektivisht në tregjet e sipërcituara me daljen e vendimit përfundimtar të AKEP.

Pergjigje e AMC:

AMC mbështet perfundimin e AKEP ne lidhje me kerkimin e vazhdimesise se implementimit te masave rregullatore per Altelecom per sherbimin Bitstream Access ne nivelin e shumices, si detyrimin per akses, mosdiskrimin, transparence si dhe per ndarjen e llogarive dhe kontrollin e tarifave.

Per t'i bere sa me efektive keto detyrimeve rregullatore, nje hap i pare ka qene detyrimi per publikimin e Ofertes Reference (RO) nga ana e Altelecom ne te cilen paraqiten kushtet per dhenie aksesit ndaj operatoreve te tjere si dhe detyrimin per kontroll te tarifave perkatese.

Duke qene se shumica e operatoreve nuk kane nje mbulim te te gjithë territorit me rrjetet e tyre, dhe i vetmi qe gezon nje avantazh te tille, edhe pse keto avantazhe jane zbehur pak per shkak te investimeve kryesisht ne zonat me te medha urbane ne rrjetet individuale nga ana e operatoreve alternative (fiber optike dhe teknologjia NGN/NGA), perseri problemi i mbulimit te territorit me rrjet vazhdon te mbetet i tille, pasi OA jane perqendruar kryesisht ne zonat me dendesi me te madhe te popullsise.

Mbetet detyre dhe anagazhim i AKEP qe te ndermarre hapa akoma me konkret ne kete drejtim ne menyre qe te sigurohet aksesit ne rrjet edhe ne ato zona ku operatorët e tjere nuk kane mbulim territorial ne menyre qe te ofrojne sherbimet perkatese ye broadband internet per kategorite e ndryshme te perdoruesve sipas nevojave qe ata kane, ne menyre qe konsumatorët te kene mundesi me te medha te zgjedhjes ne kerkesat e tyre per sherbimin e broadband.

Pergjigje e Plus:

Jemi dakord me perfundimin e AKEP ne lidhje me masat rregullatore per Altelecom ne lidhje me sherbimin Bistream Akses ne nivel shumice per te cilin kerkohet vazhdimesia e detyrimeve rregullatore te vendosura ne analize 2011 ndaj Altelecom ne lidhje me tregun e shumices te aksesit ne broadband internet (bitstream akses nga vendodhje fikse) dhe konkretisht:

- Detyrimi per Aksesin (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi per mos-diskriminim (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);
- Detyrimi per transparence (sipas ligjit 9918 i ndryshuar);

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania mbështet plotesisht perfundimin e AKEP se operatori inkumbent eshte operator me fuqi te ndjeshme ne tregun me shumice per sherbimin Bitstream Akses ne nivelin e shumices (sipas nivelit te hirearkise ne rrjetin e tij, dhe si tille duhet ti nenshtrohet te gjithë detyrimeve rregullatore qe parashikon Ligji 9918.

Duke gjykuar nga pozita ne treg e operatorit inkumbent, Vodafone Albania shprehet se testi i 3 kriterëve duhet kryer nga AKEP per nevoje analize te sakte, gjithperfshirese dhe te detajuar, por pavaresisht rezultatit te tij, pjeset e tregut nuk lene vend per ekuivok apo trajtim alternativ; operatori inkumbent eshte plotesisht ne kushtet e nje dominance te theksuar ne kete treg dhe si i tille duhet medoemos te rregullohet nga AKEP dhe te jete subjekt i te gjithë detyrimeve perkates qe percakton rigorozisht Ligji 9918.

Vodafone Albania shprehet plotesisht dakord qe detyrimet rregullatore te mbeten ato qe kane qene ne fuqi edhe pergjate analizes se meparshme ne vitin 2011.

Nga ana tjetër, duke veshtruar me shqetësim, pozitën e palekundur dominuese të operatorit inkumbent në treg, Vodafone i kërkon AKEP që të vlerësojë mundësinë e nderhyrjes në treg që të marrë masa me efikasë për të garantuar konkurrencë të shtuar dhe për të zvogëluar pozitën dominuese ekzistuese që është në dem të konsumatorit fundor.

Tregu në fjalë nuk tregon aspak dinamike ndryshimi përgjatë këtyre 2 viteve ndaj dhe AKEP duhet të marrë masa emergjente për të dhënë incentive operatorëve të tjerë në funksion të rritjes së konkurrencës dhe për të aksesuar rrjetin e operatorit inkumbent. Kjo mund të arrihet duke analizuar mundësinë e rregullimit të çmimeve qoftë nëpërmjet modelit 'retail minus' (si modeli me i ndjekur) apo edhe nëpërmjet një analize kostoje siç është rasti në Maqedoni. Paralelisht duhet të rishikohen kushtet e aksesit, pengesat potenciale indirekte, tarifat e shërbimeve shoqërore që nuk janë nën-rregullim, SLA e ofrimit të shërbimit, etj.

Nevoja për nderhyrje nga AKEP përforçohet dhe nga statistikat me të fundit publikuar nga Cullen International në raportin për vendet në zgjerim të vitit 2013, ku në ndryshim nga një sërë vendesh të rajonit, Shqipëria e ka plotësisht të paeksploruar tregun e 'bitstream access' nga operatorët alternativë.

Qendrimi i AKEP:

Dokumenti i keshilluar me paletë e interesit ka bërë të qartë edhe për tregun e bitstream aksesit në nivelin e shumicës (në mënyrë të ngjashme me LLU), se nga këndvështrimi i kërkesës nuk ka patur ndonjë zhvillim të ri, pavarësisht vendosjes së masave rregullatore sipas analizës pararendese.

Rishikimi i këtij tregu, përveç faktorëve të njëjtit të argumentuar më së shpejti në dokumentin e analizës, argument kryesor në këtë fazë të zhvillimit të analizës, cili justifikon deri në një masë të konsiderueshme mungesën e zhvillimit të kërkesave për bitstream akses, është konsideruar ndërtimi i rrjeteve individuale nga OA dhe teknologjitë e reja që mundësojnë aksesin broadband, duke zbehur interesin nga palët e tjera për të shfrytëzuar rrjetin e Albtelecom.

Por arsyet për vijimesinë e masave rregullatore edhe në tregun e bitstream aksesit në nivelin e shumicës, janë pothuajse të njëjta me ato të konsideruara për LLU, duke qenë se aplikimi i masave rregullatore të vendosura sipas analizës 2011, nuk kanë qenë efektive menjëherë pas vendosjes së tyre, pasi kanë kërkuar kohën e nevojshme për hartimin e tyre. Me qëllim nxitjen dhe stimulimin e nevojshëm të kërkesave të mundshme të tregut, si dhe në kushtet kur ka të njëjtat produkte dhe përshkrim të tyre si në analizën pararendese, dhënia e kohës për nxitje të kërkesave të tregut, nuk përben ndonjë barër për Albtelecom, dhe vazhdimësia e masave rregullatore në nivel shumicës për një periudhë afatmesme deri në analizën e radhës, justifikon qëllimin për të cilin vendosen për të kuptuar nëse realisht tregu nuk ofron asnjë kërkesë të mundshme për këtë shërbim.

Ngjashmërisht me qëndrimin e AKEP për të njëjtin pyetje të konsultuar me paletë e interesit për vazhdimësinë e masave rregullatore për LLU (qendron e njëjta edhe për BITSTREAM AKSES), duke sjellë perspektivën e "investimit" në rrjetin NGA si dhe për këtë duke referuar edhe opinionin e KE-se, në nevojën e rritjes për stimulimin e investimeve të tilla dhe pjekurisë e duhur të këtyre investimeve, duke marrë në konsideratë edhe rrishtin e mundshëm të rritjes ose jo të kërkesave në treg, që do të justifikonin proporcionalisht investimet e kryera.

Ne percaktimin e bere per vazhdimesine e masave rregullatore, duke marre ne konsiderate investimet dhe ndryshimet e kryera nder te tjera do te kerkohet nga Albtelecom edhe perditesimin (rishikimin) e Ofertave te References perkatese, ne pershtatje me ndryshimet e bere ne rrjetin perkates, duke kerkuar perditesimin sipas zhvillimeve teknologjike dhe nevojave te tregut dhe aksesin ne rrjetin NGA.

AKEP, me qellim nxitjen dhe stimulimin e kerkesave per akses ne broadband internet ne nivelin e shumices (bitstream akses), perfshire edhe komentet e paleve te interesuara mbi dokumentin e keshilluar, vlereson qe ne lidhje me detyrimin per “kontrollin e tarifave”, ne ndryshim nga analiza pararendese dhe percaktimet e bera ne VKD nr.1565 date 13.04.2011, sipas te cilit Albtelecom ka detyrimin te jape akses me shumice broadband (bitstream), ne terma komerciale, perfshire tarifat e ketyre sherbimeve dhe se cdo rast mosmarrveshje midis paleve do te zgjidheshin duke zbatuar parashikimet e ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator perkates.

Bazuar ne përvorjen nderkombetare, apo referencave te tjera per menyren e tarifimit te bitstream akses, sipas niveleve te hireakise AKEP do te perdore metoden e rregullimit e cmimeve nepermjet modelit ‘retail minus’.